

## NJË VIT PA KADARENË

A është përmbyllur  
studimi i identitetit  
dhe i psikologjisë së  
vlerës të veprës së tij?

Nga Floresha Dado (fq. 2)

Në Paris, në hapat  
e Kadaresë...

Nga Luan Rama (fq. 6)

## SHËNIME MBI LIBRAT

Tregimi "Mrikalemi dhe Dardhojmeli"

Mrekullia e rrëfimit të  
shkrimtarit Mehmet Kraja  
apo stili është gjithçka

Nga Dr. Haxhi Shabani (fq. 10)

Bujar Skëndo dhe romani  
"Flijimi i maskave"

Nga Çerçiz Loloçi (fq. 11)

Tridhjetë vjet pas botimit të parë, romani debutues i  
Dona Tartit, "Historia sekrete", vazhdon të magjepsë  
breza të rinj lexuesish.

"Historia sekrete", misteri  
që vazhdon të magjepsë  
lexuesit edhe pas tri  
dekadash

Nga Clare Thorp  
Përktheu: Xhoina Salaj (fq. 22)

Skicë antropologjike këtej  
dhe andej kufirit

Nga Albert Doja (fq. 17)

SANDËR PROSI, ARTISTI  
QË KISHTE LINDUR  
PËR EKRANIN

Nga Mevlan Shanaj (fq. 19)

Dua të kujtoj disa copëza jete nga artisti më i njohur  
i ekranit shqiptar, në këtë përvjetor të ikjes së tij!  
Rolet ia njohim kaq mirë dhe janë njëri më i arrirë  
se tjetri. Mjafton Dhaskal Todri, Xha Jaho apo Ismail  
Qemali e shumë e shumë të tjera, duke u kthyer deri  
tek Otelloja. Këtu po kujtoj vetëm copëza jete me këtë  
artist të madh.

Me fat që e  
patëm pranë  
në jetën tonë

Nga Sadik Bejko (fq. 5)

Kadare — epoka që  
vazhdon

Nga Arben Veselaj (fq. 4)



Mbi debatin rreth boceteve të propozuara për  
monumentin e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, i  
cili do të vendoset në Ulqin të Malit të Zi.

Mos u ngutni!

Nga Suzana Varvarica Kuka

Ky tekst u lind mes dhjetëra debatesh, të cilët i kam ndjekur me vemëndje mbi  
Katë se çfarë po ndodh së fundmi, në trojet shqiptare me artin e skulpturës  
monumentale. Ai është një art domethënës e social politik, jeton në kohëgjatësi  
dhe i përballet vëzhgimit dhe shijeve të brezave.

(fq. 8)

Instalacion nga Bib Frrokaj

Një përshtypje nga takimi  
me veprën "Flamuri i Dritës"

Nga Stefan Çapaliku (fq. 23)


Botim i ri nga "Trishtil"

COCO MELLORS  
"Kleopatra dhe  
Frankenshtajni"

(fq. 18)

COCO MELLORS

Kleopatra dhe  
Frankenshtajni



Roman

Trishtil

## BIBLIOTEKË

Rudolf Marku (fq. 12)

*Ka prapë kohë*

Shqiponja Axhami (fq. 14)

*NationWide*

Gaqo Apostoli (fq. 15)

*Sa herë në rrugë kalon një grua*

Luljeta Dano (fq. 16)

*Larzuar me zjarr*

Arben Meksi (fq. 24)

*Karikatura e së shtunës*

Rivështim

Simbolizmi ose preludi i  
modernitetit në letërsi

Nga Feride Pappleka (fq. 20)

Fjala poetike është transhendencë, është kërkim i  
identitetit. Kjo u kuptua më tepër se kurrë në vitet  
simboliste, kur poema u bë ikonoklaste dhe nuk i përgjigjej  
më rregullit të ligjërimit në vargje. Poeti parnasian kishte  
pushuar së ekzistuari. Kodi lirik ishte bërë stereotip. Kështu,  
lindi kriza e vargëzimit si krizë moderniteti që solli shkrimin  
vertikal, madhështor, jehonë tematike e kuptimësisë me  
vargun e lirë, poemën në prozë dhe prozën poetike.

Konferencë shkencore, 30 qershor 2025

POETIKA LETRARE E  
RIDVAN DIBRËS

(fq. 18)

Biblioteka Universitare, Shkodër

Shumë analiza cilësore nga kritika letrare, studime monografike, janë shkruar për krijmtarinë e Kadaresë ! Në botime të posaçme, në shtypin letrar e më gjerë, brenda dhe jashtë vendit (kujtojmë me mijra shkrime vetëm të shtypit botëror, francez e të tjerë...). Autori më i vlerësuar e i studiuar ! Duket sikur është thënë gjithshka...Nga ana tjetër, përkrah kritikës vlerësuese, mbizotëruese në mendimin e sotëm, shfaqen edhe sfiduesit që nuk e shohin autorin në krye të letërsisë moderne bashkëkohore. Krejtësisht e natyrshme. Sepse, siç dihet, është vetë thelbi i letërsisë artistike, si arti i përpunimit të fjalës, që sfidon vazhdimisht, në çdo periudhë dhe kategori lexuesish, që nxit mospërputhje ndijesish e përjetimesh artistike. Por, përballë dy kategorive të kritikëve dhe të lexuesve, vepra e I.Kadaresë mbetet vazhdimisht sfiduese, *'manipuluese'* vlerësimesh, kryeneçe, e bindur në pushtetin e saj, sa të drejtpërdrejtë, aq edhe të fshehtë. Në tërësinë e vlerësimeve, analizave që i janë kushtuar, ajo shfaqet gjithnjë e më *'e pakënaqur'*, sepse në thellësitë e saj, në strukturat e brendshme kuptimore, mendimi artistik hapet e hapet, si një spirale, së cilës nuk ja shohim lehtësisht fundin. Korpusi artistik kadarean e ka vlerën e vet pikërisht te kurthi që, sado i vështirë, ka magjinë e tërheqjes së vazhdueshme të mendimit kritik... Interpretimi artistik, me një kompleksitet qasjesh, mbetet një horizont i gjerë, që, nga njera anë thëllon njohjen e imagjinatës krijuese-filozofike të brendshme të veprave, nga ana tjetër zbulon aftësitë vëzhguese, thellësitë e vëzhgimit artistik të poetikës nga ana e kritikut dhe studiuesit letrar. Dhe, kur flasim për poetikën e prozës, të poezisë, apo të eseistikës së Kadaresë, kemi parasysh një makrostrukturë artistike, sa origjinale, aq edhe *'të papërfunduar'* në kuptimësinë dhe filozofinë e brendshme. Qasja ndaj saj mbetet sfidë e përhershme e kritikës sonë letrare, një proces sa real aq dhe imagjativ, që në thelb zbulon marrëdhënien specifike *të autorit me lexuesin e gjithkohshëm* si dhe të çdo kritiku me vetë Kadarenë.

#### Kufijtë e interpretimit

Moment i rëndësishëm në interpretimin e çdo veprë të Kadaresë do të ishte se nga cili pikëvështrim kryhet leximi kritik. Duke qenë se kritiku dhe teksti letrar janë dy 'krijesa' komplekse, ato sfidojnë njera tjetrën, dhe kjo bën që aspekti *gjuhësor, filozofik* dhe *psikologjik* të jenë baza e interpretimit. Sigurisht qasjet janë pa fund, por një ndër aspektet më thelbësore, i karakterit metodologjik, do të ishte fokusimi në boshtin organizativ të brendshëm: kush, realisht qëndron në plan të parë, realiteti apo reflektimi i autorit ? Sigurisht nuk janë të ndarë, por në strukturën e brendshme kuptimore, në atë që nuk është lehtësisht e veçueshme, këto dy pikënisje janë thelbësore, sepse ka autorë që nisin të rikrijojnë realitete të caktuara për të shprehur qëndrimin e tyre, kurse Kadareja ka një qasje më *universale*, për realizimin e së cilës ndërton 'realitete' të caktuara. Një konceptim artistik i tillë bën diferencën midis një autori të zakonshëm dhe një autori, mendja e të cilit lëviz përtej realitetit. Zbërthimi i këtij tipari të poetikës artistike të veprës së Kadaresë është thellim specifik i kufijve të procesit krijues në shtresat e nënshtresat e rrëfimit, kalim në një sistem superior, interpretim në rrethin e universit letrar, si pjesë origjinale e tij. Interpretimi do të kërkonte metodologjikisht dallimin midis kuptimit (autori) dhe interpretimit (kritiku), parë këto dy aspekte në plane të brendshme. Sigurisht asgjë nuk është e saktë, përfundimtare në raport me konvencionet interpretuese, por ajo që ka rëndësi është se interpretimi mund të konceptohet në disa plane : së pari për të identifikuar aspektet unifikuese të çdo veprë të Kadaresë, së dyti për të zbuluar se si pjesë të ndryshme formësojnë një tërësi organike, të ndryshme nga njësitë e tjera.

Ky proces nuk qëndron në vetvete, por, në fund të fundit, do zbulonte vetëdijen dhe produktin intuitiv të autorit. Edhe pse ai është plotësisht i vetëdijshëm për kuptimin e veprës së tij, vështrimi kritik do thellohej në *aspekte të pavetëdijes*, për të zbuluar diçka më thelbësore në procesin krijues. Kjo qasje

# A është përmbyllur studimi i identitetit dhe i psikologjisë së vlerës të veprës së Ismail Kadaresë?

Nga Floresha Dado



pak, ose aspak është prekur në studimet e derisotme.

Procesi i kufijve të interpretimit, duke qenë se ve përballë faktin objektiv 'tekstin' me aktin 'subjektiv', shtrun natyrshëm edhe çeshtjen se deri në ç'shikallë vepra përcakton kuptimin e vet dhe deri ku kuptimi përcaktohet nga kritiku. Kjo është dilema dhe sfida më e madhe e analizave të veprës kadareane. Fakti që fjala artistike përmban në vetvetë një referim të dyanshëm : *kush* rrëfen dhe *kujt* i drejtohet provokon në qasje më të thelluar vetëdijen/pavetëdijen krijuese të Kadaresë, si dhe vetëdijen/pavetëdijen perceptuese të vetë kritikut letrar.

#### Identiteti artistik

Pyetja më interesante që ka shtruar mendimi teorik është se çfarë mbetet në tekst mbas leximeve të shumta ? Ç'është thelbësore në këto përjetime artistike ? Kemi menduar se është e mjaftueshme të pranojmë se një kryevepër letrare është e pashtershme në lexime të vazhdueshme. Por, edhe kur flasim për veprat e Kadaresë mbetet një çeshtje e kaluar lehtëzi, e pa thelluar në analizat tona dhe kjo është : cilat janë tiparet që përcaktojnë identitetin artistik të njerës apo gjithë veprave ? Aq më tepër kur jemi përballë interpretimeve të ndryshme ? Pra, kritika jonë letrare vazhdimisht ka patur si çeshtje themelore shpjegimin e vlerave artistike të veprave, ndërkohë që çeshtja e *individualitetit të strukturës letrare* mbetet një ndër aspektet më të vështira, kryesisht me qasje profesionale, që do të shpjegonte pothuaj tërësinë e tekstit. Sfida e përhershme është edhe më tej : tekstet letrare të këtij autori sa janë dhe ku janë struktura të përcaktuara, të fiksuara, me boshllëqe, që lexuesi mund t'i plotësojë? Këto boshllëqe ndihmojnë apo vështirësojnë kuptimin e identitetit të tekstit ? Dhe më tej : çfarë është brenda, e qëndrueshme në tekst dhe në ç'masë është ndërhyrja, kontributi i kritikut ? Ky është një raport interesant që i vlen pikërisht përcaktimit të shkallës së identitetit të qëndrueshëm të veprës. Lind pyetja: mos vallë një strukturë e jashtme, e qartë, më e drejtpërdrejtë, thekson më tepër identitetin e tekstit ? Ndonëse, në vështrim të jashtëm, identiteti i një veprë të Kadaresë është ajo çka e bën një *tërësi të unifikuar*, thelbi i identitetit është më i

thellë, ku strukturat e brendshme kuptimore janë ato që formësojnë tipare të dukshme të njësisë së jashtme. Kjo do të thotë se dallimi i një veprë të veçantë të autorit tonë nuk është thjesht e veçanta e dukshme. Gjithashtu, po t'i referoheshim, Bartit mund të shtronim pyetjen : a duhet ta kërkojmë identitetin në diferencën e tij nga tekste të tjera ? (kjo qasje ndonëse duket se më shumë qëndron në planin e jashtëm, ka të bëjë me planin e brendshëm kuptimor). Këto dhe aspekte të tjera do të thonë se veprat e Kadaresë janë aty, për të na kërkuar të zbulojmë në thellësi identitetin krijues të këtij autori, i cili zgjon lexuesin jo vetëm një herë, por në mënyrë të përsëritur. Identiteti artistik ka një brendi shumë të gjerë, që rrok tërësinë e aspekteve të strukturës ideoartistike, prandaj mbetet fusha kryesore e interpretimit letrar.

#### Psikologjia e vlerës

Boshti i përqëndrimit në këtë aspekt thelbësor, por dhe të vështirë të interpretimit, ka të bëjë me një shkallëzim më të sofistikuar, më sfidues lidhur me raportin e *strukturave të brendshme poetike* dhe *strukturave psikologjike* të interpretuesit Nga ana tjetër, kjo lidhet ngushtësisht me çeshtjen se si realizohet përjetimi i eksperiencës artistike të shkrimtarit, duke u mbështetur në *hapësirën semantike* të veprave? Marrëdhënia që kritiku ndërton, nga njera anë me thelbin e fjalës, si mbartëse e strukturave të shumta kuptimore; nga ana tjetër me psikanalizën, si aspekti më i vështirë dhe më abuzues në zbulimin e psikologjisë së vlerës artistike dhe proceseve të brendshme misterioze të trillimit dhe imagjinatës krijuese të Kadaresë, është sa kompleks aq dhe e rëndësishme për t'u marrë në analizë. *Psikologjia e vlerës* ngërthen brenda vetes kombinimin e këtyre qasjeve ; nëpërmjet përmbajtjes së dukshme do mund të zbulohet përmbajtja e fshehur, ajo që përbën thelbin e përfshirjes së lexuesit në emocionet e vlerës artistike. Vepra e Kadaresë jep mundësi të shumta të raporteve psikologjike që kritiku mund të ndërtojë, përmes interpretimeve të tij me tekstin, ndonëse është tepër e vështirë që të realizohet bashkëqasja midis psikologjisë së personazhit, të tekstit dhe të vetë kritikut. Psikologjia e vlerës së veprës së Kadaresë nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me konstatimin e situatave, përjetimeve

emocionale, por shkon më thellë : për të zbuluar e interpretuar shkallën e përputhjes së përjetimeve të autorit me përjetimet e lexuesit. Shkalla e kësaj përputhshmërie është vlera themelore e veprave, sepse ajo kalon nga njohja e emocioneve të leximit, në rrjedhën e brendshme që lidhet me psikologjinë e autorit dhe kritikut. Pyetja qëndrore në gjykimin e krijmtarisë së Kadaresë do të ishte : *pse* vepra e tij krijon vlera ? Kjo ndodh kur midis dy psikologjive, të autorit dhe lexuesit, rrjedha është e njëtrajtshme, e pandërprerë, kur arrihet një lloj përshtatjeje midis tyre. Kritika sigurisht nuk e ka të lehtë, sepse çdo aspekt psikologjik, i pakapshëm drejtpërdrejtë, ka vështirësi specifike, por të depërtosh në psikologjinë e vlerës së veprave të Kadaresë, është thelbi i kuptimit të tyre. Sepse të kuptosh ç'është letërsia dhe të zbulosh vlerën e një veprë të caktuar, janë dy lloj qasjesh, ndonëse lidhen ngushtësisht me njera tjetrën. Raporti përbashkues dhe specifikues i tyre në analizën kritike, ndonëse e bën më të vështirë procesin interpretues, do të arrinte të depërtonte më mirë në kuptimin e aspektit psikologjik të vlerës. Zbulimi i *psikologjisë së vlerës* te veprat e Kadaresë ka të bëjë me çeshtjen se pse x-vepër është e mirë, apo ku dallon një roman nga tjetri, në vlerat e tyre.

A ka lidhje midis psikologjisë së autorit dhe psikologjisë së vlerës ? Janë koncepte të ndryshme. Hetimet psikologjike ose problemet e Kadaresë, janë pak të rëndësishme për treguar se kjo, apo ajo vepër e tij është e mirë. Ato thjesht, ndonjëherë, mundet të na ndihmojnë për të parë pse autori zhvillon tipare të caktuara në veprën e tij. Ndërkohë *marrëdhënia* midis psikologjisë së autorit dhe psikologjisë së lexuesit bëhet *shtrat i zbulimit të psikologjisë së vlerës*, e cila përfshin elementë të tjerë të strukturës së brendshme kuptimore dhe shumësisë semantike të fjalës dhe ligjëritimit tërësor. Nga ana tjetër psikologjia e veprës nuk ka të bëjë me renditjen, konstatimin e marrëdhënies midis aspekteve të psikologjisë së autorit dhe tipareve të veprës së tij, por me një plan tjetër, të padukshëm, emocional, që, siç thashë më sipër, përfshin brenda të njejtit perceptim autorin, tekstin dhe lexuesin. Është një marrëdhënie e pakapshme, që pavetëdijshëm ndikon në psikologjinë, përjetimet tona. Pra, në kuptimin më të thjeshtë, interpretimi i *psikologjisë së vlerës* së veprave të Kadaresë do të nisej nga parimi se shkrimtari mendon dhe ndjen me shpirtin e pasioneve njerëzore: hapja e një fushe specifike studimi mund të ishte pikërisht zbërthimi i kësaj lidhjeje jo të drejtpërdrejtë, por gati mistike, për të analizuar lidhjen midis imagjinatës së autorit dhe imagjinatës njerëzore, imagjinatës sonë që shfaqet në lexime të ndryshme. Ky aspekt mendoj se përbën një shtyllë të rëndësishme të kuptimit dhe vlerësimit të veprave të këtij shkrimtari të shquar.

#### Filozofia e veprave

Termi përfaqëson një koncept shumë të gjerë..., por që, sigurisht lidhet ngushtësisht edhe me thelbin e letërsisë, si një *krijim njohës, përgjithësues*, ndonëse realizuar jo përmes teorishë e konceptesh, por përmes trillimit, figuracionit emocional. Zakonisht, edhe kur është interpretuar vepra e Kadaresë, vemendja e kritikës është ngushtuar në *idenë* e tekstit të lidhur drejtpërdrejtë dhe ngushtësisht me subjektin narrativ. Pse mendoj që koncepti i *filozofisë së veprave* të këtij autori mund të trajtohet në një plan më të brendshëm dhe më universal ? Sepse universi i fiksionit artistik në veprat e tij, duke qenë përtej trillimit thjesht argëtues, intrigës së zakonshme dhe të pazakonshme, kapërcen, në disa vepra, përjetimin e zakonshëm, njohjen e drejtpërdrejtë...Sigurisht çdo vepër ka filozofinë e vet, të lidhur me një kategori personazhi, ambjenti, në kohë e hapësirë, por një shkrimtar i madh, si Kadare, në disa vepra të tij i jep *funksionit njohës përmasa universale*. Përse lexuesi i huaj e ka lexuar dhe vlerësuar veprën e tij? Pikërisht kjo është një piketë e rëndësishme, për të depërtuar në psikologjinë jo thjesht shqiptare, por mbarënjërzore, për të zbërthyer më në thellësi filozofinë universale që mbart brenda vetes vepra kadareane. Zbërthimi i këtij aspekti do të mund të zbulonte edhe filozofinë

tonë mbi jetën, mbi historinë, mbi fatin e njeriut, si dhe standartet e lexuesit shqiptar, përballë standartit që dëshmon vetë autori. Përktehen, botohen vepra t produkt thjeshtë imagjinatës apo të dukurive të zakonshme, shpesh me intriga interesante...Por ato i përkasin një lexuesi të një niveli ta caktuar, kurse vepra si “Kush e solli Doruntinën”, “Përbindëshi”, “Pallati i ëndërrave”, etj. i përkasin filozofisë universale, horizonti i tyre përfshin një rrokje më të thellë. Duke pranuar tezën se, në një kuptim, nuk është realja që preket në tekst, por tekstualizim i saj, një rindërtim i koduar në tekst, bëhet e qartë që horizonti ynë i vështrimit kalon në përmasa të tjera, për të kapur thellësinë e mendimit. Cila është pranëvënia apo diferenca që e përball fiksionin kadarean me karakterin e thellë universal ? Nëse qasja filozofike, në natyrën e letërsisë në përgjithësi, është konstatim i vjetër, interpretimi i veprave të veçanta mund ta zbulojë këtë tipar më kompleks në mënyrën unike të formësimit të brendësisë të një periudhe, të një ndjenje njerëzore, që, përtej realitetit shqiptar shkon drejt një hapësire më të gjerë...Thellimi në filozofinë e absurdit (“Viti i mbrapsht”), filozofinë e ringjalljes, të një botëperceptimi të ri për një botë me besë, për dëshirën njerëzore (“Kush e solli Doruntinën”), filozofia universale e mashtrimit (“Përbindëshi”) etj.etj. janë aspekte që i japin përmasa universale botës poetike të Kadaresë.

Në disa prej romaneve të tij autori e bën realitetin e së shkuarës më real dhe më imediat, bën që diferenca midis koncepteve *tani* dhe *atëhere* pothuaj të zhduket...kritika ndoshta mund të thellohet pikërisht në faktin se si shpirti i njeriut, jo vetëm shqiptar, është në vazhdimësi, një qasje e jashtëzakonshme filozofike, ajo prodhon iluzione të paqëna por thellësisht njerëzore; prandaj do të lindëte pyetja se si krijimtaria e këtij autori sfidon filozofinë, duke e përfshirë atë ? Vëzhgimi i trillimit dhe distancës trillues-artistike do të ishte, padyshim, mjeti matës i karakterit filozofik të një vepre, i vlerës universale të saj.

Flitet për problemin e gjithkohësisë së veprave letrare; ndoshta në këtë konceptim do të duhej të dallonim raportet reale midis kohësisë së përjetimeve të pandërprera. A lidhet kjo me një sistem dyvlerësh ? Nga njera anë ideja e realiteit të problematikës shqiptare, nga ana tjetër filozofia e gjithërrokëshme, që rrëmben shpirtin njerëzor në çdo kohë e hapësirë ?

##### Fokalizimi

Është një ndër aspektet shumë të rëndësishëm të poetikës së çdo vepre letrare, për të cilin flitet shumë pak. Kështu ka ndodhur edhe në shkrimet kritike mbi prozën e Kadaresë. Fokalizimi, ose fokusimi, nuk është thjesht pikëvështrimi i një personazhi apo momenti në strukturën e veprës. Dihet se në veprat e këtij autori ngjarjet paraqiten përmes ndërmjetësimit të disa elementeve, por thelbësore është një lloj pikëqëndrimi, ***vënia në fokus, vatërzimi*** i një tipari thelbësor të një personazhi, apo një dukurie. Ky pozicionim i rrëfimitarit nuk është thjesht një vështrim, por ***përqëndrim***, që mbart në vetvete një brendi të rëndësishme, thelbi i së cilës shtjellon e shtjellon vazhdimisht rrjetën narrative. Në prozën e Kadaresë fokusimi mund të shihet si në dallimin midis atij që sheh dhe atij që flet, si në rastin kur narrator i realizon të dyja. Te “Kronikë në gur” çdo gjë shihet me sytë e djalit-rrëfimtari, i cili shfaqet jo vetëm si objekti fokusues, që vëzhgon me përqëndrim të veçantë, por, njëkohësisht, tërthorazi bëhet edhe objekt fokusimi. Do të ishte interesante të analizohej se si në këtë roman gjuha jo vetëm përcjell perceptimet e personazhit (si fokusues), por njëkohësisht përmban shprehësinë e fëmijërisë (i fokusuar). Sigurisht fokalizimi duhet parë si pjesë e brendshme e narracionit, por qartësisht i dallueshëm prej këtij koncepti shumë të gjerë. Kjo çeshtje lidhet ngushtë me përcaktimin e identitetit të narratorit, si koncept qëndror në zbërthimin e tekstit narrativ që nuk mund të identifikohet me procesin e fokusimit. Në studime dhe artikuj të ndryshëm aspekti i fokalizimit nuk është përfshirë sa duhet në analizat narratologjike, duke lënë paksa mënjанë këtë element shumë të rëndësishëm të realizimit

të strukturës kuptimore. Në këtë drejtim ndoshta mund të shkohet më thellë, me qëllim që në korpusin prozaik të Kadaresë mund të dallohen lloje të ndryshme të fokusimit, të jashtëm (“Kronikë...”) ku personazhi kryen edhe rolin e fokusuesit edhe të narratorit, ku perceptimi dhe historia bëhen të njëkohshëm. Duke e parë fokusimin si një proces psikologjik, që varet nga mosha, statusi i fokusuesit, në vepra të Kadaresë mund të hetohet një rrjet kombinimesh, pikëvështrimesh të objekteve që fokusohen. Mund të vëzhgohen edhe fokusime të brendshëm, për shembull te “Pallati i ëndrrave”, ku fokusimi është brenda ngjarjeve të pasqyruara... Vepra e Kadaresë jep mundësinë e zbulimit dhe interpretimit të llojeve të ndryshme të fokusimeve, si për shembull psikologjik, perceptual apo ideologjik, apo fokusim të fiksuar, të ndryshueshëm dhe shumëplanësh...Akti artistik i fokusimit organizohet në mënyra të ndryshme në vartësi të pozicionit të rrëfimitarit dhe sidomos të specifikës dalluese të tij. Me

interes do të ishte edhe interpretimi i niveleve të fokusimit, që lidhen me momente të caktuar të zhvillimit të personazheve. Gjithsesi mendoj se vëzhgimi i këtij aspekti narratologjik nuk është trajtuar sa duhet në kritikën tonë, duke qenë tepër i rëndësishëm në realizimin e strukturave kuptimore të veprës kadareane.

##### Fjala brenda sferës së bashkëveprimit dialogjik.

Ky aspekti do të ishte më interesante i specifikës ligjërimore të Kadaresë. I vëzhguar në nivelin dhe thellësinë që përfaqëson studimi i fjalës brenda njësisë së bashkëveprimit dialogjik, do të krijonte një kuptim më të gjerë për vlerat ligjërimore dhe zbulimin e një raporti specifik që autori ynë ndërton me lexuesin. Fjala, duke qenë komunikim i drejtpërdrejtë, realizon vlerën më të madhe të saj në bashkëveprimin që mbart brenda vetes dhe midis dy aktiviteteve komunikues. Nëse teorikisht është thënë se letërsia është ‘praktikë e gjuhës’, në veprat e Kadaresë kjo praktikë është shumë interesante, por jo e studiuar sa duhet. Në çaspekt ? Në atë që dialogjizmi shfaqet së brendshmi, i padukshëm, në çdo ligjërim individual; në të vërtetë ai është më shumë i brendshëm, i nënkuptuar, sesa i drejtpërdrejtë apo i orientuar qartë. Sipas Bakhtin-it ‘marrëdhëniet dialogjike mund të përshkojnë së brendshmi të folurit, madje brenda fjalës individuale, për aq kohë sa dy zërat përplasen dialogjikisht’. Vepra e Kadaresë do ta provokonte studimin letrar duke hapur një fushë të gjerë e shumë të pasur, ku mund të hetohet se sa gjuha e veprave të tij u shërben dy folësve në të njëjtën kohë dhe shpreh njëkohësisht dy synime të ndryshme: synimin e drejtpërdrejtë të personazhit, që është duke folur, dhe synimin përthyes të autorit. A ka në prozën e tij brenda ligjërimit dy zëra, dy kuptime ? Ky është një aspekt thelbësor në përcaktimin e identitetit të veprës, sepse, siç dihet, gjuha e romanit nuk është një element që ka si qëllim thelbësor thjesht të përcjellë një ngjarje, por është vepra ajo që përfaqëson vetë gjuhën, se çdo vepër është strukturim fjalësh, fjalish, që kanë ekzistuar më parë por që rishfaqen në trajta e funksione të reja. Është pikërisht gjuha e Kadaresë që, në shtresat fjalore përcakton individualitetin e autorit.

Zbulimi dhe kuptimi i specifikave identitare të procesit gjuhësor të këtij autori, ndihmohet edhe nga teza sosyriane, sipas së cilës gjuha në letërsi zhvillohet mbi dy principe themelore: ai i *zgjedhjes* (pranimi i ngjashmërisë) dhe ai i *kombinimit* (rregullat e vazhdimësisë). Studimi i kombinimit të këtyre dy vlerave shprehëse do t'i jepte një perceptim të ri sistemit ligjërimitor, pasurive dhe befasive që i përcjell lexuesit. Krijimtaria e I.Kadaresë është ende një mister në zbulimin e tekstit si praktikë e përdorimit të kodeve të ndryshme ligjërimore, dhe sidomos në dukurinë e komunikimit brenda të nejtës strukturë fjalore. Ajo mbetet e pafundme në zbulimin ligjërimitor, përmes të cilit vetëdijshëm, por dhe intuitivisht, krijohen shtresëzime të brendshëm, origjinale dhe të paparashikueshëm.

##### Qasje gjenetike

Mbetet një aspekt i anashkaluar, që dëshmon një raport të diskutueshëm midis kritikës dhe sociologjisë. Vështrimi i veprave të Kadaresë në kufijtë e origjinës së saj, qoftë individuale, qoftë sociale, do të na nxishte për të hetuar lidhjen e strukturës së veprave të tij (“Dimri i vetmisë madhe”, “Koncert në fund të vitit” e të tjera) me strukturën mendore të pozicionit dhe grupit shoqëror të shkrimtarit, sepse në veprat e tij mendimi dhe realiteti përbëjnë një tërësi...Ne nuk mund ta mohojmë se veprat e këtij autori rrjedhin nga vetëdija dhe mendimi social i tij. Vizioni i këtij autori të madh mbi realitetin shqiptar, duke qenë individual, mbart me vete edhe një vetëdije të re të shoqërisë, të momentit të kohës. Prandaj qasja gjenetike nuk ka të bëjë thjesht me hetimin e origjinës sociale, por me një tërësi faktorësh që ndikojnë së brendshmi në intuitën dhe vetëdijen e autorit. Nëse në veprat e tij hasim pikëpamje të karakterit përgjithësues, universal, është metoda gjenetike që u jep kuptim ideve dhe pothuaj gjithë strukturës mendore të autorit. Lidhja midis strukturës mendore të tij dhe strukturës ligjërimore narrative është, padyshim, një hetim jo i kollajtë, por tepër i rëndësishëm për të depërtuar në origjinën e formësimit letrar. Thelbin e kësaj qasjeje do të mund ta shihnim jo thjesht në aspektin se sa i pasqyron autori realitetet shqiptare (ky do ishte thjesht një sociologjizëm vulgar), por në konstatimin e si aspekte të tilla të vetëdijes krijuese, si letërsitë e ndryshme, teoritë filozofike, njohjet kulturore autentike dhe botërore, trashëgimitë kulturore etnike e ballkanike, etj. etj. lidhen me njera tjetrën dhe kanë ndikuar në procesin e të menduarit dhe imagjinatës krijuese në veprat e autorit. Qasja gjenetike do të mund të aplikohej jo për të gjetur vartësi apo shkakësi të drejtpërdrejtë të autorit, por për të ndjekur zhvillim të tyre në horizonte origjinale krijuese, do të mund të provonte distancën që krijuesi vendos me dukuritë sociale që mbështesin veprat e tij. Është e vërtetë që vetëdija e shkrimtarit tonë i ka paraprirë vetëdijes së shoqërisë në kohën e botimit. Një qasje e tillë, ndonëse do të qëndronte në planin poetik, krijon një raport shumë të rëndësishëm me lëvizjen e mendimit dhe ndjeshmërisë historike. Kjo qasje në plan të gjerë zbulon vlerën themelore të intuitës krijuese të autorit, duke i dhënë një shtrirje më të gjerë identitetit në kuptimin e brendshëm të veprave.

Mendoj se kjo metodë studimi, ndonëse e nënvlerësuar, do të ishte shumë interesante për të depërtuar në strukturën e mendimit të Kadaresë, çka do të ndihmonte për të interpretuar shumë aspekte të poetikës së brendshme të veprave.

##### Qasje krahasimtare

Në vështrim të parë duket më e përdorura tek studiuesit tanë, madje më e lehta, por koncepti i metodës krahasimtare nuk i referohet thjesht përqasjes, ndikimit apo huazimit, por shpreh një përmbajtje më të gjerë metodologjike, përtej planit të sipërfaqshëm. Është shumë interesante pikëpamja që i jep një shtrirje të gjerë konceptit krahasimtar për t’u thelluar në procesin e *vazhdimësisë* së letërsisë së madhe. Pra është ideja që kjo metodë krahasimtare të hapë rrugën për të provuar jo thjesht ndikimet dhe afërsitë, por aspektet më të thella që e afrojnë por dhe e dallojnë Kadarenë krahasimit me autorë të mëdhenj të letërsisë botërore. Kjo metodë nxitet nga orientimi metodologjik se si mund të hetoen lidhjet e fshehta, përtej ngjashmërive, ndikimeve, rimarrjeve...për të shkuar në thellësi të origjinalitetit të metaforës kadareane. Metoda krahasimtare mund të ndalet në raportet e veprës së Kadaresë me mitologjinë ballkanike, kjo jo thjesht si konstatim, por thellim në filozofinë e përjetimeve krijuese artistike e ideore të autorit, si përpjekje për të shkuar drejt thellësive, drejt intuitës së brendshme të Kadaresë. Synimi ynë mund të jetë edhe prirje për të zbuluar lidhjet e pavetëdijes së autorit me herojtë e largët, të një botë imagjinare dhe me autorin magjik, të panjohur të baladave shqiptare e ballkanike. Kjo qasje shkon drejt kuptimit të zhvillimit të brendshëm të vetë letërsisë si proces i vazhdueshëm marrëdhëniesh dhe zhvillimesh të reja.

Kuptohet, pra, ç’përmasë të re shkencore merr kjo metode studimi, përtej “thjeshtësisë”, në dukje, të aplikimit të saj, përtej reduktimit në skematizëm konstatimesh të marrëdhënieve të dukshme, çka ndodh jo rradhë në kritikën dhe studimet tona.

##### Qasje intertekstuale

Kjo çeshtje shtron para kritikës kuptimin e letërsisë në marrëdhënie me letërsi dhe forma të tjera kulturore, madje edhe në kontekstin e studimeve ndërdisiplinare. Kjo do të thotë që dhe krijimtaria e Kadaresë do të studiohej duke njohur sistemet, kodet, traditat e krijuara nga vepra paraardhëse. A do ja vlente që kjo krijimtari të analizohet edhe në prizmin interesant të intertekstualitetit , i cili shënon një vështrim të ri të kuptimit të veprave, si rrjedhim edhe të individualitetit të shkrimtarit ? Cila do ishte arritja thelbësore e kësaj qasjeje të re ? Ka akoma shkrime ku ky aspekt i interpretimit të letërsisë barazohet me nocionin e metodës krahasimtare. Por ndryshimi thelbësor ka të bëjë jo thjesht me krahasim ngjashmërishë, apo huazime personazhesh e motivesh, jo thjesht me *ndikim letrar* por me një tipar të brendshëm të thelbit filozofik e historik të letërsisë, me lëvizjen që realizon ajo nëpër vepra të periudhave të ndryshme historiko-letrare. Dihet se në disa vepra të Kadaresë (p.sh.“Përbindëshi”) përqasen në përmasa e marrëdhënie të ndryshme, motive apo personazhe të letërsisë së antikitetit dhe më gjerë... A duhen kuptuar thjesht rimarrje ? Këto nuk janë ndikime, por ajo që do duhej të sqarohej do të ishte: në ç’përmasa kuptimi i tyre është “brenda” dhe “jashtë” tekstit. Sigurisht një shkrimtar i madh, si Kadare, me intuitën e vet ndërton kuptimin më shumë brenda, çka bën dallimin me autorë të tjerë, të çdo lloj letërsie.

Kritika e specializuar ka dhënë modelin e zëvendësimit të nocionit ‘ndikim’ me nocionin e ‘intertekstualitetit’; çka do të thotë se kalohet nga një huazim aspektesh të modeleve, tek një konceptim origjinal i marrëdhënies së veprës me krijimtari të trashëguara. Ajo që mund të tentojmë të provojmë është se sa veprat e Kadaresë janë një proces i pavarur, por edhe sa janë *lëvizje midis teksteve*. Sigurisht kjo qasje nuk është e lehtë dhe drejtpërdrejtë e konstatueshme, megjithatë i jep një shtrirje tjetër interpretimit të korpusit kadarean. Metodologjikisht do të kishim një qasje sipas dy konceptimeve: në *raportin horizontal*, ku romanet e Kadaresë i përkasin autorit dhe lexuesit, si dhe në *raportin vertikal*, sipas të cilit çdo vepra ka marrëdhënien e vet me korpusin letrar të mëparshëm. Kështu, në mendimin tonë kritik do të vinte më i shtjelluar interpretimi intertekstual i krijimtarisë së këtij autori si mënyrë tjetër leximi, që s’duhet të identifikohet as me medodën krahasimtare as me atë gjenetike.

##### \*\*\*

Nëse do bëja një tipologjizim të interpretimeve që janë bërë rreth veprës së I.Kadaresë mund të dalloj : *metodologjinë strukturore*, që studimin e romaneve të Kadaresë e fokuson në ndryshimin dhe lëvizjen e strukturave semantike; *metodologjinë shkakore dhe të origjinës*, që interpretimet i lidh me shkaqe historike e sociale, me ndikime të ndryshme letrare e joletrare; dhe *metodologjinë receptive*, e cila, ndonëse vlerëson aspektin e ndryshimeve në format letrare, përqendrohet te roli i lexuesit. Vlera e këtyre qasjeve qëndron në faktin se ato konfirmojnë marrëdhëniet specifike që mund të ketë çdo kritik e studiues me vetë letërsinë. Prandaj, shtylla themelore në të gjitha qasjet e kritikës së sotme do të ishte kuptimi i thelbit të *filozofisë së interpretimit* letrar.

Një teoricien ka thënë : ‘arti është më i madh se interpretuesi i tij’. Asnjë kritik nuk do të mundëte të zbulojë në mënyrë të plotë dhe shtrruese tërësinë e vlerave të korpusit artistik Kadaresë. Ne mbetemi vetëm tentativa të pjesëshme. Sigurisht, ka standarte të koncepteve dhe vlerave artistike dhe interpretim ynë nuk mund të jetë amatorizëm. Ama, jemi të vetëdijshëm, rreth horizontit të gjerë poetik të veprës së tij. Mbetet i papërfunduar ! Prandaj I. Kadare, si çdo autor i madh, është sfidë e përhershme për studimet tona letrare.

Dita e parë e korrikut të një viti më parë zbardhi me lajmin e ikjes nga kjo jetë të shkrimtarit më njohur shqiptar të të gjitha kohëve, Ismail Kadare. Përveç shkrimtari më i njohur ai qe dhe figura më reprezentative e kulturës shqiptare në botë. Fama e tij nuk mbuloi veç hapësirën e letërsisë shqiptare — ai shpesh u konsiderua edhe si njëri prej shkrimtarëve më të njohur botërorë të shekullit XX. Veprat e tij jo rrallë janë krahasuar me të Franz Kafka-s, Georg Orvell-it, Stefan Zweig-ut, James Joyce-it etj.

Si sot e një vit më parë lajmi për vdekjen e Kadaresë në botën shqiptare erdhi si një nemitje zëri, si një ndalje fryme. Fjala vdekje nuk u kuptua plotësisht; mendja përpiquej ta mohonte, duke shpresuar se ishte një gabim, një keqkuptim ... sepse, ndonëse kishte hyrë në moshën e pleqërisë së madhe, nuk ishte dëgjuar se ai e kishte zënë shtratin e vdekjes.

Por, ndërsa burimet e konfirmuan lajmin, realiteti nisi ngadalë të rëndoje me një qetësi të frikshme.

Vdekja e Kadaresë u konsiderua si humbja më e madhe e kulturës shqiptare. Kontributet e tij u vlerësuan të pakrahasueshme në kontekstin letërsisë shqiptare. U tha se kjo vdekje ishte edhe fund i “epokës kadareane”, duke lënë një boshllëk të pazëvendësueshëm në peizazhin letrar e kulturor shqiptar.

Për shqiptarët vdekja e Kadaresë qe më shumë se një vdekje, sepse për ta ai qe më shumë se një shkrimtar.

Gjatë ditëve përkujtimore për të u ripanë e u rivlerësuan: skicat e tregimet, novelat e romanet, poezitë e poemat, dramat e skenarët, veprat eseistike e publicistike, letrat e polemikat, intervistat e paraqitjet publike etj.

Duke i rikujtuar veprat e hershme me të cilat i kapërceu kufijtë e botës shqiptare, si romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, e deri te njëri prej librave më të fundit, *Kur sunduesit grinden, Kadareja u vlerësua si “zëri i parë” i ndërgjegjes shqiptare në botë. Dikush madje tha se, përveç si zë i parë emri i tij paraqiste edhe simbolin e rezistencës kulturore e intelektuale të një vendi dhe të një populli që për më shumë se gjysmë shekulli iu nënshtrua njërit prej regjimeve më të egra totalitare të shekullit XX.*

Gjatë ditëve përkujtimore për Kadarenë dikush tha se ai erdhi në letërsinë shqipe si emancipuesi më i madh i saj. U tha gjithashtu se në veprat e tij ai tregoi aftësi të jashtëzakonshme për t’i ndërthurur dilemat e njeriut shqiptar me ato universale; përmes kanonit letrar ai e ndërtoi narrativën më të bukur të historisë së trazuar të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

\*

Ja një analepsë e shpejtë kadareane:

Romani i parë *Qyteti pa reklama* (1959), erdhi si i pikur nga qielli. Kishte një formë dhe një përmbajtje disi aliene; i kapërcente telat gjemborë të letërsisë së realizmit socialist — letërsi që kishte frymë thellësisht propagandistike; që promovonte optimizmin e detyruar; letërsi që e shndërroi njeriun në objekt — i gatshëm të vetësakrifikohet për qëllime “të mëdha” ideologjike.

Më pas zbriti *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Ky roman e bëri letërsinë shqipe pjesë të paradigmes antifashiste të letërsisë botërore të shekullit XX. Në romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, ashtu si te romanet distopike të shekullit XX, ndrynte fund e krye fytyra e vdekjes, shprehej hapur kotësia e luftës, si dhe zbuloheshin mënyrat se si regjimet i shfrytëzonin jetët njerëzore për t’i realizuar qëllimet e tyre politike e ideologjike.

Pas *Gjeneralit* ... doli *Përbindëshi*. Ky roman ishte një përshkrim surreal mbi natyrën ricikluese dhe metamorfizuese

Jeta tokësore e Kadaresë u shua një vit më parë, por letërsia e tij mbetet e pavdekshme — monument i triumfit të lirisë mbi përpjekjet tiranike për ta heshtur dhe shkelur shpirtin e lirë njerëzor.

# KADARE — EPOKA QË VAZHDON

Nga Arben Veselaj

të frikës dhe ankthit. *Përbindëshi* u shfaq në botën shqiptare sa çel e mbyll sytë. Në ngjarjen e këtij romani koha mitike me kohën historike disi kishin një marrëdhënie ndërvarësie të pashkëputshme. Në këtë roman sistemi totalitar, veç tjerash, provon të vë kontroll edhe mbi dashurinë. *Përbindëshi* u “zhduk” shpejt, si një yll me bisht, duke e bërë Kadarenë një shkrimtar të ndaluar.

Më tej magjepsi romani autobiografik e fantazmagorik *Kronikë në gur*. Me personazhet e çuditshme që mbinin si hije në sokakët e gurtë të Gjirokastrës, Kadareja e bëri letërsinë shqipe pjesë të letërsisë së realizmit magjik.

Duke e kërkuar gjenezën e hakmarrjes tek tragjeditë e mëdha që krijuan babazotët e letërsisë që prej Eskilit e Sofokliut, e deri te Shakespeare e Corneille, te romani *Prilli i thyer* Kadareja e zbuloi thelbin e kompleksit të gjakmarrjes shqiptare, duke e krijuar sivëllain e Hamletit në kontekstin shqiptar — Gjorg Berishën — një vrasës i pavullnetshëm, i zënë në leqen e lashtë të hakmarrjes. Në këtë roman gjaku nuk është thjesht një akt personal hakmarrjeje, por një ritual i përgjeshëm që ushqen nderin e brezave njerëzor.

Pas *Prillit të thyer* Kadareja u fut në ciklin e gjatë e të mundimshëm të shkrimit të romaneve të ashtuquajtura “sovjetike”

dhe “osmane”. Në fillim erdhi *Dimri i madh* — një kërkim i thellë historik, politik e psikologjik mbi gjendjen e ankthshme të shoqërisë njerëzore. Vet Kadareja kishte thënë dhe shkruar disa herë se ky roman ishte kundërvënja e tij më e madhe letrare ndaj regjimeve totalitare.

Më pas Kadareja iu rrek botës osmane. Në vargun e “korpunit osman” *Pallati i ëndrrave* e përshkruan më së miri makthin e shtetit tiranik. *Pallati i ëndrrave* qe vepra kryesore rreth së cilës edhe kundërshtarët më të mëdhenj të Kadaresë pajtoheshin me faktin se një pjesë e letërsisë së tij ishte disidente.

E cilësuar shpeshherë si kryevepra e Kadaresë, *Pallati i ëndrrave* ishte një hipotezë mbi historinë e viktimave të një vendi me kontroll të hekurt mbi shtetasit. Kadareja ishte akuzuar se me këtë vepër kishte bërë aluzion kundër vet shtetit dhe rendit socialist shqiptar. Ai kishte projektuar brenda një vepre letrare një ngrehinë osmane të shekullit XIX (Tabir Sarajin) që ngjante me ato të institucioneve të Shqipërisë komuniste të shekullit XX. Ajo ngrehinë synonte të mbante nën kontroll jo vetëm veprimet e rëndomta të shtetasve, por edhe ëndrrat e tyre.

Pak vite më vonë Kadareja “verboi” me *Qorrfermanin*-n. Kjo novelë e përshkruante paranojën që kishin sistemet tiranike,

diktatoriale dhe totalitare ndaj shikimeve kritike. Këtu Kadareja ia zbuloi fytyrën më groteske tiranisë; frika dhe ankthi nga urdhri mbretëror (qorrfermani) e kishin shpërhytyruar njeriun deri në atë shkallë sa ai me “kënaqësi” e flijonte edhe dritën syve në “altarin” e stabilitetit dhe të mirëqenies së perandorisë.

Vështirë është të gjendet një vepër e dytë si *Qorrfermani* në krejt letërsinë me kumt antitotalitar, që i godet më “bukur” metodat e sistemeve shtetërore që ndiqnin dhe persekutonin zërat kritikë. *Qorrfermani* krejt natyrshëm na sjell ndër mend esenë e George Orvell-it, *Letërsia dhe totalitarizmi*, në të cilën thuhet se shteti totalitar “kujdeset” që shtetasve t’iu sigurojë edhe një kod sjelljeje. “Shteti totalitar ju ndalon të shpreheni, madje edhe të mendoni; gjithashtu ai ju imponon se çfarë duhet të mendoni. Shteti totalitar krijon një ideologji për ju, përpiket ta qeverisë jetën tuaj emocionale, si dhe të sigurojë një kod sjelljeje për ju”, kishte shkruar George Orvell.

Kryevepra e humbjes, *Eskili ky humbës i madh*, na shpërfaq dialektikën e tragjedisë — edhe si formë letrare, por edhe si gjendje e përhershme njerëzore. Kadareja në këtë ese na rrëfen se, për ironi të fatit edhe një humbës mund të mbetet i pavdekshëm. Këtu Eskili na shfaqet si një dishepull i ringjallur nga një epokë e harruar, që nuk i kupton më heroizmat e kohës së tij. Ai na zbulohet si një humbës, jo nga mungesa e talentit, por nga natyra shpërhytyruese e historisë. Me këtë vepër Kadareja na mëson se madhështia shpesh nuk është e mjaftueshme për të shmangur harresën.

Në ngryse të shkrimtarisë së tij Kadareja edhe një herë iu rikthye “Kronikës gjirokastrite”, duke e “shtruar” *Darkën e gabuar*, në një “kryevepër të pagabuar”. Rrëfimi shumëplanësh na zbulon fillin e një komploti planetar, versioni më tragjik i të cilit ngjante në periferitë më të harruara të Evropës. Në skenën e historisë së gjysmës së shekullit XX na zbulohet një prej ultimatumave më të frikshme, një prej pritave më të pabesa, një prej hapsanave më të errëta. Dy diktaturat e shekullit XX — fashistja dhe komunistja — pleksen në këtë roman si në gostinë makbethiane. Historia e dy njerëzve (dy popujve), që ritakohen pas shumë kohësh në një darkë të pazakontë, del si një metaforë e përplasjes së madhe mes botëve. Në këtë roman gjuha e Kadaresë është njëfarë enigme politike; këtu frazat bartin kuptime të shumëfishta dhe realiteti përthyeret përmes alegorisë. Te *Darka e gabuar* pushtimi gjerman i Shqipërisë nuk kuptohet si një akt agresioni, por si një lojë inteligjente, sepse forca ushtarake demonstron si një ritual.

Temën e madhe të letërsisë — opozicionin mes shtetit dhe individit, apo më ekzaktesisht marrëdhënien shkrimtari — diktatura, Ismail Kadare e ka trajtuar në shumë vepra të tij, por me librin *Kur sunduesit grinden*, ai ia ka vënë pikën opusit. As krejt tregim, as krejt ese, as krejt roman, por një meditim krejt i veçantë letrar, ky libër na shfaq një botë ku zhvillohet lufta



e lashtë midis dy të kundërtave: lavdisë së shkrimtarëve, në njërën anë, dhe mizorisë së diktatorëve, në anën tjetër. Në këtë libër të çuditshëm Kadareja shpërfaq natyrën e vërtetë të tiranive, ku armiku më i madh i një tirani është një tjetër tiran. Ky libër supzhanror është një alegori mbi natyrën e paqëndrueshme të fuqisë, ku sunduesit, pavarësisht pushtetit që zotërojnë, janë gjithmonë të cenueshëm.

\*

Asnjëri nga shkrimtarët e vendeve të ish-blokut komunist nuk ia ka dalë më mirë se Ismail Kadare t'i lexoj nën rreshta mesazhet e shkrimtarit dhe filozofit gjerman, Bertolt Brecht. Në esenë *Pesë vështirësi për ta shkruar të vërtetën*, Brecht-i shkruan se edhe në kushtet më të vështira të diktaturës një shkrimtar i mirë mund t'ia dal mban ta shkruaj dhe ta përhapë të vërtetën. Si rrallë ndonjë shkrimtar tjetër Kadareja e përdori gjuhën e fshehtë të letërsisë për ta koduar të vërtetën, si kundërvënien e parë kundër shtypjes dhe tiranisë.

Edhe poeti i “Burgologjisë” shqiptare, Visar Zhiti, duke përsiatur për “dukurinë Kadare”, konsideron se Kadareja e shkroi veprën e tij në zemër të diktaturës dhe errësisë, duke e ruajtur qetësinë e brendshme. Sipas tij, letërsia është një prej shenjave të jetës njerëzore që reziston. “Qetësia e brendshme është vetë liria e shkrimtarit. Është letërsia ajo që e çon atë drejt lirisë dhe jo liria drejt letërsisë”, ka shkruar Zhiti.

\*

Kadareja nuk ishte thjesht një mjeshtër i fjalës, por dhe një arkitekt i mendimit. Vepra e tij letrare nuk është sall një pasqyrë e shpirtit të tij, por reflektim kompleks i botës shqiptare me universalen. Falë veprave të tij, Shqipëria dhe shqiptarët u futën në hartën e letërsisë botërore, dhe në përgjithësi kulturës botërore. Gjenialiteti i tij lindi ashtu siç lindin diamantet: nën presionin e madh tektonik të diktaturës komuniste. Fuqia e mendjes së tij natyrshëm i kapërceu kufijtë e konvencave dogmatike të kohës, duke e ripërcaktuar vetë natyrën e letërsisë. Kadareja nuk qe thjesht një përshkrues i botës shqiptare, por dhe një kritik i madh i saj. Ai shpesh e përballi botën shqiptare me të vërtetat e pakëndshme; u dha zë historive të pathëna, duke sfiduar t'ia ndryshonte veset fatkeqe.

Ismail Kadare, si rrallë ndonjë shkrimtar tjetër, e mundi diktaturën. Edhe pse jetoi dhe shkroi në një vend të mbyllur, siç ishte Shqipëria socialiste, arriti t'i kap majat e lavdisë letrare, duke u bërë shkrimtar i njohur përtej kufijve kontinentalë e oqeanikë. Për të gjallë rrëmbeu çmimet më prestigjioze të letërsisë në botë — përveç çmimit Nobel — në listën pritjes së të cilit qëndroi për më se gjysmë shekulli. Sa qe gjallë e dinte se Nobel-in nuk do ta merrte, por për këtë nuk ndihej aspak keq, përkundrazi.

Edhe pse kanë kaluar një vit qëkur ai nuk është më në mesin e të gjallëve, vepra e tij është po aq e gjallë — në mos edhe më e gjallë seç ka qenë. Veprat e tij jo vetëm që vazhdojnë ta forcojnë identitetin shqiptar, por dhe ta përmbushin shpirtëroren me fisnikëri — me atë fisnikëri që vetëm magjia e letërsisë e përmbush.

Që nga kohët homerike letërsia ka dëshmuar lindjen dhe vdekjen e shumë mendjeve të jashtëzakonshme, të cilat duke i lënë shenjat e tyre, e kanë bërë botën më të bukur e më fisnike. Këta janë shkrimtarët e mëdhenj, shkëlqimi i të cilëve është aq i rrallë dhe zërat e të cilëve janë aq të thellë, saqë duket se shfaqen vetëm një herë në qindvjeçar.

# Me fat që e patëm pranë në jetën tonë

Nga Sadik Bejko

Po të mblidheshin bashkë ata njerëz që i qëndruan ngushtë e pranë deri në ditën e mbrame Ismail Kadaresë, veç familjes, do të ishin dhe një grusht shokësh e miqsh.

Në radhë të parë, ishte Helena, zonja e tij.

Kadareja deri në fund ishte i rrethuar me njerëz të dashur.

E them këtë se për ditë dëgjojmë për largime nga kjo jetë të artistëve me famë a të personaliteteve më të shquara politike, të cilët shuhen në vetmi a në rrethana krejt enigmatike...

Kadarenë e deshën miqtë dhe ai që i rrethuar me kujdesin e tyre gjer në fund. Siç e përmenda, Helena, familja, botuesi i Onufrit dhe një sërë miqsh të tjerë. Kjo shfaqje kujdesi e përkushtimi u bën nder atyre, po i bën nder dhe kulturës shqiptare.

Jeta mbahet në fije të holla. Arteret e qafës që dërgojnë gjakun në tru, janë fije të holla e të padukshme. Po bllokimi, këputja e tyre vdes trurin, këput përfundimisht jetën e njeriut.

Këto fije janë kujdesi për atë që duam, besimi te njeriu në krahun tonë, integriteti i një marrëdhënieje që e dëshiron përcjelljen e miqësisë, të mirësisë, por dhe kthimin e ndërsjellë midis tyre. Kadareja kishte nevojë për miq, për njerëz, për ngrohtësi, empati.

Ata që ishim pranë tij, e ndoqën largimin e tij gradual. Në fillim ai iku nga Franca. Hoqi dorë nga të shkruarit. Një operacion... një pandemi me pasojë të rënda psikofizike.

Dikur ngjiteshin në shëtitjet tona deri në majë të kodrave rreth liqenit të Tiranës. Ngecëm... shkonim deri te gjysma e kësaj rruge. Më pas nuk ecnim as dy-tre qind metra. Pastaj ai nuk donte të lëvizte asnjë hap. Madje me zor e nxirrnim nga shtëpia e tij. Ai po rrëgohej si një zjarr që futet poshtë hirit të tij dhe nuk do ta ndezin

përsëri. Bujar Hudhri dhe Çerçiz Loloçi e shoqëronin përditë. Kur unë mungoja ai më telefononte të ishim bashkë në kafe.

Kur e sillnim të hyrja e pallatit kishim përshtypjen se ne po mbanim në duar një vazo të shtrenjtë kristali që çast pas çasti mund të na thyhej në duar. Trupi i tij me kohë nuk donte t'u bindej lëvizjeve të domosdoshme që kryen për çdo ditë një njeri. Vazoja e kristaltë e jetës poshtë këtij trupi kishte marrë plasaritje të pariparueshme dhe thyhej sot, thyhej nesër. Por këtë as e besonim dhe e shtynin tej... ne do takonim atë përsëri e përsëri. Sa dhe ditën që morëm lajmin e fikjes së tij, nuk donim ta besonim. Fijet e holla që mbajnë jetën, më së fundi ishin këputur.

Ishte një jetë aq e pasur, aq e begatë me aq shumë prurje në kulturën shqiptare dhe atë botërore, sa asnjë shqiptar tjetër përpara tij. Por dhe kjo pasuri e begati e jashtëzakonshme nuk e mbajti dot për këndej në jetën e gjallë. Ai duhet të shkonte. E kishte kryer si një burrë i madh misionin e tij. Ai i dha nder profesionit të tij, nderin e një shkrimtari të madh që i shërbente për ditë talentit, pasurimit dhe mbrojtjes së paprekshme të detyrimeve që të vë mbi shpatulla një profesion e tillë.

Ne që ndoqëm ikjen e tij, mund të kemi qenë nga ata që ndoqëm lartësimin e tij. Ashtu si ai u tërhoq nga ngjitja në kodër, dikur ai u lartësua prej nesh, nga mjediset tona të rëndomta. Jeta e tij e dytë prej shkrimtari, romancieri e çonte në maja që ne nuk e arrinim dot.

Por nuk u shkëput prej nesh. Diku na kërkonte mendim për një vepër të cilën kritika zyrtare po ia kryqëzonte. Ne ia miratonim atë vepër. Ai kish nevojë për një reference nga njerëz pranë tij. Diku kërkonte mendim për një poemë që në të ardhme

mund ta dëmtonte, por ne i thoshim që “për shumë arsye” bënte mirë ta botonte. Ai ishte njeriu që të peshonte e të përshkonte tej e etj më vështrimin e tij. Cilat janë këto shumë arsye, pyeste. Duhet të merreshim vesh me nëntekst. Heshtnim... i thoshim “dihen shumë arsyt”.

Kishte raste kur ai kritikohej rëndë... ndonjëherë të ngjante se vërshtëllenin presa kamash në qafën e tij. Ai vinte të ne në Gjirokastrë, në Berat. Si vëllai i madh që ka marrë goditje që dhe boksierët e mëdhenj mund t'i hedhin knockdaën; ai donte afrimin tonë drejt plagëve të padukshme të tij. E rrethonim. Nuk flisnim. E dinim, më shumë e ndienim, që vëllai ynë kishte një problem të madh me shtetin. Kohë paranojash, kohë që hante kokë ministrash, kryeministrash. Nuk mund t'i denim të gjitha. Ai ishte prej kohësh në sfera të tjera. Ne vetëm mund ta merrnim me mend që vëllai ynë i madh i ka punët pisk. E rrethonim. Një drekë, një darkë. Në mëngjes kafe. Një takim letrar me dashamirë të letërsisë tij. Kaq mund të bënim. Të heshtnim. Ta donim me heshtjen tonë mirëkuptuese. Mund të ishte martiri. Në një kohë që duhet të ishte më kurorën e dafinave, të mirënjohje, të dashamirësisë mbi krye.

Miqësi të tilla të farkëtuara në kohë kur ngarkesa elektrike shkëndijonin e mund të shkrinin linjat e tensionit të lartë, i mbetën kohës.

Thanas Dino nga Gjirokastra më pyeste për të dhe pastaj më këshillonte: shiko, se ai njeri është i pazhbirilueshëm. Mos i beso. Ai ka rezerva. Thotë nuk shkruaj, por kush e di ç' fsheh në arkat, në arkivat e tij.

Ne nuk e besonim se si ai nuk po shkruante më. Nuk e besonim... dhe kur më së fundi ai po thoshte se nuk i pëlqente asgjë nga jeta.

Ishte njeriu i sfidave të mëdha. Ai do t'ia hidhte moshës, sëmundjes, do t'ia hidhte dhe asaj që donte t'i këpuste arteret që çojnë gjak në zemër.

Por në ditë fjet u këputën. Jeta edhe një njeriu të madh si ai, mbahet në fije të holla.

Ato fije të tjera të miqësisë të mirëkuptimit, të besimit, të mirëqenies që të jep shoqërimi me njerëz, të zbulurimit të jetës nga që ke pranë, nga njerëz që kurrë nuk të lënë në baltë, këto fije ende mbeten të forta tek ne që në një jetë e patëm për fat të jemi pranë tij.



Kam patur fatin që në shtegtimet e mia nëpër rrugët e Parisit të njoh dhe të shkruaj për itineraret parisiane të shkrimtarëve të shquar që kanë jetuar e krijuar në Paris, jo vetëm ata francezë si Hygo, Balzak, Prust, Bodler apo më pas Apoliner e Kamy, por edhe shumë shkrimtarë të tjerë amerikanë (veçanërisht ata të « brezit të humbur »), latino-amerikanët me Asturias, Sabato, Kortazar etj. e gjer skandinavë e aziatikë që për shumë vite kishin jetuar në Parisin e tyre për çka përshkruaj jetën dhe gjeografinë e tyre parisiane në librin « Parisi letrar », në « Mbresa parisiane » apo në « Bohemë anglosaksonë në Paris ». Janë gjurmët që kanë lënë Heminguei, Fitzgerald, Dos Passos, Becket, Xhois, apo Bohres me hotelin e tij të përhershëm në Rue des Beaux Arts apo Sabato me “Hotel Madison”. etj. e shumë të tjerë. Edhe pse vitet e fundit të jetës së tij Kadare u largua nga Parisi për të jetuar përfundimisht në Shqipërinë e tij (çka nuk arriti ta bënte Jusuf Vroni që aq shumë e dëshironte), përsëri Parisi ishte i përhershëm dhe i qenësishëm brenda tij, në ndjesitë dhe letërsinë e tij, apo kujtimet parisiane për të cilat shkroi dhe në librin « Mëngjeset në Kafe Rostand », e ku akoma më shumë, në librin e saj “Kohë e pamjaftueshme”, Helena Kadare me një mjeshtëri të veçantë, na dha atë jetë të plotësuar të Kadaresë, rrethuar me ngjarje, miq e shkrimtarë të shquar të botës si Kundera, Jonesko, Umberto Ecco, me intelektualë të mëdhenj si Jacques Attali, filozofi Edgar Morin, me procesin krijues të përditshëm dhe jehonën shqiptare, gjurmë që do të evidentohen së afërmi duke filluar me vendosjen e një pllake përkujtimore në 63, Boulevard Saint-Michel, aty ku familja Kadare jetoi për një kohë shumë të gjatë.

Vendosja e kësaj pllake do të jetë një nismë e shoqatës së sapo krijuar në Paris « Miqtë e Ismail Kadaresë » e duke vazhduar më pas me evidentimin e një jete që do të jetë e pranishme në këtë Paris letrar por që ka lidhje dhe me politikën shqiptare, veçanërisht në kohët e fundit të viteve 80’, me ndryshimet politike dhe tranzicionin e vështirë shqiptar. Gjurmët e Kadaresë janë të shumta në këtë Paris me rrugët e tij të dashura, sheshet, kafenetë, vendet ku ai shkroi veprat e tij, apo ku takoi personazhe të jetës shqiptare e franceze për të cilët do të shkruante. Unë nuk e kam njohur historinë parisiane të Kadaresë në vitet ‘70-’80 por njoh diçka nga kjo jetë e gjallë dhe mjaft aktive pas viteve ‘90.

« Në librin tim të parë, - shkruante Kadareja në « Mëngjeset në Kafe Rostand », kisha një vjershë për Parisin. Më kujtoheshin shpesh sytë kureshtarë të botuesit dhe pyetja e tij se përse kisha shkruar për Parisin ». Isha 16 vjeç, gjimnazist dhe nuk e dija asgjë nga ajo çka ndodhte në botë. Ndaj ngrija supet dhe përgjigjesha : - S’e di !... » Por talenti i madh dhe letërsia do ta sillte atë në Paris. « Lidhja ime me Parisin do të ishte e gjatë, dyzet vjeçare. Në të vërtetë ishin dy Parise, ai i kohës së komunizmit dhe tjetri, i përkohshmi, secili nga 20 vjet. E kisha të vështirë të gjeja se cili ishte imi, e cili jo... »

Sheshi i parë që do të shihte në Paris ishte siç kujton ai “Place de Trocadero” dhe padyshim Avenue de Champs Elysées, ndërsa hoteli i parë ku qëndroi në ardhjen e tij në Paris ishte “Hotel Duplex” ku zakonisht vinin gjithë shqiptarët nga Tirana, veçanërisht funksionarë dhe studjues. Ishte një hotel modest, jo larg “Kullës Eiffel” dhe shumë pranë dy stacioneve të metrosë “Commerce” dhe “Duplex”, meqë aty afër ndodheshin apartamentet e punonjësve të ambasadës, në mënyrë që ambasada “të kujdesej” nga afër për ta dhe të dinte se ç’bënin e ku shkonin në Paris. Pikërisht aty zbarkoi për herë të 2<sup>ar</sup> më 1971 kohë e botimit të “Gjeneralit i ushtrisë së vdekur” nga “Albin Michel”. Me vete siç shkruan Helena kishte dorëshkrimet e romaneve “Kështjella” dhe “Kronikë në gur”. I vetëm, me ambasadorin e kulturuar Javier Malo që nuk e kuptonte se përse botuesi i “Albin Michel” nuk do vazhdonte aventurën letrare me Kadare, shkrimtari vështronte gjithë trishtim atë Paris të hirtë, por pak kohë më vonë shumë shtëpi botuese kërkuar ta botonin duke filluar me “Hachette literature”.

Para se të vija në Paris në vitin 1991, pas rënies së monumentit të Enver Hoxhës, duke qenë se Ismaili ishte dhe një shkrimtar i lidhur me kinematografinë, e kisha takuar disa herë në Lidhjen e Shkrimtarëve apo Kinostudio kur regjisor i Kujtim Çashku përgatitej të realizonte filmin « Prilli i thyer ». Skenari ishte shkruar. Më kujtohet kur në klubin e Pallatit të Kulturës, Kujtimi i propozoi që veprës « Prilli i thyer » ti jepte një karakter politik duke futur personazhin e një të burgosuri politik në veriun shqiptar, të pranishëm gjatë udhëtimit të çiftit të sapomartuar Dianës dhe Besianit. Dhe Ismaili e pranoi menjëherë këtë ndryshim madhor dhe u tregua entusiazti që vepra e tij do aludonte për diçka të fuqishme, politike. Por kur Timo Flloko do të interpretonte këtë figurë në xhirimet e para, imazhi i këtij personazhi me kokë të qethur u kujtoi cenzorëve të kohës se ai ishte i ngjashëm me ata mijra të burgosur politikë në Burrel, Spaç apo Qafë e Barit, çka ajo « kokë e qethur » nuk do të shfaqej më në ekran. E pra, disa muaj pas ardhjes time në Paris, munda ta takoj Kadarenë në një apartament në katin e parë të një shtëpie modeste në

# NË PARIS, NË HAPAT E KADARESË

*Nga Luan Rama*



Boulogne pranë kishës së kësaj qyteze (në sajë të mikut të përhershëm Julien Roche) dhe ku në interfonin e tij duhej të shtypje atje ku shkruhej fjala « Mozart », një preferencë e bukur kjo e Kadaresë. Por para se të instalohej në këtë shtëpi, Kadareja kishte gjetur mbështetjen e regjisores Liri Begeja e cila vite më parë kishte realizuar filmin « Prilli i thyer » me producent Frederik Miteran, mikun e saj, një film i xhiruar në Korsikë, në mjedise kullash që të kujtonin botën e veriut shqiptar meqë Shqipëria e Enver Hoxhës refuzoi që një grup artistësh të Perëndimit të shkelnin tokën shqiptare. Një kohë të shkurtër familja Kadare e strehua fshehurazi në një fshat 200 km larg Parisit, në Nibelle, (ku vite më vonë, më 1995, do qëndronim me pushime bashkë me Begejë-n dhe ku gjeta shënime të Kadaresë dhe librat që kishte lexuar ato kohë, mes tyre dhe një libër të Dostojevskit dhe Orwell). Më pas, familjen Kadare e vendosën në Rue Monsieur le Prince » e pastaj në një apartament të Louis Barnier, vjehrit fisnik të Liri Begejës, në “Rue Olier,” në Parisin 15 që të mos përndiqeshin nga Sigurimi shqiptar dhe ai serb. Pra kur ata ishin pranë pyllit të Boulogne që e ndante me Parisin, kisha një ndjesi të çuditshme mbrëmjen e parë kur do të shtypja interfonin me emrin Mozart në darkën që çifti Kadare kishte shtruar për kushërirën e Helenës, Helene Gusho Bishop dhe profesorin e letërsisë franceze në Amerikë, zotin Tom Bishop, një çift mjaft simpatik. Në atë kohë shtëpia e Liri Begejës dhe e mikut të madh të shqiptarëve Luc Barnier, në “Rue de Gravillier” në Parisin 3, pranë Qendrës së Kulturës Ndërkombëtare “Georges Pompidou”, ishte një shtëpi e dashur për Kadaretë. Por jo vetëm, pasi kjo shtëpi u kthye më pas në një nga shtëpitë mikpritëse të intelektualëve shqiptarë që zbarkonin në Paris.

Në këto vite të para, kur ishin botuar nga “Fayard” romanet “Prilli i thyer” (1987), “Pallati i ëndrrave” (1990), “Përbindëshi” dhe “Pesha e kryqit” (1991), “Piramida” e përshëndetur nxehtësisht nga Alain Bosquet (1992) apo “Dritë hëne” (1993), Kadarenë e pritën me entuziazëm të veçantë shkrimtarë dhe artistë francezë të cilët e përshëndetën nxehtësisht aktin e tij për të mos u pajtuar më me regjimin. Një prej tyre ishte dhe Michel Piccoli që për në tepër kishte interpretuar rolin e priftit në filmin « Gjenerali i Ushtrisë së vdekur » të Luçiano Tovoli, film që nuk arriti të realizohej në Shqipëri por në Abruzze të Italisë së jugut, kohë kur Ismaili do i duhej të vinte disa herë në Paris për të diskutuar rreth filmit me Michel Piccoli, Marcello Mastroianin, skenaristin Jean-Claud Carrere apo dhe regjisorin italian Marco Belocchio. Një pasdite, në FNAC-un e Montparanasse-it u prezantua një roman i Kadaresë. Ishte viti 1993-1994 dhe në këtë takim dëgjoja të flisnin për veprat e Kadaresë disidenti kroat Pedrag Matvejević si dhe aktorin e mirënjohur Michel Piccoli. Botimin e romanit “Hija” më 1994 e përshëndeste me një shkrim në “Quainzaine littéraire”, ish lektori i frëngjishtes dhe studjuesi i shkëlqyer i Kadaresë Jean-Paul Champseix me titullin “Një shqiptar në Paris ose dashuritë e një të vdekuri të gjallë”.

Pikërisht në ato kohë, në vitin 1992 munda të organizoj takimin e Kadaresë me delegacionin e parë të Partisë Demokratike të ardhur në Paris dhe të kryesuar nga Gramoz Pashko, një i njohur i vjetër dhe mik i Kadareve. Ishte një mbrëmje e paharrueshme në një kafene përballë metrosë « Commerce » ku më pas Kadareja do të kishte zakon të shkonte shpesh. Në kohën kur ishte në Boulogne, Kadaresë i mungonte qendra e Parisit, për më tepër për takimet me shkrimtarët e shquar të Francës si dhe botuesin e tij drejtorin e botimeve « Fayard », Claude Durand, zyrat e të cilit ishin në “Rue des Saints Peres”, në lagjen e Saint-Germain-des Près. Mbaj mend që Ismaili atë kohë kërkonte një apartament të ri dhe një ditë ne shkuam në ndërtesat buzë Senës të Paris 16. Sigurisht i pëlqente të shikonte mbrëmjeve, tej dritareve, lumin e Senës, por më pas nuk i pëlqeu dhe përfundimisht më 1993 u vendos në katin e parë të një ndërtese në “Rue Violet”, jo larg nga metroja “Duplex” dhe « Commerce », ku kishte zbarkuar për herë të parë në Paris.

Ato vite të para të demokacisë shqiptare ishin mjaft të ngjeshura për Kadarenë. Nëse gjatë një dekade botoheshin çdo vit romanet e Kadaresë, të cilat gjenin një jehonë të jashtëzakonshme në kritikën franceze me romanet “Dimri i madh” apo “Koncerti”, tashmë i duhej të shkruante dhe artikuj të shumtë mbi demokracinë e re shqiptare, për

dëshirën e madhe të shqiptarëve për tu bashkuar me komunitetin europian. Intervistat po ashtu ishin të shumta. Pena shumë të njohura shkruanin për romanet e tij si Alain Bosquet, Robert Sabatier, André Cladel, François Nourissier, Mona Ozouf, Antoine Spire etj. Një ditë nga Roma erdhi një gazetarë italiane e RAI 1 që më kishte telefonuar më parë për një intervistë me Kadarenë (atëherë shumë gazetarë më telefononin për të njëjtën kërkesë për intervista dhe jo vetëm francezë). Mbaj mend që Kadarenë, gazetaren dhe një kameraman i çova në pyllin e Boulogne-s, ku në një stol, përballë një dielli të bukur, Kadareja foli më shumë se një orë për zhvillimet shqiptare, emision ky që u ndoq shumë në mediat italiane. Ishte pikërisht kjo kohë kur në një bisedë, Ismaili më pohoi se i kishin kërkuar të pranonte që të ishte presidenti i parë i Shqipërisë demokratike por ai nuk e shihte veten në një pozicion të tillë pasi as që e imagjinonte të braktiste letërsinë, ndërkohë që propozuesit i sillnin shëmbullin e Havelit. Misioni i tij i madh ishte letërsia. Megjithatë ai e ndjente se duhej të angazhohej me diskursin e tij politik në ardhmërinë e Shqipërisë, siç do ta tregonte ato vite duke i dërguar letra presidentëve të shquar të botës, presidentit Bush, presidentit Miteran, presidentit Havel etj, letra, tekstet e të cilave mi jepte që ti nisja për botim në gazetat shqiptare ku ai mendonte t’i botonte. Lumturisht atëherë ishte koha e faksit. Ishte koha e miqësisë së madhe me intelektualin e shquar Jacques Attali, këshilltarin më të afërt të presidentit Miteran, i cili do ti dërgonte ftesë personale për të ardhur në Paris për festimet e 200 vjetorit të Revolucionit Francez, ditë kur presidenti do ta priste një mëngjes në pallatin presidencial. Ato kohë miq të shumtë shkrimtarë e artistë e rrethonin Kadarenë siç ishte regjisor i greko-francez Kosta Gavras apo gazetarët Nicole Zand, Jean Pierre Elkabach, Franz-Olivier Gisbert apo Bernard Pivot që vite më parë e kishte intervistuar në emisionin e famshëm “L’Apostrophe” ku kishin kaluar gjithashtu më të mëdhenjtë e botës letrare.


Një tjetër gjurmë e rëndësishme ishte Akademia Franceze, pranimi i tij si anëtar i Akademisë së Shkencave sociale e politike, seanca e mrekullueshme me fjalimin e tij që la gjurmë por dhe kujtimi i parë i tij kur do të shkonte një ditë në Akademi dhe do ti dhuronte mikut të tij një “dhuratë” të çuditëshme shqiptare. Një revole... Duhej të ishte padyshim miku ynë Laurent Personne, një mik i Shqipërisë dhe shef kabineti i Sekretarit të Përhershëm të Akademisë, Maurice Dryon. Dhe ja si e përshkruan Kadareja me humorin e tij skenën e asaj dite në “Mëngjeset në Kafenenë Rostand”: “Erdhi ora, thashë me vete. Përpiqesha të mos mendoja asgjë, por të bëja atë që duhej, si ballkanas i vërtetë ose i rremë, kjo s’kishte shumë rëndësi. Futa dorën në çantë dhe preka tytën e ftohtë të armës... Në anën tjetër të tryzës dukej që njeriu nuk po i besonte syve. – O, jo, thirri me zë të lartë... Jo gjer këtu, zoti K. Ju lutem, ju betohem... Ai vazhdonte të thoshte se kjo ishte një gjë e paparë, e papërfytyrueshme, nga ato që s’ndodhin kurrë në këtë Akademi. Në të vërtetë tronditja e tij prej pamjes së armës ishte më e fortë se ç’e kisha menduar... Ai vazhdoi të fliste me të njëjtin stil, por që mua më dëgjoheshin dy mënyrash. O, jo, zoti K. Po

kapërceni çdo kufi. Në këtë Akademi s’bëhen kërcënime të tilla. Largojeni, ju lutem, atë armë...” E imagjinoj se sa shumë ka qeshur Kadareja në mënyrën e tij kur ua tregonte miqve të tij të afërt në tryzat e mbrëmjes. Por kjo, në vitet e para të demokracisë shqiptare ishte bërë normale kur vetë presidenti “demokratik” i sapo zgjedhur Berisha filloi të shpërndante shpata dhe bokbure artizanale ndër homologët e tij europiane çka në vizitën e tij të parë me Miteran, një skenë e habitshme u zhvillua para syve të mia dhe protokollit francez në aeroport: kishin harruar shpatat për Miteranin. Si mund një stërnip i Skënderbeut të harronte shpatat?! Këtë histori nuk ia kisha treguar Kadaresë se kushedi kjo mund ti kishte nxitur idenë e shkrimit të një skene burleske. Sigurisht, fjalimi i tij në seancën e pranimit si akademik ishte një nga fjalimet më të bukura të Kadaresë për rolin e shkrimtarit në progresin e mendimit njerëzor.

Pas Hotel “Duplex”, hoteli tjetër për të do të ishte hotel “Derby» në krah të « Ecole militaire » ku dikur bëheshin paradat e famshme të kavalërisë së Napoleonit dhe ku ishte organizuar një nga pritjet më madhështore që i ishte bërë ndonjëherë një gjenerali të huaj, dhe ky ishte Ibrahim, djali i Mehmet Ali Pashës, themeluesit të Egjiptit modern. Ishte viti 1990 kur shoqëria shqiptare kishte nisur të lëvizte drejt ndryshimit politik dhe ishte ardhja e fundit e Kadaresë nga Tirana në Paris. Tutje, përmes “Champs de Mars”, dukej kulla e hekurt “Eiffel”. Pas kaq vitesh ai kujtonte tashmë kafenenë “La Terrace”, aty përballë hotelit ku jo rrallë kam qenë me miqtë e mi. “Më e këndëshmjia ishte “La Terrace” – do të shkruante më vonë ai. - Më kishte tërhequr që në mëngjesin e parë, por vetëm ditën e katërt, pas kafesë, kur duart e mia po kërkonin nëpër xhepa ndonjë copë letër dhe një stilolaps, e ndjeva se ajo ishte kafeneja e duhur.” Por më vonë, në ardhjen e tij të fundit nga Tirana, kur s’do të kthehej më për shumë vite, ai e kujton « La Terrace » me nostalgji : “Në “La Terrace”, në një ditë tetori kishte ndodhur ndarja e dy Pariseve (ajo komuniste dhe postkomuniste. L.R.) Kisha vendosur të mos kthehesha më në Shqipëri pa rënë rendi politik. Tek vështroja gazetarin Daniel Shnejdermann të “Le Monde”-it, që po largohej, bashkë me tekstin e intervistës sime lamtumirore, nuk më shkonte mendja se ndarja, nga çdo pikëpamje do të ishte e përkohëshme...”

Nga itineraret e Kadaresë, një nga vendet apo « stacionet » më me emër ishte Rue Monsieur le Prince, apo « Zoti Princ » siç e shkruan Kadareja, duke kujtuar disa nga banorët e vjetër të kësaj lagje të kohës iluministe apo të kohës së Revolucionit, të fundit të shekullit XIX me Auguste Comte etj. Rrugë që i përshkonte pothuaj çdo ditë. Më kujtohet një herë që po kaloja në « Rue de l’Odéon » për të shkuar drejt Panteonit me një poete që kishte mbërritur nga Rennes ku jetonte dhe po flisnim për Kadarenë të cilin ajo e adhuronte. Po i afrohem « Café Rostand » dhe për një çast i thashë: - Ke dëshirë ta shohësh ? – Edhe pyet, - më tha dhe i ndritën sytë. – Shiko aty në cepin e kafesës, përtej xhamave, ulur pranë tavolinës. Ajo vështroi dhe hapi sytë nga habia. – E pamundur ? Kadareja ? – Po, - iu përgjegja. – Vështrova orën dhe i thashë. – Për gjysmë ore besoj se do ngrihet. – A mund ta takojmë ? – Mjerisht do duhet që ta lemë shkrimtarin të qetë. Ai po shkruan. Si mund ta ndërpresim frymëzimin e tij?” Ajo e kuptoi dhe ne vazhduam më tej. Një herë, në një tavolinë tjetër në “Café Rostand”, jo ajo që ishte tryeza e tij e shkrimit e dëgjoja me interes tek bisedonte me një producente braziliane, një brune rreth të dyzatatave, për realizimin e një filmi tjetër mbi romanin “Prilli i thyer”. Atë film do ta shikoja vite më vonë në televizion, një film interes në frymën e realizmit magjik siç i pëlqejnë latino-amerikanët.

Një herë tjetër po aty, duke ecur në bulevardin Saint-Michel me fabulistin e njohur Ferit Lamaj që kishte shkruar disa fabula mjaft të bukura lidhur me krijimtarinë e Kadaresë, unë ndalova pranë një kioske gazetash e revistash. Pastaj duke i treguar numrin 63 dhe duke vështruar dritaret sipër, i thashë Feritit. – E shikon këtë portë? – Po, - tha i habitur nga pyetja ime e çuditshme. – Këtu jetonte Kadareja. Ai u hutua një çast, qeshi dhe vështroi nga porta e pastaj nga dritaret. Me siguri imagjinonte shkrimtarin. Kështu i kisha treguar dikur mikut tim të vjetër Spartak Papadhimitri shtëpinë ku kishte jetuar në vitet ’20-’30 Heminguei, një ditë kur po ngjiteshim nëpër kalldrëmet historike të “Rue Moufflard” ku më parë Kadareja ndalonte në një restorant të thjeshtë, tek miku i Omer Kaleshit që quhej Claude dhe që ishte lokali i preferuar dhe i përditshëm i Omer Kaleshit. Të tjerëve u tregoja shtëpitë ku kishin jetuar Xhois, hotelin ku kishte vdekur në mjerim Oscar Wilde po shtëpinë e Hugoit në “Place Vosges” apo të Mopasanit, e cila ishte kthyer në residencën e ambasadorit turk pranë “Radio France”, shtëpinë e Balzaku, buzë Senës, ku ai u fshihej huadhënësve që i kërkonin borxhet dhe ku romancieri i madh vdiq, atë të shkrimtares Marguerite Duras ngjitur me “Café Floré”, në “Rue Benoit” apo të Romain Gary në “Rue du Bac”... Shtëpi, shumë shtëpi, pllaka, data të shkruara nëpër mure, sipër portave. Mjerisht, pikërisht pas portës, një ditë Gary kishte vvarë veten një fillim dhjetori të



vitit 1980. Shtëpi të trishta, shtëpi të gëzuara...

Padyshim “Rue Monsieur le Prince”, ka qenë rruga më e rrahur nga këmbësori Kadare Ishte koha kur në vitin 1996 u vendos në bulevardin simpatik Saint-Michel që të çonte drejt Panteonit dhe kopshteve të Luksemburgut për të cilat në kohën e adoleshencës kishim lexuar tek “Të mjerët” e Viktor Hygoit.

Kur u vendos në bulevardin Saint-Michel pas botimeve të shumta në “Fayard” dhe në mirëkuptim me mikun e tij Claude Durand, një ditë këmbët e çuan Kadarenë në zyrat e botimeve “Jose Corti” ku u njoh me botuesin i cili botoi një vepër të tij. Pas tij, po në atë lagje, një ditë u kryqëzua me botuesen e “Odile Jacob” ku përsëri dhe ajo do të botonte një vepër të re të shkrimtarit shqiptar. Por dhe krah botimeve “Flamarion” dy hapa nga “Café Rostand” në « Place de Odeon », ai do të botonte librin “Kushëriri i engjëjve” pas takimit me Angjelin Prelocaj. Ismaili kishte dëgjuar për koreografin e talentuar dhe bashkë me Izet Currin organizuam takimin e shkrimtarit me koreografin, të cilin atë kohë e njihja familjarisht. Prindërit e tij jetonin në periferinë parisiane ndërsa Prelocaj me familjen e tij jo larg Bastille-s së Revolucionit Francez, në boulevard “Richard Lenoir” Kështu bashkë me Ismailin shkuam në kafenenë “Café Bastille” në sheshin historik të Bastille-s me obeliskun e mrekullueshëm dhe “gjenium” në majë të tij që shndriste nga dielli, i larë në ar. Mes Ismailit dhe Prelocaj, i cili e njihte mirë veprën romaneske të Kadaresë nisi një bisedë pasionante edhe pse Prelocaj shumë pak e fliste shqipen në atë kohë. Ishte tregimi i tij për ikjen nga kufiri shqiptar kur nëna ishte shtatzënë me të. “Angjelin Prelocaj, - do të shkruante Ismaili në “Mëngjeset në Kafe Rostand”, - m’i tregoi (historinë e familjes L.R.) me një frëngjishte tepër elegante... Angjelini tha se, ndonëse mjeshtëria e shkrimtarit dhe e koreografit dukeshin aq të largëta, në thelb... Flisnim të dy aq ngatërrueshëm, sa, po të na dëgjonte njeri, do të kujtonte se i ishim kthyer gjuhës shqipe. Më dukej se kisha gjetur bërthamën e librit tim për të.”... Dhe jo shumë vonë, “Flamarion” botoi librin e mrekullueshëm “Kushëriri i engjëjve”.

Odeoni ishte padyshim zona e tij e preferuar. Në mesin e viteve ’20 të shekullit XX aty kishte dhënë disa herë shfaqje Aleksandër Moisiu, për çka ka shkruar shumë shtypi i asaj kohe. Ismailit i pëlqente që rrugët e ngushta kishin emra dramaturgësh, pllaka përkujtimore me datat e lindjes dhe të vdekjes së tyre. “Të gjitha të vitit 1600. Afërsisht të kohës së Shekspirit...”

Ndërkohë që shkruaj të tjera imazhe më shfaqen, siç ishte dhe shtëpia e poetes franceze Claudine Helf një mikeshë e afërt e amerikanes së mrekullueshme Norma Bosquet (gruaja e Alain Bosquet) e cila organizonte në apartamentin e saj në

Rue de la Fesanderie çdo muaj një takim letrar me shkrimtarë dhe poetë të shquar francezë. Dhe kjo në vazhden e tradicionit francez ku gjithnjë shkrimtarë, siç kishte qenë Mallarmé apo Flaubert në fundin e shekullit XIX që organizonin çdo javë takimet letrare në apartamentet e tyre. Krahas Kadaresë dhe Helenës takoja atje dhe Luan Starovën me gruan e tij. Jo pak shqiptarë në tryzën dhe banketet letrare parisiane.

E megjithatë, “Café Rostand” u kthye në vendin e ritualit të shenjtë, atë të Shkrimit, meditimit, vështrimit të shoqërisë njerëzore dhe të botës. Një kafe përpara, një letër, një stilolaps dhe shkrimtari humbte në botra të tjera, të ngjashme me atë që pulsonte para syve të tij. “Ideja për të shkruar diçka për “Kafe Rostand” më kishte ardhur aq natyrshëm, sa që s’e mbaja mend as kohën, as rrethanat. Ishte një ndjesi midis pendimit dhe mirënjohjes, e ngjashme me atë të shoqes së jetës, që, duke qenë pranë teje në gjithçka, nuk e ka pasur, ose ty të duket se nuk e ka pasur vëmendjen e duhur. Në këtë kafe kisha shkruar qindra faqe e po aq shënime për motive e sinopse, pa u kujtuar asnjëherë për atë vetë, kafenenë...” Në itineraret parisiane të Kadaresë nuk mund të harrosh as restorantin e famshëm “Fouquet’s”, atë të aktorëve të teatrit dhe kinematografisë franceze e botërore ku mblidhej me Piccoli, Mastroiani, Carrere... Disa herë i ftuar në “Fouquet’s” të Champs Elysées në takimet e Kadaresë me Ekrem Bardhën që vinte nga Amerika të takohet me të, shikoja me kënaqësi të veçantë Kadarenë pasionin e tij për verërat e njohura, që për francezët vera është një institucion më vete. Ishte ai që e zgjidhte gjithnjë verën, ai që e shijonte dhe jepte pëlqimin për verëra të njohura si “Margaux”, “Chateaufort du Pape”, “Saint-Julien”, etj. Shikoja Kadarenë se si e mbante verën në gojë, e rrotullonte që qiellza të kapte tërë shijet e tokës dhe të diellit. Këtë kulturë të verërave besoj se Kadareja nuk e kishte kur erdhi në Francë. Ajo u përftua në darkat e zgjedhura të francezëve, me politikanë, shkrimtarë, artistë të shquar etj. Për të pak rëndësi kishte e ngrëna. Rëndësi kishte vera, si një mbretëreshë që zotëronte tryezën dhe shpirtin. Mbaj mend disa darka kur na ftonte ish ministri Jacques Augard dhe gruaja e tij një bjonde e bukur, kur një martinikase që shërbente sillte verën, tregonte etiketën e verës, ku ne shikonin ngjyrën e saj. Shërbimi i verës ishte një ritual më vete. Kadareja e provonte i pari, pasi hidhej në një kanë vere. Më pas fillonte biseda për verën, (për çka më vonë do të botoja një libër për verërat franceze), pasi vera kishte gjuhën e saj, fjalorin e vet, aty flitej për “velurin e verës” (il a du velours), për aromë sileksi, mjalti, lule shtrydheje, për verën që kishte trupin e bukur të një gruaje (“il a du corps”) etj.

Një tjetër restorant i parapëlqyer i Kadaresë ishte “Closier de Lilas”, në fund të bulevardit “Montparnasse”, një ndërtesë që kishte ruajtur hiret e fillimit të shekullit pasi aty bëheshin mbrëmjet kur shpallej poeti me i mirë i Francës, i cili konsiderohej “Princi i Poezisë”. Pikërisht aty, (ku ishte ftuar disa herë gjatë viteve ’80) por nga mesi i viteve ’90, atje ai do të nderohej me “Çmimi i Mesdheut” e padyshim vera do të ishte e klasit të parë, aty në ato tavolina që mbanin pllaka të vogla bronxi me emra shkrimtarësh e artistësh ku për çudi ndodhej dhe emri i atij që quhej ... Lenin!

Si mos të kujtoj gjithashtu praninë e Kadaresë në koncertet e artistëve shqiptarë, siç ishte premiera e një opere (dhe jo vetëm) me Inva Mulën në Opera Garnier, apo të Tedi Papavramit në sallën “Gavaux” etj. Shumë artistë që kanë prezantuar veprat e tyre në Paris, kanë dashur ta kenë praninë e Kadaresë në sallë, siç ishin dhe premierat e koreografitë të mrekullueshme të Angjelin Prelocaj (“Dasma” apo “Romeo dhe Zhuljeta”, etj) apo të aktorit të njohur Rexhep Mitrovica (“Hamlet”, “Ditari i Nizhinskijt”) në Teatrin e Opera Bastille” apo “Comedie Française”. Një epokë më vete ishte koha e Konferencës së Rambouillet me delegacionin e Kosovës, letrat e Kadaresë që duhej ti përcillja Rexhep Qoses apo anasjelltas, kohë kur shoqëroja një mbrëmje prijësin e UCK-së Hashim Thaçi dhe Ram Buja për në shtëpinë e Kadaresë në bulevardin Saint Michel, një mbrëmje ku na priste atje Bukurie Gjonbalaj dhe kur lufta vazhdonte e ashpër në malet e Kosovës kundër forcave serbe.

Këto shënime janë shumë të pakta dhe të pamjaftueshme për të ndërtuar itinerarin parisian të Kadaresë, (ja pse dhe Helena e quajti librin e saj me kujtime « Kohë e pamjaftueshme » pasi është e vështirë ta rrokësh jetën e një shkrimtari të shquar të një epoke në disa krimet, qoftë dhe me një libër). E megjithatë shumë miq të Kadaresë që e kanë takuar dhe jetuar pranë tij në Paris këto 35 vjetet e fundit (mes tyre dhe ambasadorët Dritan Tola apo Ylljet Aliçka, e padyshim shumë miq artistë e shkrimtarë që vinin nga Tirana) kanë shumë ç’të tregojnë, çka do mund të krijojë afreskun e vërtetë të jetës së një shkrimtari të lidhur aq ngushtë pas krijimit të tij, letërsisë, me atë ritual të përditshëm siç mund të ishte lutja e një murgu mesjetar në « scriptoria »-t e manastireve. E atëherë do ta kuptojmë më mirë shkrimtarin, pa u kapur në vogëlsirat por duke e parë atë si një përfaqësues të shpirtit krijues kombëtar. Së fundi, nëse do të përcaktoja një gjeografi

(Vijon në faqen 9)

Ky titull, i cili më pëlqeu pakufi, u huazua prej të shprehurit të skulptorit të mirënjohur shkodran Ferid Kola. Sa bukur në gegnisht “mos u ngutni!” të jep mundësinë e të kupturit “mos u nxitoni!”, si për mirë ashtu dhe për keq.

Ky tekst u lind mes dhjetëra debatesh, të cilët i kam ndjekur me vemëndje mbi atë se çfarë po ndodh së fundmi, në trojet shqiptare me artin e skulpturës monumentale. Ai është një art domethënës e social politik, jeton në kohëgjatësi dhe i përballet vëzhgimit dhe shijeve të brezave. Cilësia e mirë, ose jo e tillë, e skulpturës monumentale, e realizuar ditëve të sotme mes shprehive të kamufluara të realizmit socialist në imazhin figurativ realist ose modernist, kalimet apo kapërximet e krimeve nga një sistem vlerash tek tjetri, ende shkaktojnë një gjendje amullije figurative në sytë e publikut apo të njerëzve të jetës së përditshme. Edhe pse janë krijime të kohës së sotme ose më konkretisht të kryera gjatë gjysmës së parë të shekullit XXI shihet se ende është e vështirë të dallohet e të kapërdihet cilësia dhe tipologjia e skulpturës monumentale në ditët tona. Situata më e fundit është ajo e krijuar rreth boceteve të propozuara për monumentin e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, i cili do të vendoset në Ulqin të Malit të Zi.

Siç e do rasti u zhvillua një konkurs, ku morën pjesë 17 - të bocete skulpturore. Një numër i shumë i pakët ky, për rëndësinë e një subjekti të tillë. Vendet e nderit u përcaktuan nga gjykimi i anëtarëve të komisionit të ngritur nga bashkia e qytetit. Vendin e parë e zuri propozimi i një kompozimi të llojit kompleks figural i ndarë në dy grupe, heroi Gjergj përball trimave malësorë të Ulqinit i skulptorit Sabri Behramaj. Vendin e dytë e zuri propozimi i një kompozimi ekuestër të Gjergj Kastriotit mbi kalë, i cili ecën qetësisht dhe fitimtar, i skulptorit Vasil Rakaj. Vendin e tretë e zuri propozimi i një kompozimi të gjinisë së shtatores së heroit, me qendrim vertikal, i skulptorit Agron Ujkashi. Të tre fituesit sollën tri atmosfera të ndryshme figurative. Deri më tani, ato në aspektin kompozicional të zhvillimit të formave skulpturore rezultojnë të njohura, të trajtuara dhe ekspozuara në mjediset ndërkombëtare dhe kombëtare.

Kompozimi skulpturor, që ka zënë vendin e parë, ka prej disa ditësh që ndodhet nën trysinë e gjykimeve negative, shpeshherë fyese dhe, herë refuzuese dhe mohuese. Dhe në pak raste pranohet si një vepër e konceptuar ndryshe dhe që i përket formave të artit modern. Dhënia e mendimeve është ndarë në dy grupe të mëdha, ku masa më e rëndë anon nga mospranimi i kompozimit skulpturor të përzgjedhur si vendi i parë prej komisionit të profesionistëve të kohës. Nën një vëzhgim të veçantë mbi opinionet e asaj popullsie shqiptare, që ka marrë pjesë në debatet publike e në rrjetet sociale, dallon se tri bocetet skulpturore të propozuara duken sikur përcaktojnë qartë dhe mirë nivelin njohës dhe kulturor, dijet mbi monumentalizmin, shijet dhe dëshirat për formën figurative të heroit. Dhe kjo është e natyrshme.

Ka dhjetëra arsye pse ndodh që publiku i sotëm, në të përditshmen e vet, arrin të shpreh ide të shumëllojshme mbi imazhin monumental figurativ të heroit kombëtar. Ai, kur vihet përballë propozimeve figurative të artistëve skulptorë, shqetësohet rreth asaj çka nesër, e çdo ditë do të duhet të vështroj dhe admiroj. Nëse analizojmë mendimet e shprehura në publik arrijmë të zbulojmë jo vetëm nivelin ideo-kulturor të dëshirave të tyre, por edhe pamjen e stadit të sotëm dhe të nivelit të deritanishëm të skulpturës monumentale, të propozuar e të krijuar nga artistët shqiptarë.

Një nga opinionet më të zakonshëm të publikut është se duan ta shohin e ta rishohin heroin mbi kalë ose siç njihet në gjuhën e artit, në formën ekuestër. Arsyeja pse më e shumta e mendimeve të publikut shqiptar e dëshiron ende ta shohë heroin kombëtar mbi kalë, pra të formës ekuestër, është thuar se qindra vjeçare e më shumë se kaq. Ajo lidhet më parë me kulturën figurative të artit ndërkombëtar, e cila heroin mbretëror, perandorak dhe mesjetar apo prijës in e një ushtrie e ka parë të realizuar më së shumti në formën e ekuestrit të vendosur në sheshe

# “Mos u ngutni!”

Nga Suzana Varvarica Kuka

qendrore të shteteve europiane dhe më gjerë se kaq. Historia e artit e daton, si një ndër ekuestrat më të hershëm, monumentin e Marcus Aurelius mbi kalë, derdhur në bronz në 173 - 76 pas K., i cili gjendet në Romë. Po në në qytetin e famshëm të Romës nis edhe historia e ekuestrave të Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Skulptori Romano Romanelli, (1882-1969), e realizoi veprën në 1938, e cila u vendos në vitin 1940 në sheshin “Albania” në Romë. Ndërsa, portreti – bust i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, realizuar në bronz nga Odhise Paskali (1903-1985), ishte vendosur në vitin 1939 në Kukës. Pamja e këtij portreti u bë burim frymëzimi dhe ndikimi tek shumë skulptorë të viteve të komunizmit dhe ende ka ndikim mbi dhjetëra skulptorë të pas viteve `90.

Shembuj të ekuestreve nëpër botë ka shumë. Ata ndikuan në zgjidhjet kompozicionale të ekuestreve që kanë realizuar artistët shqiptarë gjatë shekullit XX e në fillim të atij XXI e që sot ndodhen në sheshet e qyteteve Krutë, Tiranë, Prishtinë, Shkup, Detrid. Ekzistenca e tyre e realizmit figurativ, me pamjen e heroit mbi kalë para ushtrisë së tij, tërheq vemendjen dhe nxit të mos pranohen lehtësisht zgjidhjet e tjera kompozicionale. Kjo nxitje shkaktohet edhe pse historiografia e periudhës komuniste e trajtoi Gjergj Kastriotin si një hero lufte dhe lider të bashkimit kombëtar, duke ia anashkalluar disi cilësitë e tjera si: politike, diplomatike, sociale dhe fetare. Këto cilësi, të faktuar në ditët e sotme nga burime arkivore, e pasurojnë dijen mbi figurën komplekse të kryetrimt mesjetar shqiptar, por në të njëjtën kohë kanë krijuar edhe rezistencë për t’i pranuar, duke shkaktuar tek një pjesë e popullsisë një mendësi të ngurtë e të ashpër, e cila dëshiron ta trashëgojë figurën e kryetrimt të himnizuar e madhështore. Madje në skulpturën monumentale vetëm të vendosur mbi kalin e tij, si dhe mundësisht të mos lejohen trajtime të tjera figurative dhe kategorikisht të përjashtohen trajtimet e formave moderne. Gjithësesi, asgjë nuk absolutizohet. Kërkimet figurative në artet pamore e kanë trajtuar figurën e kryeheroit me shprehje emocionale të disallojeve dhe në pozicione të ndryshme.

Por mendësia ekuestrale në popull lidhet ngushtësisht me ekzistencën e qëndrueshme ekuestrale artistike, e cila e ka përmëshur më së miri qëllimin estetik dhe vijoi të funksionojë dhe në konkursin e fundit të Ulqinit. Boceti i ekuestrit Skënderbe, i skulptorit Vasil Rakaj u vlerësua me çmimin e dytë. Në këtë mënyrë shihet se bëhen bashkë dijet monumentale të tre segmenteve: popull, artist dhe anëtarë profesionistë të komisionit vlerësues. Por komisioni nuk i dha vendin e parë edhe pse jam e bindur që e ka njohur mjaft mirë situatën populiste të parapëlqimit të një ekuestri.

Boceti i çmimit të tretë tregoi se kërkesa e artistit ishte të shkëputej prej ekuesrit dhe të pasqyronte një shtatore monumentale ku psiku dhe fiziku tors i heroit të qendrojnë drejtë, me shpatën vertikalisht para e të mbërthyer me të dy duart. Një trajtim i tillë tashmë është shumë i përhapur në skulpturat e statujave që i përkasin dëshmisë së figurës së mbretit, klerikut reformator ose figurës metaforike “Drejtësia”, në gjykatat e larta. Disa prej tyre janë si: ajo mbretit viking Alfredi i Madh që jetoi në shekullit të IX dhe objekti kryesor i tij është shpata. Statuja e reformatorit Ulrich Zwingli në Zvicër, që mban përpara biblën dhe shpatën, si dhe statuja alegorike “Drejtësia”, që mban para trupit shpatën dhe ndodhet në hyrje të fasadës qendrore të gjykatës supreme të Londrës. Tek boceti i çmimit të tretë shpata është objekti simbolik kryesor. Ai kryen dy funksione atë të mjetit luftarak dhe atë të kryqit si shenjë e një luftëtari të mesjetës, qëllimi i të cilit ishte jo vetëm të bashkonte shqiptarët, por edhe të mbronte perëndimin e krishterë ndaj vërshimit të pushtimeve të lindjes osmane, një dëshmi kjo e njohur dhe e folur vetëm pas viteve `90. Ndërsa simbolet e metaforave figurative e qarkojnë këtë bocet në mënyrë tregimtare, ku evidentohet mazhi i shqiponjës në kraharonin e heroit. Natyrisht një gjetje e tillë kompozicionale e shtatores së heroit udhëheqës e luftëtar është e njohur në skulpturën e krijimeve të artistëve shqiptarë, duke nisur me statujën e Skënderbeut, me shpatën në ngulur në tokë, të realizuar nga Odhise Paskali. Ndërsa, komisioni ka vlerësuar drejt kërkesën monumentale të skulptorit Agron Ujkashi, e cila shkoi deri aty sa ta shohë heroin si një individ të veçantë, që nëse do të ishte fitues do të bëhej vetëm shprehje e faktit statik të ekzistencës së heroit përmes një trajtimi realisto-tregimtar.

Vjen një ditë dhe vjen një brez tjetër skulptorësh të rinj, që arsyetojnë për të evidentuar të ndryshmen e që dëshirojnë të jetojnë me modernen, me forma figurative që tejkalojnë tërësisht format e para e të njohura realiste të krijimit monumental mbi Skënderbeun si equestrian ashtu dhe shtatoren në këmbë. Ata guxojnë, pasi dëshirojnë të provojnë tjetrën apo të renë që dallon shpesh e panatyrshme, sepse figurat që krijojnë i largohen pasqyrimt të drejtëpërdrejtë të natyrës. Ky qendrim solli në konkursin e Ulqinit bocetin e propozuar nga Sabri Behramaj, i cili është i përbërë nga dy pjesë. Mendoj se komisioni e shquajti si një zgjidhje të veçantë, të pa trajtuar më parë në skulpturën shqiptare monumentale dhe e vlerësoi me çmimin e parë, vlerësim që tashmë nuk mund të kontestohet, por që mund të debatohet e të opinionizohet.

Sa e mundur është të pranohet e të shijohet ky trajtim jo realist dhe kjo zgjidhje kompozicionale që i përket po themi

## Vendi i parë



parimeve të skulpturës moderne të shfaqura në Europën e fund shekullit XIX dhe të fillimit XX? Sa origjinal është një trajtim i tillë si në formë dhe në përmbajtje?

Kur në vepër janë bërë bashkë dhe në lartësinë e duhur estetike të gjitha elementet kreativë e përbërës, atëherë është plotësisht e mundur të pranohen trajtime jo realiste edhe kur ato përdoren për të pasqyruar personalitete historik. Dhe kjo ka ndodhur me monumentin portret bust të shtatores së Fan S. Nolit, që ekspozohet në Tiranë, e krijuar nga skulptori i mirënjohur Thoma Thomai Dhamo (1939), pas viteve `90. Monumenti u prit me kritika të shumëllojshme. Sot i ka tejkaluar të gjitha. Asaj kohe shënoi fillesën e trajtimit të një skulpture moderne mbi subjektin e personalitetit historik dhe anashkaloi tërësisht mendësitë raliste dhe ato të realizmit socialist.

A mund të themi se është e njëjta situatë me projekt bocetin e çmimit të parë në Ulqin? Në pika të përgjithëshme po, por në pika nevralgjike jo! Krijimi modern i Thoma Thomai Dhamos është i besueshëm pasi rrjedhonte nga puna krijuese e një artisti të formuar qartë e qenësishëm me kulturën moderne figurative europiane që në vitet `50 të formimit të tij në Akademinë e Arkitekturës dhe Dizajnerit në Pragë. E ky formim krijimi vijonte çdo ditë në studion e tij edhe në kohën e komunizmit. Të gjitha skulpturat e tij edhe kur tentojnë të kapërcejnë realizmin etiketohen si të Thoma Thomai Dhamos. E kjo lidhet me qëndrueshmërinë jetike dhe artistike të krijimit individual, që përcaktonte dinjitetin estetik unik të artistit.

Ndërsa me artistin e ri Behramaj shihet qartë që kemi përballë një përmbajtje dinjitoze, një zgjidhje domethënëse dhe krejt të ndryshme nga ç`kemi parë deri më sot në lidhje me personalitetin e kryetrimt, si dhe në lidhje me veprat e tjera të artistit. Ajo që po shqetëson publikun, ajo që e “penalizojnë” projektin është forma plastike që ka realizuar idenë e tij. Ajo është një formë plastike e huazuar thuar nga pak tek gjigandët e ekspresionizmit, abstrakt ekspresionizmit, kubizmit dhe të futurizmit. Kjo formë e huazuar eklektike, përmes skulpturës monumentale, i është veshur kryeheroit dhe luftëtarëve të tij për të sjellë një pamje tjetër të tyre, jo realiste. Dhe në mënyrë të llogjikshme kjo formë e huazuar e ka opinionizuar negativisht artistin, sepse sipas tyre, përmbajtja, që nënkupton organizimin e subjektit të monumentit në dy grupe dhe forma plastike apo skulpturore nuk janë “përputhur”, nuk janë bërë bashkë dhe kanë krijuar një atmosferë skulpturore plot thepisje dhe pikpyetje. Dhe kjo ndodh sepse artisti shqiptar dhe arti figurativ apo pamor në Shqipëri, por edhe në Kosovë nuk i kanë zhvillimet e lëvizjeve moderne të njëkohëshme me ato europiane e më gjerë. Dhe më e trishtueshmja është se shpeshherë

artistët shqiptar bijen në imitime dhe huazime të formave të lëvizjeve moderne europiane, pa u thelluar në psetë dhe arsyet e lulëzimit të tyre. Dhe më kryesorja është se këto zhvillime i mungojnë edhe dijeve të publikut shqiptar, i cili nuk është edukuar me to gjatë formimit shkollaresk apo akademik. Ai, publiku ynë, është ushqyer me forma të artit të pasqyrimin të drejtëpërdrejtë nga natyra, me ato natyraliste dhe realiste, si dhe format e artit të propagandës dhe për këtë ka çdo të drejtë të shprehet se dëshiron një monument realist e me forma të lexueshme natyraliste, për kryetrimin Skënderbe. Por a duhet që këto dëshira ta penalizojnë veprën fituese? Mendoj se jo. Por a ka tek këto dëshira të publikut një fill që të bënë të mendosh nëse vepra është dinjitoze ose jo për të pasqyruar figurën legjendare të Skënderbeut? Natyrisht që ka. Dhe bukur e qartë e thotë skulptori Ferid Kola “Mos u ngutni!”.

Forma e huazuar moderne e artistit shqiptar i ka bazamentet e forta, që mund të ecim mbi to duke lexuar e njohur historinë e artit ndërkombëtar. Nëse mendojmë rreth Ekspresionizmit, do të zbulojmë se asnjë artist madhor i tij nuk trajtoi figurën e njohur reale të personalitetit historik, por trajtoi emocione të ndryshme njerëzore. Duhet të pranojmë se artisti shqiptar ka huazuar formë ekspresioniste, e cila lindi në brumin e lëvizjes artistike, që u cilësua Ekspresionizmi dhe u shfaq në fillim të shekullit XX. Në skulpturë, ai dallohet nga ekzagjerimi i formave, mënyra se si emocionet manifestohen intensivisht dhe nga refuzimi i realizmit klasik. Në skulpturë, ekspresionizmi nuk kërkonte saktësi estetike, por të përcjellë ndjenja ankthi, dëshpërimi, vuajtjeje ose energjish negative përmes figurave me një dinamizëm të fortë dhe të transformuara. Vepra “Hakmarrësi” (1914) e skulptorit gjerman Ernst Barlach (1870-1938), është një vepër themelore në skulpturën moderne ekspresioniste, që pasqyron kaosin dhe emocionet e një bote në prag të trazirave, (bëhet fjalë për shpërthimin e Luftës së Parë Botërore) intensitetin e thellë emocional dhe eksplorimin e vuajtjeve njerëzore. Artistët ekspresionist nuk kishin asnjë qëllim për të krijuar me format e tyre të reja imazhe të personaliteteve të njohura historik.

Nëse mendojmë rreth figurës madhështore të burrit prej bronzi me titull “Unique Forms of Continuity in Space / Format unike të vazhdimësisë në hapësirë”, të krijuar në 1913, nga Umberto Boccioni (1882–1916) do të shprehemi se arsyeja që u krijua nuk është një çështje që lidhet me personalizimin e figurës historike, as të një artisti si individ, por është çështje historike e zhvillimeve teknologjike në fillim të shekullit XX, si dhe të manifestit të grupit të artistëve futurist. Ata rritmin e shpejtësisë dhe fuqinë mekanike të teknologjisë së botës moderne, që dukeshin në sfondin e fillimit të atij shekulli dhe të LPB, i kthyen në dinamizëm për të shkatërruar të kaluarën klasike në art dhe në të gjithë aspektet e jetës.

Nëse njihemi dhe me Kubizmin, që lindi në prag të LPB si një lëvizje artistike që revolucionarizoi artin dhe sfidoi atë tradicional, do të dallojmë se artisti shqiptar ka huazuar segmente të formave kubiste për të realizuar bocetin e tij “Skënderbeu me burrat e Ulqinit” Mjeshtërit kubist i përshkruan subjektet e thjeshta të emocionit të përditshëm njerëzor nga këndvështrime të shumëfishta dhe me forma gjeometrike. Veprat e tyre shkaktojnë ndjenja fragmentimi dhe abstraksioni, pasi janë të shkëputura nga perspektiva lineare dhe përshkrimet realiste. Skulptori hungarez Oseph Csaky (1888 - 1971) ishte një pionier i skulpturës moderne dhe vepra tij kubiste “Autoportret” 1913, e depersonalizoi pamjen e vet realiste dhe shprehu përmes Kubizmit të Kristaltë apo Purizmit ndjenjat e tij të brendshme. Situatat kubiste e shpëlanë plotësisht përmbajtjen dhe natyrisht askurr artistët e tij gjigandë nuk i përdorën format e tyre kubiste për të ndërtuar apo krijuar figurën e rëndësishme të personalitetit të njohur historik.

Ndoshta për artistin Behramaj format e huazuara të përdorura në shekull më parë, janë një vetpohim i tij, është një dëshirë e tij për të provuar ose kopjuar baballarët e modernizmit ekspresiv, kubist dhe futurist? Por kjo ka krijuar një turbullirë në publik, sepse publiku e njeh artistin me skulpturën e tij realiste, tregimtare dhe natyraliste. Kujtojmë veprat e tij bust i Skënderbeut me një trajtim tradicional, figura shtatore e ulur e Leotrim Ahmetit dhe Zahide Jashari me një trajtim realisto-natyralisit,



statuja dhe portrete heronjsh me ndikim kah skulptura e realizmit figurativ natyralist dhe realizmit socialist. Mos ndoshta dhe artisti Behramaj kërkon që përmes formës së huazuar nga ekspresionizmi, futurizmi dhe kubizmi të shkatërrojë mendësitë realiste dhe të realizmit socialist që e kishin ngërthyer më parë edhe krijimtarinë e tij? Krijimi që ai propozoi në konkursin e Ulqinit është krejt i ndryshëm dhe është unik. Ndër 17 punimet konkurse, ai u cilësua një sukses nga komisioni i profesionistëve dhe u vlerësua prej tij me vendin e parë. Kjo tregon se ia ka arritur qëllimit që t`i “largohet” realizmit klasik (tregimtar dhe natyralist) dhe të revolucionarizojë mendësitë e shkuara skulpturore në pasqyrimin e kryetrimin. Kam mendimin se komisioni e vlerësoi përplekjen e tij jo thjesht si një përplekje individuale, por edhe si një skulpturë të re që lind në një kohë të re dhe për një publik të ri. E vlerësoi si një skulpturë, e cila “thyen” mentalitetin e zakonshëm të krijimit ekuestral mbi Skënderbeun. Në ditët e sotme ky vendim është kthyer në sukses për artistin, i cili ka fituar të drejtën të realizojë përmbajtjen e qenësishme të kryetrimin përmes formave të huazuara moderne. Ato, gjatë kryerjes së monumentit në përmasat e kërkuara, do ta bëjnë artistin të përballat me kontradiktat e vetvetes mbi origjinalitetin ose jo të formës plastike dhe të pikpyetjeve sesi do t`i superojë ato. Format e huazuara moderne do ta bëjnë të përballat me publikun mohues, por edhe me personalitetin e figurës madhore të Skënderbeut, i cili kuvendon ethshëm rreth betejave me trimat malësorë, si dhe me personalitetin dinjitoz të trimave të tij.

Asaj kohe, kur vepra të marrë formën përfundimtare, publiku do të debattojë përsëri, dikush për mirë e dikush për keq, sepse kjo është në natyrën njerëzore, e cila ndërton opinionet, mendësitë, vlerësimet dhe gjykimet, mbështetur në zhvillimet social-kulturore të një komuniteti apo vendi. Kam mendimin se Sabri Behramaj me propozimin e tij skulpturor vendosi të sfidojë kohën e kryerjeve të monumenteve të mëparshëm të figurave historike dhe ka marrë përsipër të rrezikojë me figurën më madhore të shqiptarëve Gjergj Kastriotin Skënderbeun.



(Vijon nga faqja 7)

itinerarësh të Kadaresë në Paris do mund të shkruaja : “Rue de la Pompe”, ku ishte dikur dhe ambasada shqiptare në Paris, “Hotel Duplex”, “Hotel Derby”, apartamenti në Boulogne, apartamenti në “Rue Olier” apartamenti në “Rue Violet” Parisi 15, apartamenti në 63 bd. Saint-Michel, « Café Rostand », (ku u shkrua një pjesë e rëndësishme e veprave të tij si “Lule të ftohta të prillit”, “Aksidenti”, “Zëvendësi”, “Një darkë më shumë”, etj) « Café Les Deux Magots » (“Dy magjistarët”, i cili prej vitesh jepte një çmim letrar për shkrimtarin më të mirë dhe aty nga mesi i viteve ’90 asistova në çmimin që iu dha Kadaresë, siç i ishte dhënë më parë dhe çmimi letrar “Cino del Luca” po në Paris); apo dhe « Café Flore » në Saint-Germain des Près (aq të preferuar nga Heminguei, Sartre, Simone de Beauvoir etj), ambasada shqiptare në “Avenue Marceau” pranë “Harkut të Triumfit”, “Rue Monsieur le Prince”, botimet « Fayard » në “Rue des Saints Père”, “Café Luxembourg” ( vend-takimi i shqiptarëve ruajalistë të viteve ‘40-’70), “Kopshtet e Luxembourgut”, zyrat e botuesit të « Jose Corti », botimet « Flamarion », restoranti « Fouquets » në Champs Elysées, restoranti « Closerie des Lilas » etj, etj që s’kanë të mbaruar, si stacione jete të një shkrimtari të shquar. E vështirë ti rrokësh të gjitha pasi gjurmët e tij janë ngado në këtë Paris të lashtë dhe me aq shumë histori e jetë shkrimtarësh që dikur ishte epiqendra botërore e kulturës. Në këtë itinerar kam fotografuar jo pak imazhe që së bashku përbëjnë atë çka mund të quanim Parisin e Kadaresë. Madje dhe “Café de Luxembourg” kur një ditë shoqëroja Kadarenë dhe Helenën në takimin e tyre me Flora Brovinën që vinte nga Kosova dhe që Kadareja donte të mësonte shumë se çfarë ndodhte ato kohë në Kosovë. Brenda një shkrimi është e pamundur të shkruash për ngjarje dhe vende të lidhura ngushtë me Kadarenë, të shkruash për ceremonitë zyrtare, takimet me Jusuf Vronin dhe ceremoninë e tij për Legjionin e Nderit në parlamentin francez, vdekjen e mikut të tij Alain Bosquet dhe përcjelljen e tij në varrezat e Montmartre-s (ku hidhnim mbi arkivolin e tij fletë të poezive të librit të tij më të fundit), takimet me shqiptarët, për Parisin e Pestë apo të Gjashtë siç shkruante ai dhe padyshim për Parisin e Letrave, atë të Shkrimit, aq të çmuar dhe jetike për të. Kujtimet duken pambarim siç mund të shkruaja gjatë kur më kërkoi ta shoqëroja në atelieron e piktorit Omer Kaleshi, të cilin nuk e kishte vizituar më parë dhe ku lindi ideja e librit të ardhshëm “Arti si mëkat”, shkruar për të. Ishte interesante ta shihje habinë e tij me atë atelier-apartament, me rroba karakteristike të varura si për të dëshmuar origjinën e tij shqiptare, aty mes atyre tablove dhe kokave të pikturuara të historisë ballkanike. Për disa çaste të gjata ai vështonte pa folur atë seri kokash ballkanike, të shkëputura nga trupi i tyre, por Omeri i paqtë ndërkohë i tha: “Në fillimet e mia si piktor, pikturoja portrete por ati im, hoxhë, më qortonte: Mos pikturo fytyra pasi është mëkat ndaj Zotit”. Por Omeri nuk do ta dëgjonte atin e tij dhe Kadareja do të hskruante një ese mjaft të bukur për kokat e tij dhe luftrat ballkanike. Po kështu si mund të harroj vizitat e përbashkëta në Vesdun, në Rennes në një ngjarje të rëndësishme kulturore e shumë të tjera duke kujtuar këtë çast restorantin e bukur “Treni Blu” në stacionin e trenave që shkonin për në jug, “Gare de Lyon”. Por e rëndësishme është të shënohen “stacionet” më të rëndësishme për të kuptuar Kadarenë. Në të ardhmen, admirues të letërsisë së Kadaresë, njerëz që e kanë njohur vitet e fundit në Shqipëri do të kenë kështu mundësinë ti shkelin këto itinerare për të përjetuar jetën e shkrimtarit të madh.

Ky itinerar do të jetë gjithashtu interesant dhe për brezat e rinj të shqiptarëve, të letrarëve të rinj që do të vijnë në Paris për të përjetuar jetën dhe veprat e shkrimtarit, një udhëzues për vendet ku ka shkelur dhe ka jetuar, rrugët që ka përshkuar, për të fiksuar si të thuash ekzistencën e tij të përherëshme dhe kujtesën e një letrari që shënoi shekullin e vet, e një bardi që i këndoi Shqipërisë së lashtë dhe asaj moderne. Kështu ata do ta përfytyrojnë këtë gjeni të letrave që vazhdon brezhjet e tij në botën parisiane. Helena Kadare është padyshim kronistja më e mirë dhe e pagabueshme e Ismail Kadaresë duke na sjellë gjithashtu dhe informacionin e ardhjeve të Kadaresë në Paris në vitet ’70 (duke filluar nga 1971), takimet me ambasadorët shqiptarë Javer Malo, Dhimitër Lamani apo Misto Treska, mbi letrat që i dërgone asaj Kdareja nga “Hotel Derby” janë padyshim letra sa personale aq dhe politike e filozofike, që së bashku përbëjnë atë që mund ta quajmëitinerare kadareane në Paris. Është e habitshme që ndërkohë që eci nëpër « Rue Monsieur le Prince » (ku në vitet 30 banonin studentët shqiptarë) në mënyrë instinktive më shfaqet figura e Kadaresë. Është një figurë që do të endet për një kohë shumë të gjatë nëpër rrugët e sheshet e Parisit, duke u shfaqur në vendet ku ka jetuar, shkruar dhe dashuruar, ku i trishtë dhe i zemëruar ndonjëherë e ka braktisur atë vend për të ardhur sërish të nesërmen...

### Në vend të hyrjes (Gjetjet gjuhësore e stilistike)

Veprat e Mehmet Krajës duhet lexuar me kujdes e vëmendje, sikur përkëledh fëmijën e vet kur fle dhe je plot kujdes që mos ta zgjosh nga gjumi magjik i tij që e rrit; ashtu edhe gjuha e stili i këtij shkrimtari është aq i gdhendur dhe i përsosur që duhet pasur kujdesin e botës për të mos e prishur, por vetëm duhet lexuar e shijuar... që të mos prekësh asgjë nga ajo botë e përsosur. Gjuha dhe stili i veprës së tij bëhet edhe më i pasur kur kemi parasysh dimensionin filozofik të tregimeve me ndërthurjen e rrëfimit, temave e motiveve si: vetmia e kotësia, qielli e deti, vdekja dhe jeta; nocione që janë në harmoni, por edhe në kundërtënie: ato thurin, por edhe shthurin konceptin hapësinor dhe kohor të rrëfimeve. Ky shkrimtar ka një aftësi gati-gati të pamundur për të rrëfyer bukur dhe mirë në kuptimin e plotë të fjalës.

Janë dy fragmentet e mëposhtme që e dëshmojnë bukurinë e stilit, gjuhës dhe temës së bashku:

Fragmenti i parë:

*“Shtëpia e Zukes për një kohë qëndroi ashtu e heshtur, sikur ajo ‘derë e parajsës’ të qe një portë misterioze që nuk do t’i hapej askujt. Lufta që sillej andej rrotull, një natë, më në fund, gjeti një shteg të hynte në qytet dhe ca njerëz hijerëndë e enigmatikë, pasi bënë bisedime të fshehta nën një tendë ushtarake krejt afër portit, iu sulën shtëpisë së Zukes dhe atje bënë gjëra që njerëzit e patën të vështirë t’i merrnin me mend. Disa thoshin se, pasi u zhdëpën së ngrëni mish thëllëze dhe pasi pinë tre dymixhana verë të Francës, që Zuka i paskësh sjellë me veti, dhe pasi bënë dashuri secili me nga dy vajza (një brune e një të bardhë), ajo farë komisie a çfarë ishte, vendosi që qytetin t’ia linin në dorë askujt tjetër pos Zuke Kalimanit, që ajo ta qeveriste dhe ta kthente atë në një parajsë të vogël, në të cilën kohë pas kohe do të ktheheshin njerëz nga detrat e botës, të tillë që aq shpesh i zinte dëshpërimi dhe bjerrakohësia”. (“Zuke Kalimani dhe stjuarti i çalë”).*

Fragmenti i dytë:

*“Tash më duket shumë e zorshme me i kallxue ato gjana ndodhun atëherë simbas rendit e simbas kohës, mbase për një arsye të thjeshtë: përzihen heraherës me një dishir të papërmbajtshëm me përshkue ndër ndiesi e ndër tallaze mendimesh pamje të vagullta e joshëse e dritëdhanëse qi pluskojnë në ajrin mbushun rrezellimë diellore, e me ndie prap atë aht mallëngjyes e atë heshtim shejtnuer t’asaj bote të mshëfun ndër skutat ma të pambrijtshme të kujtimeve, ndërkohë qi sipri saj enden pamje të reja, diku me hijëzime të errëta e diku me vesim të bardhë e të tejkyrshëm. Due me kjen prap atje me pa hanën e bardhë se si zbret qiellit të sedeftë e ndalet te një shkamb motnuer dhe aty rri e shikon ftyrën e vet në liqenin e mbushun me njimijë hanëza të tjera, qi rrethojnë krejt pellgun e shkojnë deri atje përtej në një valëzim argjendi shkrimun e derdhun pa kursim! Due me kjen prap atje e m’u fut n’at pyll kshtenjash rrethue gjithandej me hije gjelbroshe e me ecë giatë e giatë, tuj trazue me kambë vjeshtë e fjetun ndër gjeturinat e verdha e fëshfëritëse, m’i trazue të gjitha e të gjitha ato vjeshta të fjetuna atje e me ndie atë tingllim të paharrueshëm zanash qi vijnë nga përtej murit të heshtjes, e masandej m’u shtri në fier të butë e të njomë e me pa atë copë qiell të bruztë rrethuem kunorash të blerta. Due me kjen prap atje! Por, ah! se ç’m’i ngatërron e m’i trazon këto pamje të madhnueshme e të brishta një ndiesi e errët, e zymtë, paspjegueshëm e errët e e zymtë, e e vjetër e e harrueme, qi pikon në shpirt dhe përziëshëm mbështjell atje me një tis andrruer, si një duvak i zi qi ndan nga kjo botë dhe e mërgon tëhu dhimbjen e pangushllueme. E unë jam aty, në atë vijë të padukshme, natë brerore drite dhe nuk e di pse prirem gjithmonë andej, te*

*“Nga një largësi e ëndërrt erdh sërish këndimi zëhollë i Mrikës, që çante përgjysmë një rreze dielli”... (Tregimi “Mrikalemi dhe Dardhojmeli”)*

# Mrekullia e rrëfimit të shkrimtarit Mehmet Kraja apo stili është gjithçka

Nga Dr. Haxhi Shabani

*gjysa tjetër e botës veshun hijesh të pakjarta e mbushun regtimë dhimbjesh çfilitëse*. (“Historia e një andrre të hershme”)

Shkrimtari Mehmet Kraja vende-vende, si në tregime ashtu edhe në romanet e tij, e ngrit nivelin e stilit, përkatësisht përdorimin gjuhësor të shqipes në atë shkallë sa që të shkon mendja se duhet arkivuar si të tillë, për ta shpallur të mirë kombëtare. (Dy fragmentet e mësipërme janë dëshmi për këtë, sikurse edhe fragmentet e tjera që do të jepen në vazhdim të këtij shkrimi).

### Rrëfimi deri në pamundësi, deri në pakufi

Duhet pohuar se hapësira dhe thellësia e rrëfimit të prozës në tërësi të shkrimtarit Mehmet Kraja, por edhe tregimit në veçanti janë thuasht të pakufishme dhe tejkohshme. Ai me rrëfimin e tij kalon kufijtë kohorë dhe hapësinorë të së mundshmes, prandaj mund të thuhet se rrëfimi i këtij shkrimtari shtrihet deri në pafundësi, deri në pakufi.

Ai di ta përdorë letërsinë, por jo ta shpërdorë. Thuhet se letërsia e Kosovës ka shkruar pak për krimet që janë bërë ndaj shqiptarëve në luftën e fundit. Por a është vërtetë kjo? M. Kraja edhe në tregimet e tij, përfshirë edhe tregimin ‘Mbreti’, shkruan për krimet e reja dhe të vjetra të fqinjit verior.

*“Nga të katër anët syri nuk të zë gjë tjetër, pos kufoma të prishura njerëzish, të shqyera nga bishat, disa tek dergjeshin të pavarrosura mbi dhë, e disa të tjera tek notonin mbi ujërat e lumenjve, të fryra, të irnosura, të zeza, me sy të zgurdulluar, të cilët, po i shikove gjatë, të duket sikur përqeshin botën e të gjallëve. E pashë me sytë e mi një çakall teksa hante rropullitë e një fëmije dhe atë çast m’u bë sikur u çka qielli dhe sikur që andej filluan të binin kufoma të tjera, që e mbuluan botën anë më anë. Midis tyre, madhëri, më besoni, e pashë edhe timen, e, më ndieni për guximin që marr të them, edhe tuajën”...*

Kurse teatri i heshtjes, që mund të përkufizosh një pjesë të tregimeve të këtij

autori, shprehur me një dendësi teksti të skajshëm flet shumë (tregimi “Teatri”), shoqëruar me dhimbjen përtej të mundurës (tregimi “Restoranti i qepve”).

Si shkrimtar i përmasave të mëdha, Mehmet Kraja komunikon edhe me shkrimtarë të tjerë.

Fryma e shkrimtarëve të tjerë në tregimet e M. Krajës është më shumë e ndërdijshme, e fare pak e vetëdijshme. Aty-këtu, siç kanë vërejtur të tjerët, ka pak magji sikurse te Gabriel Garsia Markez, apo pak shi e mërzi nga Ismail Kadare. Këto lloj shoqërimesh nga shkrimtarët e përmendur; nga i pari vërehet krijimi i një mjedisi magjik dhe tërheqës që është më i bukur dhe i besueshëm sesa në realitet, kurse nga i dyti del përmes leksikut (fjalësit).

Ngulmimet e shkrimtarëve që përmes përdorimit të fjalorit, përkatësisht pasurisë së varianteve letrare të toskërishtes ose gegërishtes është sprovë të cilën me sukses e kanë përballuar edhe shkrimtarë të tjerë shqiptarë (Jakov Xoxe, Vath Koreshi, të cilët kanë përdorur edhe variantin gegë, sikurse Mehmet Kraja që në veprën e tij përdor edhe variantin toskë). Dhe ky veprim i këtyre shkrimtarëve ka qenë i qëllimshëm, për t’u bërë i lexueshëm nga tërë areali gjuhësor i shqiptarëve. Dhe kjo teknikë është një vlerë më shumë e prozës së tij. A nuk i ngjajnë për nga cilësia regjisorët më të mirë njëri-tjetrit, kështu edhe shkrimtarët, arkitektët e fjalëve të gjuhëve, mjetit më efikas të komunikimit.

### Kur letërsia dëshmon historinë

*“Derisa rrija ashtu i kredhur në qëmtimin e asgjësë, e cila ishte formësuar para meje si natë e si det e si udhëtim rrethor, hetova se dikush prapë m’u afrua dhe sërishmi zuri vend pranë meje. Çfarë do të më thoshte? Asgjë. Se paskësh qenë një herë e një kohë një natë e qetë, një natë e mrekullueshme; se dikur atje tej, në lindje të Detit Jon kishte qenë edhe një hënë që ishte zhdukur papandehur dhe se vendin e saj tani e kishte zënë nxirojsja e tepërt, e padepërtueshme, e panevojshme... - Ai vdiq, - tha si me të mërmëritur, me një zë që shtrihej horizontalisht nëpër natë.*

*- Kush?*

*Dhe me vrik u ktheva nga ai, ndoshta që t’ia shihja fytyrën dhe nga pamja e saj të merrja vesh se ç’kishte qenë ajo vdekje e ardhur aty aq papandehur.*

*- Im atë, - tha ai me një përhumbe prehëse në fytyrë. - Ishte çam, çam i lindur atje. - Dhe me dorë tregoi një pjesë të natës, e cila nuk kishte asnjë shenjë dhe nuk shquhej me asgjë në atë errësirë të shtrirë në të gjitha përmasat e hapësirës. - Nuk e di, nuk e di përse më tha të mos e kujtojmë më kurrë... Vallë, ta ketë dashur aq shumë vdekjen?”* (tregimi “Vdekja e çamit”)

Ja këtu del qartë një nga tmerret e një tragjedie ndaj shqiptarëve, tmerret e krimeve ndaj tyre, të

cilët ata që i kanë bërë janë përpjekur që të mos lënë gjurmë. Ky tregim është dëshmi se letërsia edhe një herë shkruan historinë më mirë se vetë historia, atë historinë tragjike të Çamërisë dhe çamëve. (Çamëria dhe çamët janë një krim i ndodhur, të cilin ata që e kanë shkaktuar kanë bërë përpjekje për ta fshehur). Historia shqiptare historinë e çamëve e ka heshtur, politika e përdor për konsum praktik deri në pështirosje, kurse ky tregim i Mehmet Krajës këtë pjesë të historisë së shqiptarëve e gdhend me shkronja eshtërore që nuk zhduken dot.

Kam menduar gjithnjë se romanet e Mehmet Krajës janë pjesë e elitës së tërësishme të letërsisë shqipe qysh me leximin e romaneve të tij të parë. Me riliximin e tregimeve të tij, mendoj se edhe kjo pjesë e krijimtarisë së tij është pjesë e kësaj elite. Ndërsa, edhe pse dihet ky fakt, në letërsinë e sotme shqipe ka të atillë që përpiqen ta mohojnë. Kurse absurditeti i prozës së Mehmet Krajës, është (mos)



përkthimi i saj i duhur dhe cilësor në gjuhë të tjera. Në këtë rast, pa zmadhime, mendoj se nuk humb letërsia e tij, vlera e saj është aty, sidomos në romanet e tregimet e tij, por humb vetë lexuesi jo shqiptar, përkatësisht ai që nuk e njeh këtë gjuhë.

Shkrimtari Mehmet Kraja në prozën e tij tregimtare nuk gëlon ide revolucioniste, por ai shtron ide evolucioniste: sipas së cilave çdo gjë ka kohën dhe vendin e vet.

*“U ktheva në shtratin tim, duke tërhequr këmbët zvarrë mbi dyshme dhe u shtriva me fytyrë të kthyer nga muri, për të gjetur mbi verdhësinë e tij të ndotur po ato njollat e gjithmonshme, nëpër të cilat kaloj pa vështirësi dhe futem në një botë të patrajtshme, në një botë amebash dhe gjolesh të pështirë, atje ku fillon gjeneza e të gjithave. Kështu bëra edhe kësaj radhe dhe kështu do të bëj gjithnjë, derisa hekurat e ndryshkur të kalben e të bien nga dritaret e shtëpisë sime”.* (tregimi “Burgu”)

Të shkruash tregime për asgjënë dhe gjithçkahun, kjo ndodh në tregimet e Mehmet Krajës. Ai edhe kur shkruan për vetminë, rëndomësinë, heshtjen, mendimet e pazbërthyeshme; zbulon nuancat e tyre, duke i bërë të flasin më shumë se çdo e bërtitur njerëzore. Rrëfimtari i tij nuk pisket, por edhe kur hesht flet më shumë sesa të ketë edhe sokëllimat më të mëdha të kësaj bote.

Tiparet e tjera të tregimeve në këtë zgjedhje, qofshin ato strukturore, përmbajtësore e figurative plotësojnë dhe e përmbushin mendimin se autori bën vepër tërësore në prozë. Kështu p.sh. harrimi i vetes në tregimin “Astrologu” dhe shkaktimi i vdekjes me toruturë psikologjike në tregimin “Maestroja” janë teknika rrëfimore që plotësojnë mozaikun e llojlojshëm. Kurse, në tregimin “Shkodra e rrethuese në tri pergiasime”, autori është një vazhdues dhe zhvillues i traditës së rrëfimit të shkrimit në gegërisht në stil, gjuhë, mendësi e filozofi, që herë-herë rri bukur e mbështjellë brenda një atmosfere mistike duke shpalosur edhe më gjerë dhe më thellë këtë shtrat të prozës shqipe ndërtuar që nga shqipërimet e Gjon Buzukut e fillimin e shkrimit origjinal në shqipen gegërishte nga Pjetër Bogdani e deri te proza e Ernest Koliqit e Martin Camajit. Ndërkaq, për tregimin “Zuke Kalimani dhe stjuarti i çalë”, mund të thuhet se “të gjithë i sjell në gisht një femër”, apo kur rrëfimet e mëdha tregohen përmes historive të vogla e njerëzore, përballë luftës, ushtrive, fitoreve e humbjeve; na dalin fatet e vogla, jeta e njerëzve të zakonshëm e të pazakonshëm, të cilët gjithsesi janë shumicë në këtë botë.

Mehmet Kraja është shkrimtari që përmbys e kundërshton histori, kode, mendësi apo i relativizon ato (konstatim i Basri Çapriqit), duke dhënë alternativën e tij dhe duke i rimodeluar ato, në të cilat në të shumtën e rasteve dominon humbja përballë fitores, vetmia karshi të qenit bashkë, vdekja përballë jetës, prishja e fjalës së dhënë kundruall mbajtjes së saj (tregimi “Tanusha”). Prodhimet letrare të M. Krajës në të shumtën e rasteve janë e kundërta e triumfit të jetës, siç fundi-fundit është edhe jeta reale: a nuk mundet ajo, pra jeta nga vdekja, sado që të zgjasë?!

Duke këmbëngulur në tiparet e stilit të autorit, për të mund të thuhet se është prozatori poet, apo më shumë romancieri poet, që janë sintagma që i shkojnë shumë për shtati shkrimtarit Mehmet Kraja, përkatësisht veprës së tij. Nënteksti, shkrimi i figurshëm, shtresat e shumta të leximit që duhet nënkuptuar te tregimet e tij, por edhe te romanet e tij, përgjithësisht janë nga veçoritë dominuese të strukturës së kësaj vepre. Përgjithësisht këto tipare të veprës letrare janë karakteristike për veprat poetike, por në rastin konkret, kur vepra në prozë, siç është fjala për prozën e Mehmet Krajës, i ka këto veçori, atëherë ajo rrit nivelin e saj artistik, ndonëse mund të humbë lexuesin e

gjerë dhe lehtësinë e të përkthyerit në gjuhë të tjera. Prandaj mund të thuhet se tregimet dhe romanet e Mehmet Krajës kanë shumë poezi të vërtetë, po aq sa edhe poezia e mirë dhe e vërtetë si formë. Por dimensionet e poetikës, përkatësisht të tregimeve të këtij shkrimtari nuk përfundojnë këtu. Ato herë-herë përshkohen nga një satirë e hollë dhe një groteskë, duke përfshirë edhe hapësirat e absurdit që dalin në tregimet e këtij shkrimtari. Kështu tregimet përfitojnë elemente shtesë, rrisin bukurinë e stilit dhe gjuhës si dhe shtojnë shtresat shumëkuptimëshe të temave e motiveve rrëfimore tregimtare. Absurditeti deri në pamundësi, mund të quhet një studim i veçantë për disa nga tregimet e Mehmet Krajës (tregimet “Lajmëtari”, “Kanibalët”). Narratori i këtyre tregimeve na shpie në zona të skajshme dhe absurde të jetës e të vdekjes, luftës e paqes, lirisë e robërisë, saqë bëhen të diskutueshme e të papranueshme, madje shumë postulate e parime të cilat kthehen kokëposhtë, duke u transformuar në raport me ato të zakonshme që njihen nga bota njerëzore.

Ja një fragment i këtillë:

*“Oficeri i policisë më dëgjoi indiferent, pastaj tha se midis dëshmitarit dhe të dyshuarit për një vrasje ndodhte të mos kishte dallim të madh. Unë i shpjegova se në korridorin e asaj komandës lokale të KFOR-it kisha qëndruar më shumë se dy orë, por askush nuk ishte marrë me mua, sepse ushtarët e KFOR-it kishin qenë të zënë, njëri pas tjetrit ishin futur në një kthinë në fund të korridorit dhe i qenë hedhur sipër përkthyeses, e cila, meqë ra fjala, vinte e bëshme nga trupi dhe ishte shumë e zhgënjyer me lirinë e Kosovës”.* (tregimi “Borë”)

#### Për botimin

Shkrimtari Mehmet Kraja si përfaqësues i kulmeve të prozës shqipe, me romanet dhe tregimet e tij në këtë përzgjedhje të tregimeve, vjen me një zgjedhje që e ka bërë vetë ai, nga tërë krijimtaria e tij tregimtare gjatë viteve.

Botimi i veprës së parë të shkrimtarit kaq të rëndësishëm për letërsinë shqipe, siç është Mehmet Kraja, dhe kaq të vonë në vendin e tij të lindjes në trevat etnike shqiptare në Malin e Zi, flet për një absurditet të llojit jashtëletrar. (Kujtojmë se Mehmet Kraja ka lindur në Kështenjë të Krajës, pranë liqenit të Shkodrës, kurse gjimnazin e ka kryer në Ulqin). Sido që të jetë, shoqata e “Art Club”-it nga Ulqini me botimin e kësaj vepre po bën një punë që duhej bërë vite e vite më parë. Kurse titulli i këtij libri “Histori të ëndrrave të hershme” është marrë nga titulli i tregimit të tij “Historia e andrrave të hershme”. Janë të rrallë shkrimtarët e letërsisë shqipe, sikurse është Mehmet Kraja, që përfshijnë në veprën e tyre kohë e hapësira të ndryshme, por prapëseprapë mbesin të lidhur me identitetin e origjinën e tyre; gjuhën, historinë e kombin, përkatësisht vendlindjen, duke i pasur këta të fundit shtratin kryesor dhe pjellor letrar.

#### Për fund

Romanet dhe tregimet më të mirë të Mehmet Krajës janë mrekullia e rrëfimit për jetën dhe shtresat e para dhe të papara, të dëguara dhe të padëguara, të prekshme dhe të paprekshme të njeriut, kohës e hapësirës, jetës dhe dashurisë, vetmisë e pritjes, humbjes e zhgënjimit; të nocioneve të dukshme dhe të padukshme filozofike të thëna e të pathëna, të cilat presin studiuesit për t’i studiuar, përkatësisht përkthyesit për t’i përkthyer në gjuhë të tjera; për të konstatuar vlerën e një shkrimtari botëror, për nga niveli estetik, pasi ai vetë e ka bërë punën e tij, e ka shkruar veprën që ka përmasat gjithëpërfshirëse të këtilla.

## Bujar Skëndo dhe romani “Flijimi i maskave”

Nga Çerçiz Loloçi



E kam lexuar dy herë romanin e sapopublikuar “Flijimi i maskave” të Bujar Skëndos: një herë në dorëshkrim siç ngjet zakonisht mes të njohurve të hershëm dhe herë tjetër pasi ka dalë në shtyp nga botimet Onufri. Është romani i dytë i autorit, po me të njëjtin botues që dëshmon se është një zë i veçantë në letërsinë bashkëkohore shqipe.

I njohur kohë më parë si redaktor në të përjavshmen ‘Drita’ dhe kritik arti, me të dy librat e botuar njeri pas tjetrit, Bujar Skëndo ka hedhur një hap të sigurt në prozën romaneske, si për temat e mprehta që trajton ashtu edhe në kompozicionin e veprës e skalitjen e personazheve.

Ndjesia e parë që merr nga romani i dytë, “Flijimi i maskave” është kurajoja intelektuale për të dhënë mjeshtërisht ‘anatominë’ e shoqërisë së sotme shqiptare që është kapluar nga korrupsioni, krimi, pasiguria; përzierja e fortë e niveleve më të larta të katër pushteteve me botën e nëdsheshme që shfaqet në mori formash e që duket sikur grish edhe qiejt me shumëkatëshet, restorantet, baret e hotelet që në metropole europiane kanë dashur disa dekada për t’u ngritur.

Duke jetuar midis Nju Jorkut dhe Tiranës, autori sjell mjedise dhe personazhe shqiptare, jo thjesht si raportime mediash që janë vetvetui lajmësit e parë të dukurive negative në një shoqëri, por duke operuar me dy linja: e para me një biznesmen që rikthehet në vendlindje për të ngritur bizneset e tij dhe që tashmë kërkon të

gjejë edhe shoqen e jetës dhe linja e dytë, ajo e individëve që janë pasuruar me gjithfarësoj mënyrash dhe tashmë duan të hyjnë në politikë, madje duke pasur edhe përfaqësuesit e vet në pushtetin më të lartë, atë legjislativ.

Një temë aktuale si ajo që krimi shfaqet në majat më të larta dhe prek çdo nivel, kriminalizimi i një shoqërie të tërë, pra kjo temë ka përherë një rrisik, atë të rendjes pas paraqitjes së dukurive më të shëmtuara, por jo e ardhur artistikisht me mjetet që kërkon romani.

Autori këtij rrisiku i ka shpëtuar mjeshtërisht jo thjesht e vetëm sepse e ndërton veprën e vet me pak personazhe, por sepse ai arrin një krijim artistik që sa i përket botës shqiptare, aq mund të gjendet edhe në atë serbe, maqedonase, bosnjake, në krejt Ballkanin Perëndimor ku ka demokraci hibride, nuk funksionon asnjë pushtet, shtetet kanë një shkëlqim të rremë fakesdek e zhurmues po brenda saj do të gresh shëmti dhe akte të frikshme, dhunë, kaos, zgjedhje jo të lira, autokratë nga të gjitha krahët që shkon sa te njeriu më i zakonshëm e deri te kreu i vendit.

I konceptuar në dy linja dhe me dymbëdhjetë kapituj romani spikat për zhirime të thella psikologjike, për personazhe që kanë veçantitë e tyre dhe fate të ndryshme; nga njëra anë është biznesmen Dritani me Emën, ish aktore e Teatrit Popullor dhe tashmë drejtuese e një program televiziv që duan të kurorëzojnë lidhjen e tyre mes të njohurish të hershëm në lokalin misterioz “Korbi i bardhë”.

Linja e dytë ka gjithashtu një personazh interesant, Leoni, që i përket botës së krimit, por që arrin edhe në sferat e larta të politikës; çunat e tij besnikë janë atashuar me një parti kapobande që gjithçka e arrin me para, dhunë, vrasje dhe krime të tjera.

Poeti i mirënjohur Sadik Bejko vlerëson te Bujar Skëndo “gjuhën artistike të romanit, fjala e gjetur me saktësi e ngarkesë emocionale dhe stili i rrjedhshëm. Problematika e romanit është e mprehtë dhe e guximshme. Në roman ka figura të realizuara mjeshtërisht si Leoni, Ema, Dritani etj”.

Ndërsa profesor Bardhosh Gaçe veçon trajtimin e problemeve mprehta të tranzicionit tonë në romanin ‘Flijimi i maskave’, për përplasjen e interesave të qytetarëve me ato të politikanëve dhe për shtrëmbërimet e demokracisë në vendin tonë. Ai tha se i kam pritur këto romane nga Bujar Skëndo. E dija që një ditë ato do vinin”. Gaçe vlerësoi, gjithashtu, nivelin e lakmuar të shprehjes, stilin dhe nëntekstet e fjalës e të mendimit.

Vetë autori në promovimin e librit te librari ‘Onufri’ pohoi se në këtë libër kemi një realitet i pangjashëm, i dhunshëm, armiqësor, i korruptuar nga zyrat më të rëndësishme të shtetit, në qeveri, në Kuvend, nëpër drejtori tenderash... Krimi, pasi pastroi paratë dhe vetveten, hodhi edhe një hap më tej: Joshi me para dhe korruptoi politikën, u fut në parlament e qeverisje. Dhe politika, qëllimimisht e me dëshirë të pafre, ndau pushtetin me krimin. Por krimi nuk u ndal me kaq. Korruptoi edhe edhe një pjesë të qytetarëve, votën e tyre. Maskën e vetvetes ua vendosi, në fillim politikanëve e më pas edhe qytetarëve, të cilët e pranuan atë. Pushtetarë me maska e pa fytyrë. Ose me fytyrën e dytë a të tretë... Dhe me po aq maska. Dëshiroj të theksoj se romani është një refuzim artistik i kriminalizimit të vullnetshëm të pushtetit dhe të çdo aspekti të jetës së vendit. Është një mospajtim, një pakënaqësi, një dyshim i madh, të përthyerat të tëra këto nëpërmjet artit të së vërtetës. Sepse letërsia nuk është thjesht tregim i të vërtetës, por art i të vërtetave të jetës. Në roman, nëpërmjet figurash artistike e ngjarjesh, episodesh rrëqethëse zbulohen artistikisht të këqiat e këtij tranzicioni të tmerrshëm. Dhe po ashtu të këqinj të, djajtë e vërtetë të këtij vendi”.

### BUJAR SKËNDO

## Flijimi i maskave



OnufriRoman

## EXODUS

Rrafshinat në rrëzë të Maleve të Dajtit/Sinait,  
Janë ekranet ku predikojnë analistët tanë,  
Shenjat janë të qarta-shkurret që digjen,  
Faraonët kanë zëvendësuar Zotat Paganë.

Dhe ne na duhet të ikim. Moisiu-drejtor Bankash,  
Na tregon çdo ditë fatura të pashlyera kurrë;  
Pesë herë na mësyen epidemitë e murtajave,  
Duke i lënë qyteteve tona veç beton dhe gurë.

Udhëtojmë në gamile-avionësh, me kuaj- gomonesh,  
Asnjë sakrificë qëngjash nuk sjellë më paqtim,  
Zotat janë zemëruar me ty, apo ti vetë,  
Prapë je i zemëruar me Zotat, Babiloni im ?

Qershor 2025

## VETËM PAK KUJTIME MBETEN

Vetëm pak kujtime mbeten  
Barishtet e detit në breg, si ca kafshë që jepnin shpirt,  
Dhe indiferenca e njerëzve; pulëbardhat që qanin në erën  
e marrë,  
E cila frynte nga deti; dhe pulëbardhat që u zhdukën nën  
një qiell të hirtë;  
Ca gaforre që nxitonin të fshiheshin poshtë një shkëmbi  
me lëmyshk,  
Dhe një plazh i braktisur për të zbuluar vetmitë,  
Të shtrira në shezlonget e lagura pranë ujnave të  
Adriatikut.

Shumë e shumë vite më parë, aq shumë vite,  
Sa të jenë të mjaftueshme që era prapë me të marrë  
Si ato pulëbardhat që era i mori në një qiell të hirtë  
Dhe për pesëdhjet vite askush nuk e di fatin e tyre, nëse  
arritën të fluturojnë  
Apo krahët e tyre u thyen duke u përplas në tokë, si një  
avion  
Nga forca e eres a nga gjuetarët ‘që qëllonin ashtu kot, në  
ajër,  
Aq sa dhe ne të dy të humbisnim njëri tjetrin  
përgjithmonë.

Qershor, 2025

## KASANDRA

U lind poshtë një ylli të përgjakur;  
Zotat e dënuan me mallkimin më të tmerrshëm në anale  
gdhendur,  
Do thojë gjithnjë të vertetën që njerëzit ta quajnë të  
çmendur.

E ëma e vuri re e para dënimin e Zotave,  
Kur e dëgjoi të fliste me gjysma fjalësh, për një kalë druri  
fatal,  
Në kohën kur fëmijët e tjerë, mbi muret e Trojës, luanin  
lojëra të pafaj.

Ishte e para që pa flakët e ardhshme të Trojës,  
Trojanët e quajtën të marrë, dhe thërritën mjekët në  
ndihmë,  
Psikoanalistët konkluduan njëzëri se Kasandra është rast  
pa shërim.

Rrugëve fëmijët e Trojës filluan ta gjuajnë me gurë,  
Ndërsa Gjykata e Strasburgut i aprovoi të shoqit të saj  
menjëherë,  
Që në seancen e parë, Divorcin pa apel!

Orakulli i Delfit e këshilloi, ngase ndjeu mëshirë:  
Kasander-pse nuk bënë dhe ti si të gjithë analistët e tjerë?  
E verteta nuk i bënë të lumtur njerëzit, gënjë më mirë!

Kur erdh koha, nën flakët e Trojës që digjej, u shtri të vdes,  
Duke pëshpëritur ca fjalë pakuptim, me buzët e thara në  
kllapi,  
Se Troja të tjera, në shekuj kuaj metalik, bombë atomike  
shkrumb e hi .  
Gjykata e Strasburgut e konsideron çështje të mbyllur  
përgjithnjë!

Maj, 2025



## NUK E KISHIM VËNË RE MË PARË

Nuk e kishim vënë re më parë,

Po bëhej mbrëmje, filxhanët e kafesë qëndronin në një cep,  
Me pafajsinë e tyre të qelqt nuk bënin zë,  
Veç degët e pemëve shtriheshin poshtë e më poshtë, drejt  
nesh.

Kishin dëgjuar çdo gjë. Gjethet dridheshin në erë,  
Apo pëshpërisnin sekrete, kureshtare si gjithmonë ?  
-Ajo kush është? Kush është ajo Zonjë?

Me një gjuhë kalorsiake të shekujve që shkuan.  
Një lule ra lehtas mbi tavolinën tonë.  
Nuk mund të thuash se ishte era që e fryu kot.

Ti e more në dorë atë lule pa emër. Petalet qenë shprishur,  
Si çarçafët pas një nate dashurie gjithë pasion,  
Ah, gjethet kishin dëgjuar çdo gjë që kishim thënë.

Dhe kur u ngritëm, degët u përkulën deri poshtë,  
Jo për mua, në drejtimin e asaj që e quajtën Zonjë  
Me at'gjestin kalorsiak të shekujve që kanë ikë,

Të gjitha lulet u përulen para teje, pa çarë kokën për  
Asnjëri,  
Në Kafë Flora, si të ishin në Sallonet aristokratikë  
Pa përfillë se mund t'i quanin jashtë mode, arkaikë.

Dhe ishte Shekulli Njëzet e Një!

Dhe ekrani i madh vazhdonte të fliste veç për politikë,  
Tek numëronte se sa të vrarë ishin atë ditë.

Qershor 2025

## ERDH LUFTA...

Erdh Lufta,  
Jo më larg se dje ne ishim një Kontinent,  
Sot jemi unë një Vend,  
Dhe ti një Vend.

Erdh Lufta, erdh koha e denoncimeve,  
E shëmbjes së urave, tani që detet me gomone i kalojmë,  
E ngritjes së mureve ndarëse, kur shtëpitë rrënohen,  
E urrejtjes, tani kur ne filluam të dashurojmë.

Erdh Lufta,  
Së bashku ishim një Kontinent.  
Tani jemi unë një Vënd  
Dhe ti një Vënd.

Bombarduesit e Vendit tim fluturojnë mbi Vendin tënd,  
Mbi çatinë e shtëpisë hedhin trëndaflilat që këputa për ty  
sot,  
Bombarduesit e Vendit tënd që fluturojnë mbi Vendin tim  
Më lëshojnë letren tënde të dashurisë shkruar si komplot!

Qershor, 2025

## LONDER, 2025

E çfarë dua unë në Trafalgar Square,  
Atje ku Nelsoni, nga Kolona e tij, që zgjatet në rë,  
Mua, kalimtarin, poshtë nuk e sheh?  
E pse të jem në Parliament Square,  
Para Churchill -it të kërrusur që si Atlas gjithë botën  
mbajti mbi shpinë,  
Përveç vendit tim ?

E përse të vihem në radhë për një vizitë në Westminster  
Abbey,  
Tani që Katedralja është një spot turistik që vizitohet me  
biletë  
Dhe askush për të vrarët e vendit tim nuk dha asnjë  
meshë?

Vërtitem si një afishe teatri të cilën era lart e ngrenë,  
Dhe më sjell te Globus ku shfaqet ‘Romeo dhe Xhuljetë’,  
Xhuljeten këtë rradhë një aktor-transgjender do ta luaj në  
skenë.

Qershor, 2025

## NË MOSKOHË

Numëro orët që s’kemi qënë bashkë,  
Numëro minutat dhe sekondat. Bota do mbushej me Kohë,  
Sahatet e Zvicrës do çakordoheshin nga pesha, Kulla e Big  
Benit do binte në Tamiz,  
Dhe do mbytej bashkë me rrahjet e tingujve të saj si në një  
Blitz.

Numëro orët që nuk kemi qënë bashkë,  
Numëro minutat dhe sekondat. Një kalendar i ri do  
krijohesh kësaj Bote,  
As Gregorian e as Jewish, as Kinez, Islamik, Hindu, Julian  
a Persian,  
Një kalendar i ri ku masa e matjes së kohës,

Do ishte veç mungesa jote.

Maj, 2025

## I BURGOSURI

Është e pamundur që në turmën kaotike të Tiranës,  
Dikush që gjërb i vetmuar kafenë qetë-qetë,  
Të mos jetë ai i burgosuri që u amnistua në vitin Njëmijë e  
nëntqint e tetëdhjetë e tetë.

Ka zënë një vënd larg nga të tjerët. Jo se ka frikë se dikush  
mos ta përgjojë,  
Tashmë hafijet njihen nga gjithë dhe quhen patrozhonistë,  
Kanë miq të shumtë dhe janë modern dhe bashkëkohor.

Por këtë të burgosur askush nuk e njuh, dhe ai s’ka më kë  
të flas,  
Ai që dikur në qeli mendonte se turmat e njerëzve,  
Duke rrjedhur lumenj lotësh do ta dëgjonin jetën e tij më  
pas.

Nuk i njuh ata të cilët flasin në ekrane televizive deri vonë,  
Dhe as emërat e rrugëve a të rrugicave. Qyteti është një  
Shkretëtirë beton,  
Pa hije dhe pemë dhe përrenj dhe zogj. Burgjet në liri nuk  
kanë emrat Spaç a Tepelenë.

Miq t e tij të burgut kanë ikur të gjithë, në Hënë, në Mars,  
në Eden  
Dikush rrëfimtar vuajtjesh për lavdinë e vet,  
Dikush tregtar burgjesh, mik me kryeministra dhe  
Presidentë;

Dhe ai çdo ditë ëndërron të vdes, pa nekrologji dhe  
monument!

Qershor 2025

## KA PRAPË KOHË

Ka prapë kohë për të folur me zogjtë  
Për të dëgjuar rrëfimet e tyre të ngatërruara  
Rreth udhëtimeve, në luftë me retë, stuhitë dhe ciklonet  
ciklopike,  
Të cilat asnjë Homer nuk i ka shkruar ende;  
Ka prapë kohë për atë gjestin vertikal  
Për t’u ngritur në këmbë që të vështrosh perëndimin e  
Diellit,  
Para se të mbytet në thellësitë e detit,  
Duke e vënë pëllëmbën si strehë në ballin gjithë rrudha,  
Ka prapë kohë për t’i takuar miqt që të tradhëtuan.  
Asgjë nuk ka ndodhur - të vjen keq barabar për fajësitë e  
tyre,  
Po aq sa dhe për vitet e tua mbuluar nga pluhuri i Saharës,  
Teksa era vazhdon të fryjë po ashtu si dikur, a si të mundet.

Kjo është jeta ime dhe e askujt tjetër, sikundër e jotja është vetëm e jotja,  
Askush nuk mund ta fshijë atë, si nuk mund të fshihen retë nga qielli i errët,  
Madje si nuk mund të fshihet as dhe një vijë e vetme në fletore,  
Të cilën e vizatuam në një çast hutimi,  
Tek shihnim tek na shfaqej papritë fytyra e një vajze që e deshëm,  
Vite e vite më parë,  
Dhe që tash prehet në një palumturi të vetmuar,  
E pa prekur nga dekadat e viteve a nga terrori i harreses.

BILETË PA KTHIM

Sa herë që më thërrasim miqt nga larg,  
Blej një biletë me kthim,  
Edhe kur vetë ti më telefonon të takohemi,  
Në shtëpinë me derë sekrete që askush nuk e di,  
Bëj kujdes ta kem të sigurt kthimin nesër,  
Duke parë tinzisht oren pasi bëjmë dashuri;  
Mendo pastaj kur më ftojnë në dasëm a në një takim me shkrimtarët,  
Nder i Kombit, Nobelist, i ngjashëm me Franc Kafkën a me Shekspirin vetë,  
Bileta është natyrisht me kthim tri-herësh,  
Me tren, me autobuz dhe me avionin më të shpejt,  
Që të jem i sigurt se nuk do kthehem me vonesë;  
Dhe vetëm kur dua të shkoj në varrezat e qytetit ku linda,  
Të shoh varret e prindërve,  
Blej një biletë pa kthim,  
E di se do më ftojnë të qëndrojë gjatë, shumë gjatë  
Nga malli që kanë,  
E di se çdo çast mund të prehem përjetësisht aty.  
Në shtëpinë e prindërve askush nuk të pyet-sa do të rrish,  
Dhe ti vetë nuk ndjen asnjë nxitim,  
Për të qënë prapë në botën e harruar të të gjallëve!

Maj, 2025

KUSH DO T’I NDEROJË QYTETET TONA

Kush do t’i nderojë qytetet tona të harruar?  
Qytete që ende flenë gjumin e tyre shekullor,  
Thellësira të dheut.

Turistët i mbushën rrugët. Si monedha të përkohshme,  
Turistë kalojnë dorë më dorë në duar tregtarësh, në copa gazetash,  
Dhe asnjëri prej nuk di t’i shqiptojë emrat tanë.

Statujat e thyera që me kokfortësi refuzojnë kirurgjitë plastike,  
Iu kanë hijë gjymtyrët që humbën, plagët, heshtat në duar,  
Dhe atë diskun që duan ta hedhin deri në Venerë.

Sa vetmi që ka në sytë e verbër, a në zgavrat bosh të syve,  
Statujat që janë mbrojtësit e vetëm të qyteteve tona,  
Statujat që shohin nga një kodër e vetmuar,

Me trishtimin e syve të zgavërt prej mermeri të thyer.

ISHULL

Në fillim ishim një masë e vetme ujore  
Përrenj, lumenj, dete ku derdheshim ti dhe unë.

E vështirë t’i dalloja në ujërat pa kufinj  
hapsirat e tua të pafund !

Derisa vullkanet e trupave shpërthyen me vull;  
Copa gurësh, shkëmbinj, llava të ngurta  
Krijuan ishujt tanë. Me zogjtë e parë, mes bimëve dhe pemëve,

Çdo natë përpiqem të deshifroj gjuhën e dallgëve të tua,  
Tek vijnë tek unë, në bregun e detit, mbrëmjeve.

Shkurt 2025



NJË DORËSHKRIM NGA RIG-VEDAT  
(i pagjetur ende)

Vështro sa e bukur është Bota,  
Ky planet që askush kordinatat s’ia di.  
Thellësira brenda thellësires,  
Errësira brenda errësires,  
Kafshët e ujnave oqeanike,  
Aq të shumtë sa dhe yjet në qiejt pa fillim e pa fund;  
Kafshët që ende nuk kanë emra,  
Dhe as që e ndjejnë nevojën që të kenë,  
Lulet që çelin nga puthja e dritës së parë,  
Dhe pemët, shkurret, kaçubet e marinave,  
Që nuk bajnë za në heshtjen e tyre të gjelbërt,  
Pa u mërzit se nuk kanë ende emra latinë  
Dhe përmbytjet dhe avalanzhet shurdhuese, stuhitë  
Që askush s’i mallkon pse janë në kët’botë,  
Dhe kafshët që e dijnë të kuptohen aq mirë  
Dhe yjet që zbresin ndonjëherë mbi Tokë  
Lënë shenja sekrete që askush nuk mund t’i deshifrojë.

Qielli nuk ka nevojë të parafrazohet nga metafora poetësh,  
Kodrat nuk kanë gunga shtëpish dhe vertikale rrugësh që u ngjajnë thikave,  
Pëllumbat dhe zogjt nuk i njohin kafazet,  
Dhe as dorën që zgjatet si një heshtë për të ushqyer trumcakët,  
Ujqërit nuk janë egersira, dhe as çakejt, hijenat, tigrat, leopardët, luanët,  
Sepse nuk vrasin askënd.Dhe koha nuk ekziston,  
Dhe as ditët dhe muajt dhe vitet.Askush nuk mund ta thotë  
Se sa është mosha e një boababi a e nje redwoodi  
Mosha e një bualli plak gjithë rrudha të thella a e një rrazi  
Buzë rruge ku nuk kalojnë as qerre, karroca, makina a tanke  
Për të lënë gjurmë si plagë në dheun e pafaj,

Sepse nuk ka lindur ende Njeriu i parë.

Qershor 2025

NË NJË AXHENSI TURISTIKE, NË RRUGËN ‘MINE PEZA’

Flakët e pyjeve që digjen,  
Zjarret që këmbëngulin të arrijnë zhezhlonget tona, në bregdet,  
Vetë Dielli që djeg si sketerrë;

Nëse doni të kaloni një Verë më të këndshme,  
Pronotoni pushimet tuaja  
Me çmime më të lira, për në Ferr.

Gusht 2024

VJESHTË

Në qytetin e madh kish ardhur Vjeshta,  
Dhe era që frynte papushim,  
Papritur si një gjethe me ngjyrë të artë,  
Era të mbështeti në gjoksin tim.

Përnjëherë e ndjeve vehten ngrohtë,  
E ndjeve vehten aq mirë,  
Si një gjethe në formën e pëllëmbës së dores,  
Po të futej në dorashkë, në dimër.

Do kesh kohë të kthehesh në kohën tënde,  
Tek telefoni jot, WhatsApp, Instagram,  
Te Laptopi, politikanët që presin duartrokित्je,  
Te ndërhyrja kozmetike për gjoksin e madh.

Do kesh kohë të kthehesh te bisedat e modës,  
Të këngët Eurovision, te Big Brother kuplerá,  
Do kesh kohë për zilitë e shoqeve të tua,  
Kur të thonë- Sa e bukur që je! Hatá

Der’ at’herë, ti je një gjethe e artë,  
E strukur rastësisht në gjoksin tim,  
Me gjuhë posh zë të flasesh për koloritin e Vjeshtës,  
Dhe Vivaldin që luan me erën -violinë!

Qershor 2025

Im Zot, ata më therrasin azilkërkues. Por sistemi s'më quan njeri - më njeh si "Subjekti X\_1977\_SH", trashëgimtar i një toke që dikur mbante emrin e gjyshit tim dhe tani njihet si "Zona e riciklimit të mbetjeve urbane, B". Mbj mend që kur dilja me gjyshin të shëtisja në ato toka, ai më thoshte që të vija veshin mbi to. Sapo veshi im prekte dheun, dëgjoja zëra. Gjyshi me shpjegonte që nëse do isha e vëmendshme toka me tregonte të gjithë emrat e njerëzve që kishin shkelur mbi të, por për dreq kurrë nuk munda të dwgjoj , njeë emër a fjalë. Si sot, në këtë rrugicë të errët nuk dëgjoj asnjë zë. Ndonjëherë dëgjoj ndonjë fishkëllimë, sinjal mesazhi, por për dreq telefoni shfaq vetëm një ekran të zi, ku ora rri pezull.

Duhet të jetë ndonjë mallkim, s'ka se si. Kam humbur mes mjegullës në rrugën *Neachells Lane* dhe më duhet medoemos të gjej bankën, *Nationwide*.

Do të thuash që duhet ta gjej vetë, por nuk mundem. Jam një banor i ri në këtë zonë. Veç kësaj, ti më solle në këtë botë kundër dëshirës sime – ndaj më detyroresh të më ndihmosh. Të kujtohet besoj: unë strukesha në fundin e testikujve të tim eti, dhe u lëshova udhë mijëra vëllezërve e motrave të mi, që u sulën drejt një vrime ku një dritë mjegullore – si kjo e sotmja – i thërriste për në këtë botë. Por unë u tremba. U fsheha. Sepse, për dreq, pikërisht atë ditë – në një paraburgim të një burgu komunist – një derdimen me fytyrë të shpëlarë i kapi tim atë për testikujsh me pinca. Ai nuk donte të tregonte të vërtetën rreth një fjale. Fjala ishte "Nationwide", që ai e shqiptoi rastësisht në gjuhën angleze, i dehur, mes shokësh.

Atëherë ndodhi çudia: u nisa drejt sipërfaqes, mu poshtë lëkurës së poshtme të testikujve. E mbaj mend si sot: trupi më përdridhej nga dhimbja. Ulërita. U plandosa përmbys – me orë, ndoshta me ditë të tëra. Që nga ajo ditë, të jam lutur të mos më lëshosh në hojet e nënës sime. Pata frikë. Janë të frikshme skutat e burgjeve, im Zot. Sepse për gjashtë muaj me radhë, im at lëngoi në një qeli. Një dhimbje e tmerrshme mes këmbëve. Dhe pikërisht ai ind i sëmurë, që nuk i bindej shërimit — më mbante mua pezull të shenjuarin e lënduar, që pas dhjetë e ca vjetësh do të ngjiste në mitrën e sime mëje.

Tani, ajo që më çudit është se pikërisht kjo fjalë — Nationwide — më bën të rrekem nëpër këtë mugëtitirë mjegulle për të gjetur një bankë me të njëjtin emër. Më duhet të marr një kredi, ndaj, im Zot, më jep një shenjë.

Mbj mend që në fshatin tim të lindjes, edhe pse nuk duhej të besonim në ty – ishim vend komunist – nëna ime ndizte një qiri pranë fytyrës sime sa herë përhumbesha në makth dhe zgjohesha duke ulëritur.

Ajo thoshte: "Zot, më jep një shenjë," dhe priste ndonjë flutur që të sillej rreth flakës, ndonjë insekt që godiste xhamin, apo ndonjë kërcitje dërrasash në tavan. Ishin këto — sipas saj — shenjat e tua.

Gjithë jetën e kam përsëritur këtë fjali. Edhe këtu, në lagjen e vjetër në Wends Field. I kam dhënë rëndësi çdo gjëje që lëvizte: një shpend që ndalonte në parvaz, tundja e një letre të bardhë në erë, kërcitja e një trangu të thatë. Sepse e vetmja mënyrë për të jetuar në këtë vend është të dish të lexosh shenjat — ashtu siç më mësoi ajo.

Por sot, në këtë mjegull pis, në këtë errësirë që qelbet lagështirë, pranë statujës së Lady Wulfrun, nuk shoh asgjë.

Bëj para, mbrapa, kthehem anash — por të gjitha udhët më çojnë në të njëjtin vend: një hon i thellë ku nuk dëgjohet asgjë, veç një ulërimë e largët... Një kafshë errësire.

Nuk di të them: ujk nga vendi im? Apo dhelpër nga kodrinat përreth?

Teksa përtypt këtë dialog të çmendur me Zotin tim, më në fund shquaj siluetën e një gruaje.

# SHQIPONJA AXHAMI

## NationWide

*-Shkëputur nga romani me të njëjtin titull në dorëshkrim-*



Mjegulla nuk ma lejon t'i dalloj fytyrën. E përshëndes: "Duket qesharake, por kam humbur..."

"Më ndiq," më përgjigjet ajo, me një zë që dukej sikur më kishte ndjekur prej kohësh. E ndjej se nuk kam udhë tjetër. Bindem. Kthina ku po më drejtonte ngjante me vathën e xhaxhait tim. Një vathë e errët ku ai mbante kalin, rraqe të vjetra...

"Unë jam në Wolverhampton," — i them vetes — "ç'dreqin më shfaqet kjo skenë e fëmijërisë?"

"Kalo anash atij pellgu," më urdhëron zonja.

"Xhaxhai yt ka kohë pa ngrënë. Erdhi të kremten e kaluar. Nuk e mbajta më gjatë. Mban lidhur pas qafës, përmes një zinxhiri një arkë. Bën shumë zhurmë kur ecën, nuk pranon ta heqë..."

"Po fle poshtë poshtë urës, por i duhet të zgjohet" Edhe ai është i ftuar nga Lady Wulfrun. Duhet të nënshkruajmë...

"Zonjë," i them me frikë, - "nuk po kuptoj asgjë. Më duhet vetëm të marr një kredi."

Zonja kthen kokën drejt meje dhe më thotë prerë:

"Tani është tepër vonë. Gjyqi ka filluar." E ndjek i frikësuar, por nuk kam zgjidhje tjetër.

Kur sosëm në një tunel që mbulohej nga degë bimësh shoh një godinë pa numër, si e fshehur midis dy epokave — mbi një pllakë bronzi shkruhej

"GJYKATA E TOKAVE TË TRANSFERUARA – DEGA E PASAKTËSIVE HISTORIKE"

Në mes të sallonit të saj ndodhej një tryezë. Rreth saj qenë ulur: Lady Wulfrun, xhaxhai dhe një burrë, që here pas here kollitej. Ndërsa Lady Wulfrun palos kindin prej atlase të pelerinës, xhaxhai fërkon shenjën që i ka lënë zinxhiri rreth qafës. Ajo që më bie ne sy qe vështrimi i Lady Wulfrusë, e cila nuk shprehte as mëshirë, as zemërim, veç një lloj harrese të strukturuar, si një ndërtesë që ruan muret por e ka harruar ç'ka ndodhur brenda. Në mes të tryezës vura re një çekiç argjendi që vënë mbi arkën e vjetër të xhaxhait shkëlqente më tepër. Por qe një shkëlqim acarues që më dëbonte nga kujtimet që më sillte ajo arkë e vjetër, që tani që po e shihja afër më kujtoi

që xhaxhai mbante në të gjera me vlerë, që nuk duheshin humbur.

"Karta me dam",- siç shpjegonte ai.

Gjyqin e filloi Zonja Wulfrun, ndërsa unë ndjeja trupin të mpirë mes makthit dhe një realiteti krejt të çuditshëm, që me grishte ta jetoja gjithsesi... Ndërsa zonja që më shoqëroi u ul bri meje.

"Si fillim më lejon t'ju falenderoj Morgan Le Fay, që gjetët Subjektin X\_1977\_SH. Kishin kohë që e prisnim". Unë shtanga pas asaj fjalie dhe mund të them që makthit po i zinte vendin një tis revolte. Ç'lidhje kishte kjo magjistare e kohës e mbretit Artur me mua? Armike apo aleate e tij? Ç'dreqin po ndodhte? Kthej kokën nga Morgan Le Fay dhe guxoj e pyes:

"Zonjë ju më tradhëtu? Më thatë se do me ndihnit"

"Një fill për çdo padrejtësi", - pëshpëriti ajo, dhe filloi të tirrte nje fije, që nuk e shquaja nëse ishte fije peri apo mjegulle, - indifirente ndaj pyetjes sime.

"Ti kërkon të gjesh bankën, Nationwide, por je keqkuptuar. Banka nuk është një vend ku ruhen paratë. Është vendi ku ruhen fajet — dhe shpërndahen borxhet si trashëgimi.", - theu heshtjen Lady Wulfrun.

"Zonjë unë nuk po kuptoj asgjë. Nuk kam marr asgjë. As kredi, as tokë, as shpresë. Pse më gjykoni?"

"Sepse nuk more. Sepse nuk firmose. Sepse nuk harrove. Këto janë shkelje", mu përgjigj.

"Subjekti X\_1977\_SH a e pranon që toka ku lindi gjyshi yt është tani pronë e një korporate të regjistruar në Ishujt Kajman?", më pyet burri. Ndërsa Lady Wulfrun paloste kindet e atlasit.

"Nuk e pranoj as si tokë, as si pronë. Ishte diçka tjetër — ishte lidhja jonë me shpirtin, me botën", - i përgjigjem me një zë që përdridhej në dënesë.

"Zotëri i nderuar, çdo gjë që nuk është e regjistruar, është e harruar. Dhe çdo gjë që nuk mbahet mend, është e jona", përgjigjet Lady Wulfrun. (qetë, ironikisht):

"Në këtë kuti janë dokumentet që nuk i deshën as gjykatat, as historia. Kjo është trashëgimia ime: letra të djegura, vula të zhdukura, Ndaj toka u shit...", - ndërpret bisedën xhaxhai, që herë pas here i duhet

të kruaj vragën e zinxhirëve.

"Kam një arsenal me dokumente të mohuara! — bërtet sërish ai, duke u ngritur nga banka e dëshmitarëve.

Zëri i tij përplaset mbi muret si një goditje në gur.

Pauzë. Një zë pak i ngjirur, por i thellë vjen nga ana e sipërme e sallës.

"Nuk janë vetëm dokumentet që mohohen. Është vetë kujtesa që falsifikohet." Gjithçka ngrin.

Në galerinë e sipërme të sallës, i mbështetur në një shufër hekuri, qëndron im atë.

Sytë i ka të qetë, por zëri i digjet nga brenda.

"Lady Wulfrun. Ah, zonjë — zonjë me dorashka të bardha dhe duar që kanë prekur çdo kontratë pa u ndotur kurrë!

Në vendin tim të vjetër gurët ende dinë të flasin më shumë se ministrat.

Ndërsa ti je bërë zëdhënësja e një kombi që ka mësuar të heshtë, jo nga urtësia, por nga lodhja. Kështu që duhet ta kuptosh tim bir. Sa për Morgan Le Fay që po tjer rreth tij mjegull, nuk kam çfarë them. Koha do të kërkoj shpagim. Por ju duhet të kuptoni, që im bir është fryt i një nëne që i besonte shenjave, dhe e një burri që duroi burgun e errët komunist. Dhe ju e dini shumë mirë që diktatura nuk kthehet me tanke. Ajo vjen në këmbët e lehta të një dite që e lamë të kalojë në heshtje, para falsifikimeve dhe shitjeve në emër të stabilitetit.

Lady Wulfrun vë buzën në gaz dhe me një zë ironizues përgjigjet.

"Dhe ç'tjetër do, zotëri i nderuar, përveç heshtjes?

Qetësia sjell investime, harresa rrit besimin. A nuk është më e leverdishme të shesësh tokën për garanci sesa ta mbash për varre me ndjenja të tepërta?

Në fund, edhe memoria ka një afat skadence — si çdo mall tjetër që respekton tregun."

Pas këtyre fjalëve im at godet podin e sipërm të sallës me shufrën e hekurt, ksaktësisht 7 herë. Një tingull drithërues godet muret e godinës, sa ndjeva se e gjitha do shembej në çast. Kur tingujt i lanë vend nje heshtjeje sfilitëse që po më merrte frymën, babai shtoi:

"Kujtova se vdekja më kishte çliruar nga nevoja për të dëshmuar,

por ja ku jam, i tërhequr përsëri nga era e një marrëveshjeje që mban aromën e një tradhtie të parfumuar. Toka nuk është vetëm mall — është dëshmi.

Dhe dëshmitë nuk shiten, zonjë, përveçse kur gjyqi është një ritual në hije, dhe historia një pergamenë qe shkruhet nga era që fryn prej fronit.

Lady Wulfrun (e lehtë, por me një vijë të hollë inati nën zën):

Ah, ju të vdekurit... gjithmonë poetë, kurrë praktikë.

Mendoni se vendet udhëhiqen me ndjenja?

Me fjalë të mëdha që fryhen nëpër epoka dhe e bëjnë popullin të qajë, por jo të hajë? Ne veprojmë, ju vajtoni.

Historia, në fund, i mban mend fituesit, jo fantazmat.

Im at (duke u kthyer drejt sallës):

Fituesit, po. Por jo ata që e shesin fitoren për çmimin e parë të harresës.

Dhe kur zëri im të mos dëgjohet më, e kur toka të jetë mbuluar me marrëveshje dhe ndërtim pa rrënjë —atëherë do ta kuptoni se ç'mungon kur kujtesa largohet pa kthim.

Lady Wulfrun (duke ngritur zërin) godet me çekiç fuqishëm tryezën, sa arka e xhaxhait anohet ne teh.

"Ju kërkon drejtësi në një gjyq që nuk ka dënime, por ka vetëm arkivim. Dhe arkivimi është më keq se harresa: është fshirja me firmë."

“Zonjë une jam i dënuar me lirinë për të kujtuar. Dhe mbase, që nga dita kur fjala Nationwide u shqiptua si mëkat, jam dënuar të eci pa hartë, duke kërkuar për një vend që nuk është më —një mbarkombëtare që nuk më njeh, një atdhe që më harroi, një drejtësi që s’ka adresë. Ndaj kthehem nga e përtemja. Se fundja toka jote është aty ku të mohojnë. Kështu që duhet të reflektoni.” – iu përgjigj babai. Dhe pasi goditi 3 herë podin, zbriti poshtë. Unë arrija të shihja vetëm shufrën e hekurit, këmbët dhe zhurmën e çuditëshme të hapave, që dukej sikur preknin copa hekurishtesh. Ai u ndal në një kënd të largët me tryezën.

Xhaxhai heshti. Madje një heshtje e gjatë pllakos sallën.

“Subjekti X\_1977\_SH shpallet i padëgjueshëm për kredi morale.

Zëri mekanik i burrit flet sërish, por tashmë nga një altoparlant:

“Subjekti X\_1977\_SH, afrohu.”

Afrohem duke kërkuar me sy tim at, gufuar makthit.

“Sipas dosjes, kërkon azil në këtë vend mbi bazë të persekutimit historik dhe trashëgimisë tokësore. A është e saktë?”, - pyet burri.

“Kërkoj të më dëgjoni.” i përgjigjem me një ton revoltues.

“Ju lutem, përgjigjuni pyetjes”, - më urdhëron zëri.

“Është më shumë se kaq. Kërkoj të mos harrohem.”, - i ulëras, duke kthyer sytë nga im at.

“Subjekti X\_1977\_SH, në deklaratën tuaj thuhet se kërkon kredi nga banka Nationwide, në bazë të një trashëgimie të mbetur në vendin tuaj të origjinës. A mund të na e shpjegoni këtë? Keni tokë në vendin tuaj të lindjes, apo jo?, - pyet sërish burri.

“Po, por sipas xhaxhait qenka shitur dhe sipas tim eti, na qenkësh harruar. Në emër të stabilitetit. - i përgjigjem burrit.

Në ato çaste dëgjoj zërin e vrazhdë të Morgan Le Fay, që përsërit sërish fjalinë e çuditëshmë; - “Një fill për çdo padrejtësi” ....

Një heshtje e gjatë pllakos dhomën.

“Subjekti X\_1977\_SH shpallet i padëgjueshëm për kredi morale.

Dënimi: të endesh në tokë të huaj me kujtesën që nuk e pranon askush.”

Unë nuk di mbase instiktivisht tunda kokën.

Mes atij makthi, mpirje, ndihesha disi i lehtësuar, të paktën nuk më dënuan me burg.

Por më dënuan me lirinë për të kujtuar — dhe ajo është më e rëndë se çdo qeli.

Tek përpiqem të mbledh veten, dua t’i flas tim eti, por ai, xhaxhai, Lady Wulfrun, dhe burri me të zeza largohen nga një dalje e errët e sallës. Dëgjoj vetëm zërin e tim eti që thotë:

“Lady Wulfrun, shpresoj t’ju shoh sërish ne Apel”

I shtangur , i pafuqishëm për të nxjerrë një klithmë që digjej thellë në kraharoj, vë re që zonja Morgan Le faj më afrohet.

“Mblidh veten” - më thotë, “Na duhet të dalim. Edhe pak porta do mbyllet”

Dua t’i ulëras, por nuk mundem. E vetmja gjë që më çliron ato çaste është një zhgryerrje në tokën e lagësht të sallës. Bëj lëvizje të çuditshme, si të ndonjë kafshe, dhe ne fund në mes dënesave vë veshin mbi dhë. Çuditërisht dëgjoj për herë të parë një zë, një fjalë; -

“I shenjuar”

Kthehem vrik t’i tregoj tim eti, por ai është tretur në terrin e daljes së godinës. E tëra rreth meje është rrugica e lagësht bri lumit që rrjedh ngadalë dhe Hebreu Avraham që ka zënë vendin e tij të zakonshëm dhe gjuan peshq me nje qetësi të pathyeshme. E përshëndes si gjithmonë, dhe ai – si gjithmonë nuk më kthen përgjigje...

# GAQO APOSTOLI

## Sa herë në rrugë kalon një grua

*poezi*



### 1. Sa herë në rrugë kalon një grua

Sa herë në rrugë kalon një grua,  
një kokë burri kthehet pas.  
Kur gjinjtë e saj shpërthejnë si ftua,  
nën bark cunami ngre tallaz.

Sa herë në rrugë kalon një grua,  
këmbët si shina dikush vështrojnë.  
Mendja e burrit dalldis trazuar,  
kur shinat ndjek gjer në stacion.

Sa herë në rrugë kalon një grua,  
plakut i mbushet zemra me gaz.  
Dielli i mëngjesit, kur atë gjuan,  
venit një lule mbi parvaz.

Sa herë në rrugë kalon një grua,  
më ndodh që frymën shpesh ta mbaj.  
Kur ndjej se pas meje është dashuruar,  
shpirti më bëhet oqean.

O Grua, oh grua, o grua,  
veç Zoti e di sa të dua,  
O Grua, oh grua, o grua,  
ti universi je për mua.

### 2. Muza ime e Patjetërsuar

Mos më braktis, Muza ime.  
Pa ty, shpirti im do të ishte i shkretuar.  
Mes poezive të mia unë do të humbisja,  
me vetveten i dashuruar.  
Nga Seuli i ëndrave të mia,  
pas tre orësh fluturimi,  
ende dremis mbi shkretëtirën e Gobit.  
Ajo shtrihet e zhveshur,  
e vdekur, e pajetë  
njëmbëdhjetë kilometra poshtë meje.  
Ti, e gjalla, e bukura ime,  
më pret me padurim mijra kilometra larg.  
Në anën tjetër të Globit.  
Në këtë fundnajë hapësirash pambarim,  
unë ndjej se je nisur  
dhe vjen drejt meje e praruar.  
Je e njëjta si gjithmonë,  
deri në amëshim.  
Muza ime e patjetërsuar.

### 3. Tik taket e zemrës çojnë drejt universit

Tik tak, tik tak...  
Zemra lehtë troket, si sahat.

Bam bam, bam bam, bam bam bam,  
Papritur fort, godet në gjoks.

Ujvara e shndritshme e shpirtit tim,  
dritës së shpirtit tënd  
i përcjell shkëlqim.

Një aureolë e thjeshtë dashurie  
shëmbëllen në horizontin e largët.  
Universi krijon rezonancë.

Më pas gjithçka shndrin,  
shfaqet dukshëm, madhërisht,  
ngrihet tërë elegancë.

### 4. Malli që kam për ty

Malli im për ty  
nuk përmbahet dot,  
më shpërthen në sy,  
më shndrit nëpër lotë.

Zjarre brenda shpirtit  
digjen deri vonë,  
i ndriçojnë rrugën  
dashurisë sonë.

E bukura ime  
eja pa merak,  
mos u mendo shumë,  
hidhu nëpër flakë.

Eja drejt, pa frikë,  
paksa çmendurisht,  
horizont i largët  
na pret madhërisht.

Ti thua, dashuria  
do na çojë në varr...  
Oh, për mua je gjithçka,  
je Ylli im Polar.

### 5. Të kërkoj ty

Mes kësaj bote të cflitur  
plot me njerëz të tronditur,  
çfarë po ndodh  
me mua vallë ?

Asgjë s’më hyn në sy,  
moj mike.  
Vërtitem ende i gjallë,  
nëpër turmat pandemike.

Nuk kam çfarë të bëj  
mes masave gjigande,  
papritur ndej dhimbje,  
dhe të kërkoj ty mes halleve.

Oh, jo,  
më shumë se hallet,  
që të ndjekin nëpër botë.  
më shfaqet në ballë një e çarë e fortë...

### 6. Mall këmbëngulës

Kur malli im  
këmbëngul në telefon,  
ti mos u mërzit,  
kërkon pak vëmëndje,  
sepse ti harron.

Kur shtresat e harresës  
shtohen pambarim,  
malli rrëshqet në hon,  
përjeton mjerim,

Ndjen humbje dashuria,  
zemra zemërim,  
në këtë botë të madhe  
oh, ti gjen,  
veç amëshim.

### 7. I përpiva poezitë e tua...

Vargjet dhe skicat e tua,  
shpirtin ma tejmbushën sot,  
përpiva me një frymë gjithçka,  
u ndjeva plot e përplot.

Natën që zvarritej  
e shtyja me këmbë e duar fort,  
drejt shtratit tënd për të ardhur,  
ah, nuk mundesha dot...

U shtriva gjatë natës  
mbi piktura, skica e poezi...  
Pas teje i marrosur  
derdhja mbi to shpirtin  
dhe farën e trupit tim.

Eja e dashur,  
ngjitu fort pranë meje,  
në shtratin tim  
të bëjmë dashuri.

I lodhur jam,  
për vdekje,  
zemra godet fort  
çdo çast me lumturi.

Oh, nuk do të doja,  
nga ëndrat të ikje përsëri.  
Ky qiell i madh  
na mbron me besnikëri...

### 8. Po nisem drejt teje

Sot do të nisem drejt teje,  
po e braktis Las Vegasin  
që për një lojë pokeri  
më ndau nga ti,  
e dashur...

Po kthehem për pak sërish  
në Seattle/Bellevue,  
ashtu i lodhur,  
tek shtëpia e birit tim,  
këtu.

Do të nisem drejt Tiranës  
dhe sa të mbrij aty,  
i cflitur nga rrugëtimi  
do të hyj i gëzuar  
në tënden thellësi.

Si për herë të parë,  
krejt lakuriq  
hyra brenda tek ti,  
kur çmendurisht,  
bëmë dashuri.

Demi e kupton në fund të korridës,  
kur ndjen papritur shpërbërjen e vet,  
se vdekja ka shijen e një vere,  
që ekuilibri i jetës, e pengoi.

*Soneti XVII i “Vetëtimë që s’ndalet”, nga Miguel Hernández*

Legjendës së gjallë të korridës spanjolle në të gjithë kohërat, toreadorit Juan Jose Padilla. Mbresa udhëtimi gjatë një jave në Madrid, gusht, 1998.

- Jepini njeri - tjetrit shenjë e paqes, si vëllezër që jemi, - tha prifti i moshuar para kungimit për ritin e paqes në kishën e vogël *Iglesia de San Ginès*. U ktheva nga fqinji në të majtë, një kinez që rrinte si statujë e dylltë duke parë drejt altarit pa lëvizur. Edhe fqinja në krahun tim të djathtë, nga veshja dukej një madrilenase që kishte shtëpinë ngjitur me kishën, nuk bëri asnjë lëvizje që të mëshironte besimin dhe të shtrëngonim duart së bashku.

Gjatë asaj jave të nxehtë gushti, nuk e di pse e pata atë nevojë, të shkoja çdo paradite në meshën e orës 9:00 në kishën e vogël të *Saint Genesius*, ku qenë martuar e përcjellë së vdekurish mjaft shkrimtarë të njohur spanjollë, ngjitur me Hostal Madrid ku rrija, shumë pranë sheshit qendror. Edhe dramaturgu i shquar, bir i një qëndistari, Lope de Vega qe martuar aty, në kishën e Shën Gjinit ose Shën Gjenit, përkthyer në shqip.

Një javë, pa munguar asnjë ditë në predikimet e orës 9:00 para shpërndarjes së jashtëkohshme të eukaristisë, as fqinji im në krahun e majtë dhe as fqinja ime në krahun e djathtë, të cilët lexoheshin qartë që kishin zbritur me rroba shtëpie nga pallatet rrotull, nuk bënë as lëvizjen më të vogël për të shtrënguar duart e t’i thoshim njeri - tjetrit:

- Paqja qoftë me ty!

Isha nuse e re. Megjithë fustankat me ngjyra të qeshura lulkash verore që i kisha zgjedhur në stilin spanjoll me dekolte të hapur, por jo shumë, mendoj se dukja ime tregonte përkorësi, besim të lindur tek Providenca Hyjnore dhe një nevojë timen të pashpjegueshme për atë shtrëngim dore me besimtarët katolikë aty, në zemër të Madridit të vjetër në kishën e *Iglesia de San Ginès*, gjë që nuk ndodhi asnjëherë dhe akoma pyes veten: *Përse?!*

Në radhorët para meje të pranishmit i jepnin dorën njeri - tjetrit. Përse aty ku ulesha unë nga fundi nuk ndodhi asnjëherë për shtatë ditë rresht?

U dukesha një e huaj që kisha hyrë për kureshti turistike?

U dukesha jokristiane?

U dukesha një *conversos/e konvertuar* e padenjë?

Si martirët e Kishës dhe si të krishterët e parë, pasi iu dhanë shenjat e Krishtit Zot, besimi im është i përplotë. Ka qenë i tillë që sa fillova të kuptoj, ime gjyshe nuk e ndante Emrin e TënëZot në lutjet e saj të devotshmërisë dhe në çdo moral fabule që i shërbente edukimit të fëmijëve gjatë ditës. Sapo linda më pagëzoi fshehtas Ditën e Shën Kostandinit dhe Shën Elenës me emrin e pagëzimit Eleni, tek një prift, Papu Zariku, që kishte qenë partizan gjatë luftës. Fetaria në Shqipërinë komuniste u ndalua me ligj në vitin 1967 duke u bërë vendi i vetëm në botë ku u eksperimentua kjo. Pagëzimi im i foshnjërisë nuk pranohej nga Kisha pas ringritjes së Kishës Ortodokse Autoqefale shqiptare në vitin 1991, sepse prifti kishte qenë partizan dhe mund të kishte vrarë njerëz, nënkuptuar: ushtarë pushtues nazifashistë. Kisha i pati përfshirë nga autoriteti i saj priftërinjtë ortodoksë që dolën partizanë, ndaj duhej të pagëzoheshin rishtas.

Kisha të paktën një linjë stërgjyshërisht nga nëna me priftërim të pandërprerë djalë pas djali, që nga Aleks Sota<sup>1</sup>, i cili u vendos i pari në Fier më 1788, në lagjen Kishë përqark kishës së vjetër të Shën Gjergjit, pas djegies së dytë dhe më të rëndë të Voskopojës nga trupat e Ali Pashë Tepelenës që e rrafshuan thuajse tërësisht Voskopojën



e një *belle époque* të pashoqe prosperiteti. Aleks ishte djali i priftit Mërtir Sota që e kishte mbyllur jetën e vet në Voskopojë në shek. XVIII dhe mbeti atje, duke e kaluar përjetësinë në qytetin e shndritshëm të zemrës. Në familjen e tyre qe rregull që njeri djalë nga vëllazëria duhej të shugurohej prift, kurse djemtë e tjerë bëheshin artizanë ose merrnin profesione të tjera të kulturës e tregtisë për të shtuar pasurinë. Stërgjyshi im nga nëna, Bushi Spiro Prifti ishte djali i Spiro Mërtir Priftit, (i cili kishte ktheu mbiemrin Sota në Prifti). Spiroja ishte djali i Mërtir Aleks Sota, djalit të Aleksit të Mërtir Sotës nga Voskopoja. Në atë linjë stërgjyshore me priftërim të pandërprerë emri: *Mërtir/Martir*, përsëritej si kod solemn.

Stërgjyshi, Bushi Prifti, si të parët e tij e mbaroi shkollën teologjike në Janinë. Pas një mjekimi të gabuar që i mblodhi gjurin, u tërhoq duke e konsideruar jo të denjë të ishte një meshtar me ecje të penguar brenda kishës duke u mbajtur në bastun. Priftëria e trashëguar përfundoi me të edhe sepse nuk pati djalë. Katër vajzave të tij u zhvillonte në shtëpi orët e mësimit të parabolave biblike, astronomisë dhe bimëve mjeksore që gjendeshin në natyrë dhe në orët e mbrëmjes para gjumit bëhej përmbledhja e mësimave. Kur mbylli sytë, më 1950, stërgjyshja ime Lica Prifti ia vuri me vete Librin e Shenjtë. Në fillim të viteve '60 librat e tij të fesë ia dhuroi Muzeut të qytetit, kurse veshjet e saj të mëndafshita dhe qëndisjet e arit ia shiti muzeut.

Shkaku mund të kisha qenë dhe unë vetë që nuk pati një shtrëngim duarsh mes besimtarësh: *Paqja qoftë me ty!* i cili më pëlqente veçanërisht dhe në kishën tonë të ritit bizantin nuk praktikohesh.

Qëndroja gjithashtu e ngrirë, si kinezi në krah, pa shqitur dot sytë nga distanca e shkurtër midis radhës së fundit ku isha dhe baldakinit të altarit me ikonën kryesore të martirizimit të Shën Gjinit, që mbahej nga katër shtylla prej mermeri të Alpeve jeshile e errët. Sikur kisha rënë në një botë tjetër, duke u kthyer pas në kohë me përfytyrime që nuk ndodheshin brenda kujtimeve të mia, por jashtë, teksa binin të njëjtat kambana që kishin rënë në shekujt e Inkuizicionit spanjoll gjatë procesioneve *Auto - da - Fë*, që shpesh nisnin pikërisht nga kjo kishë e vogël, një vakëf njëmijë a njëmijë e dyqind vjeçar plot mistere. Gjatë një spektakli popullor, aty në qendër midis mbretit dhe turmës, fatkeqët e përndjekur do të gjykoreshin si të papenduar, hebrenj e muslimanë të kovertuar të rremë në katolicizëm, por që praktikonin fshehur në shtëpi fenë e tyre, gra - shtriga dhe katarë para se kryqi i bardhë prej druri që shërbente si flakërima e parë të vërtitej mbi turrën e

druve ku të burgosurit qenë dënuar tashmë, të digjeshin.

Një çast të beftë më erdhi më për mbarë të besoja si në hinduizëm, se isha një shpirt i vjetër, si gjithë të tjerët, e që mbartja pa e ditur më shumë kujtime të fjetura, sesa mund të administronte vetëdija ime, por nuk më linte trembja e thellë nga idolatria ta pranoja se jemi shpirtëra të vjetër dhe kur u japim dorën fqinjëve në bankat e kishës katolike: *Paqja qoftë me ty!* është nevojë jo vetëm e kësaj jete.

Besoja në arsyetimet e gjera nga Shën Agustini, besoja tek shpëtimi me hirin e Krishtit të një jetë unike, jo nga vetëshëlbimi gjatë rimishërimeve të shumta.

Kudo ku udhëtova mbasandej nëpër Evropë i vizitova kishat dhe katedralet baroke e gotike, si turist duke qëndruar gjatë brenda tyre shpesh duke fotografuar fshehurazi, por nuk e ndjeva më ndonjëherë atë nevojë të ndiqja me një frymë meshën në një kishë katolike, si në kishën *Iglesia de San Ginès* shumë pranë qendrës *Puerta del Sol* në Madridin e vjetër.

Ikona e martirizimit të Shën Gjenit më mbeti në sy përgjithmonë.

*Gjykatësi Varius që urdhëron ekzekutimin, ushtari anonim romak që do t'i tejshkojë heshtën në kraharor Shën Gjenit, martiri i gjunjëzuar që sheh lart praninë e shumë ëngjëjve të vegjël fytyrëbukur, të cilët po i sjellin palmën e martirizimit dhe breroren e lavdisë qiellore të besimit.*

Të dukej se lundroje rrugëve, dyqaneve, në bare e parqe përmes të nxehtit të gushtit asaj jave në Madrid.

Nga të gjitha anët vinin tinguj kënge me kitarë që ta rrëzonin zemrën të thyer përdhë nga pikëllimi për demat. Si në fjalët e mbrame të të ungjit të Petro Markos, Aleksit, kur vëllamët e Dukatit e vranë në pritë pa e njohur kush ishte:

*“Ju që më vratë, ju do të më qani?”*

Sapo ngrije sytë, edhe brenda freskisë së kishës ndeshje një shikim spanjoll të vetëtimtë pa dallim moshe e gjinie.

Përmes të nxehtit që zhvendoste imazhet zinxhir të Madridit, zbrita për të marrë metronë, për atje ku turrej gjithë bota kur shkelte në Madrid, në *Plaza de Toros de Las Ventas*. Në sportelet e biletave të kategorizuara për vendet në diell, në hije dhe ato të përzierat bleva një biletë me çmim të mesëm, e ku për fat dielli qëndroi vetëm pesë minuta.

Dy orë para se të fillonte korrida bëhej hyrja në stadiumin me afro njëzet e katër mijë vende. Muzeu i korridës që i mbyllur për publikun, por në mure ekspozoheshin fotografitë e toreadorëve historikë më me emër që valavisnin *kapotat* - flamujt e

mëdhenj të korridave të tyre të famshme dhe që u kanë dërguar mesazhe për jetëavdekje në kohë të turbullta, jo vetëm demave në arenë.

Parada e ushtrisë, e cila do të luftonte me demat rreth e qark arenës nisi me torerot që përshëndeteshin me publikun. Kostumet e tyre të dritës qëndisur me ar e argjend larzoheshin me diellin e nxehtë të pasdites nën tingujt e muzikës shpërthyes.

Paramendova se do e ndiqja korridën duke mbajtur anën e demit.

Kur pashë toreadorin e parë Emilio Oliva, me sy e gojë të trishtuar që zotëronte, si një aktor shekspirian fushën dhe demin e ndërkryer një hap larg tij dhe turma ulërinte duke e sharë vazhdimisht, si edhe toreadorin e dytë Manolo Sanchëz, një biond elegant që dukej si skulptura e një violinisti në park nga stili si mbante shpatën dhe muletën ballë rrezikut të vdekjes, por turma mizore, mizore e paskrupullt i fishkëlleu që të largoheshin pa lavdinë e merituar, kisha kaluar në anën e matadorëve.

Demi futej në arenë me një shtizë të hollë ngulur në qafë në majën e së cilës është lulja bardhë e zi, deviza e luftës me torot që pas pak çastesh nga gjaku bëhej kuqezi. Pas tij shfaqej pikadori mbi kalin e veshur në parzmore hekuri e që me një heshtë i hapte demit plagën e parë vdekjeprurëse.

Demi tërbohej.

I kalkuluar në imtësinë e çdo detaji gjatë procesit të rritjes së tij, të mos kishte asgjë që t'i ulte instiktin e egërsisë, demi arriti të godasë kalin me brirët që i ngecnin shpesh në nyjet e hekurta dhe e ngriti në ajër bashkë me pikadorin. Kali u përgjak, se briri i depërtoi në mish. Demi me numër 60 i quajtur *Rosquillerito*, me peshë pesëqind e tridhjetë kg, pas plagosjes që i bëri kalit filloi të godiste tarabat mbrojtëse duke i shqitur cifla. Spektakli vazhdonte duke i ngulur kafshës së egër në kurriz shtiza nga dy nga dy, me lulka ngjyra - ngjyra, gjersa matadori të hidhte tutje muletën çiklamit dhe të shpaloste pelerinën e kuqe për të ngulur shpatën e fundit në kokën e demit. Pas fitores toreadori ia blatonte kapën e tij të zezë tribunës kryesore, parmakët e së cilës qenë të veshur me flamuj e emblema.

Në fund vinin punëtorët. Për siguri i fusnin demit një thikë në tru mes brirëve, e ngarkonin në një karrocë dhe hiqnin rrën e gjakosur duke e zëvendësuar me kum të pastër lumi.

Pas pesë korridave, fundi i secilës kishte nga një dem të vrarë, kishin stiluar një pauzë artistike, një etyd spektakolar për të çliruar frymëmarrjen e rënduar të mijëra tifozëve: Demi i zi përgjakej e çapërlehej, por nuk e vdisnin, e linin ashtu në mundimet e mëdha të gjakderdhjes dhe torerot largoheshin. Në fushë hynin tetë dema të bardhë me lara kafe, të bukur e të stërvitur si kuaj parade, e rrethonin demin kuqezi dhe e merrnin me vete duke dalë nga arena. Ky dekor spartakiade më bëri të ngashërehesha der në lotin më të fundit. Çifti në anën e majtë më ofronte shpesh dylbinë për të më dhënë zemër dhe çunaku në të djathtë më zgjaste të merrja për të ngrënë nga kaushët e tij të shumtë me fruta të thata dhe kokoshka në shenjë përkrahjeje. Shikoja dhe tifozët e tjerë në stadium që jepnin e merrnin me njeri - tjetrin në të dy krahët.

Këtu në *Las Ventas* katolikët madrilenë e kishin lehtësisht më të aplikueshme:

*- Dhe tani t'i japim dorën njeri - tjetrit, si vëllezër që jemi.*

Kisha vetëm lotët për pafuqinë time. Demi i luftës po u dorëzohej maskotave të gjalla të racës së vet. Gjatë tërë kohës ndieja një nevojë ulëritëse të përmbysje situata e njohur. Por nuk dija sesi mund të përmbysje. Kisha dhembje njësoj edhe për të dy matadorët Emilio Oliva dhe Manol Sanchës të cilët turma i përcolli me përçmim.

Finalja, korrida e gjashtë dhe e fundit i takonte toreadorit të ri njëzet e pesë vjeçar Juan Jose Padilla, që ishte një emër i artë i tregut të ditës. Sapo qe shfaqur në korridën e

tretë me veshjen e tij të kuqe të dritës, populli shpërtheu *Olee*. As që iu afrua ndonjëherë tarabave të drunjt mbrojtëse.

Aty, në mes të arenës Juan Jose Padilla hapte krahët dhe thërriste:

- *Toros! Toros! Torito!*

Luftonte sup më sup me demin në një vallëzim me hirin e vdekjes së ndërkryer sy më sy. Demi i magjepsur nuk përmendej dhe t'i dilte përballë me brirët e vet për ta mundur toreadorin e çmendur.

Padilla krahëhapur me kostumin e tij të kuq me qëndisje ari, si para përqaimit e thërriste me një zë ngjyrali në mes të arenës ku përqaqk njëzet e katër mijë njerëz mbanin frymën:

- *Toros, torito!*

Demi sprapsej, vraponte i etur dhe i fyer nga deficitet e gjakut të vet. Matadori e priste duke vallëzuar me krahun e nderë duke tundur pelerinën e kuqe, e sapo demi i egër pa një balë kryqëzimi mbërrinte i larë në gjak, hidhte tutje pelerinën duke nxjerrë para demit kraharorin e vet që kuqllonte, veshje e larzuar me zjarrin që i dirgej përbrenda:

- *Toros, torito!*

Demi ndalte i hutuar nga ai zë përvëlues, shpatë zanore e dashurisë.

I egërsuar dhe i çoroditur demi nuk gjente dot përsenë e gjakut të vet para gushëkuqit Padilla të gjunjëzuar para tij. Përseja e tij e gjakut, nuk kishte të krahasuar me përsenë e lotëve të mi.

Spanjollët i donin tre matadorë në arenë, por dy për t'i fishkëllyer, sado të talentuar të ishin dhe të tretit për t'iu falur. Le të ishin të tre mjeshtër, por i treti kishte farën që shkumëzonte gjakun e tyre prej zjarri pa i dhënë rëndësi kush do fitonte, ai vetë apo demi.

Tifozët në stadium tundnin shamitë e bardha për toreadorin J. J. Padilla, legjendë e gjallë.

Në momentin kur Padilla do i jepte goditjen e fundit demit qe çasti më i rrezikshëm për të nga blicet e kamerave që verbuan Arenën e Demave. Duartrokitjet e nxehta e ndezën stadiumin, ai u gjunjëzua në anën e kundërt të tribunës kryesore duke ia kushtuar kapelen e matadorit fitimtar dikujt që ndodhej mes popullit dhe që duhej të ishte e dashura. Më pas i ra unazës së arenës duke pritur faqoret e verës që i hidhnin tifozët, e sipas traditës pinte nga një gllënjë prej çdo poçeje të veshur me lëkurë.

Për gjithë natën para kthimit në Tiranë shkrova nën afshin që mbetej edhe gjatë natës nga temperaturat ditore mbi dyzetë gradë, poemthin kushtuar Federico Garsia Lorca - s: *Atdheu jeton pasi e ka vrarë poetin*. Nuk isha mirë.

Kisha lënë andej nga vija një epidemi çmendurie që po zgjaste prej gati një vit e gjysëm, qyshkur ranë firmat piramidale të fajdeve dhe turmat shpërthyen depot ushtarake të shtetit duke djegur e rrëzuar në forcën e armatimit të rëndë institucione të larta publike. Me gjithë praninë e forcave paqeruajtëse ndërkombëtare bilanci ditor i të vrarëve në Shqipëri qe i njëjtë me *Body Count* - in e një lufte. Mendja tentonte të përbashkonte izobare qyshkur Inkuizicioni shembi Sefaradin e ndritshëm multikulturor gjer tek fashizmi frankist me gjasë se kjo ishte historia e njerëzimit dhe nuk po gëzoja atë parajsë turistike botërore ku ndodhesha për një javë para se të kthehesha sërish në ajrin e mbushur me plumba nga të gjithë kalibrat. Kushedi, nëse do të binte më rasti, të vija në Madrid tjetërherë.

Çfarë ma provokonte kaq fort krizën ekzistenciale të moskuptimisë?

Natyra vrastare e njeriut dhe spektakli i saj, që nga Zanafilla.

(1 *Në emër të lirisë*, Demir KORITA, monografi për vëllezërit Jani dhe Zoi Prifti, Botimet Ymeraj, Fier, 2019, ISBN 978-9928-275-37-2. Në këtë libër autori ka konsultuar dokumenta të ndryshme të kohës, botime të tjera, si dhe arkivën familjare të fisit Prifti (Sota), nga është marrë dhe pema gjenealogjike stërgjyshore, shtuar në *"Larzar me zjarr"*, për këtë botim.

# SKICË ANTROPOLOGJIKE KËTEJ DHE ANDEJ KUFIRIT

Nga Albert Doja

Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë  
Profesor titullar i Antropologjisë, Universiteti i Lilës, Francë



radiofonike kanë muzikë të ngjashme. Ne nuk e kuptojmë gjuhën e këngëve, por ato të ngjallin një lloj qetësie në përputhje të plotë me peizazhin përgjatë luginës së Vjosës, me fshatra të vendosur aty-këtu ngjashëm me ato këtej kufirit.

Kohët e fundit, qyteti i vogël jugor këtej kufirit ka filluar të bëjë emër në këtë botë të re që zhvillohet falë turizmit që sa vjen e shtohet. Të gjithë na drejtohen në anglisht edhe pse flasim gjuhën e vendit. Qyteti është zbukuruar e gjallëruar, plot ndërtime të reja, mirëqënia duket sheshit, njerëzit janë të lumtur, krenarë për çdo gjë. Sidomos vajzat e reja mbushin rrugët, shpesh me buzë të fryra e fytyrë të zografisur, minifund të ngjeshur dhe dekolte të rastësishme, njëlloj si në kryeqytet apo në ekranet televizive, sikur bëjnë garë me njëra tjetrën ashtu si muzika e kënduar në valët radiofonike. Ndërsa te qyteti i vogël andej kufirit, asgjë e re nuk bie në sy, duket sikur aty bota e vjetër ka mbetur e pandryshuar. Po ato shtëpia të lodhura si dikur, me rrecka të shpëlara, varur në ballkon e në dritare. Varfëria mezi arrin të fshihet prapa luleve të rënduara, por ende të pavyshkura nga vapa e qershorit. Askush nuk na drejtohet në anglisht edhe pse nuk flasim gjuhën e vendit. Aty-këtu pleq të ulur ndanë rrugës luajnë lodra pleqsh ose kuvendojnë së bashku apo janë të vetmuar me sytë e humbur drejtuar nga kalimtarët pa i vështruar.

Qyteti i vogël këtej kufirit është plot lokale ku njerëzit pijnë kafe ose pije me kanaçe, ashtu si dhe në qytetet e mëdha apo në kryeqytet. Jo sepse këto janë më të lirat apo më të mirat, por sepse këto janë më fitimprurëse. Në qytetin andej kufirit lokalet e pakta mund të shërbejnë çdo gjë, sidomos ëmbëlsira tradicionale të shumëllojshme për të shoqëruar kafënë frappé apo pijet e tjera. Jo sepse këto janë më fitimprurëse, por sepse shërbimi nuk mund të mendohet pa to.

Në qytetin këtej kufirit restorantet shërbejnë ushqime bajate, shpesh të importuara nga përtej oqeanëve të largët, mish nga Amerika dhe Australia apo produkte të ambalazuara për konservim afatgjatë. Në çdo rast, ato gjenden me shumicë kudo, por janë me çmime relativisht më të larta sepse shiten duke mashtruar sikur të jenë gatime vendi apo artisanale. Edhe ato pak produkte të ëmbla që përmenden në këtë qytet janë masivizuar, standardizuar e kavanozuar për t'u shitur me shumicë në çdo kohë e në çdo vend. Shërbimi bazohet në mashtrim dhe justifikohet me babëzinë e fitimit të menjëhershëm dhe pa mundim. Prandaj edhe të shohin vëngër nëse nuk kënaqesh dhe nuk u jep bakshishin e duhur, ashtu si dhe në hotele ku shërbimi më i mirë është falenderimi i mirëseardhjes dhe asgjë më tepër. Në qytetin andej kufirit, pronari i restorantit të shërben gatime të freskëta, drejt e nga mishi që piqet në hell përpara syve, gatime me vaj të virgjër nga ullalet

e kodrave mbi qytet dhe me zarzavate nga lugina e Vjosës në këmbë të qytetit. Fitimi bazohet në bujarinë e shërbimit tradicional dhe justifikohet me synimin e kënaqjes afatgjatë dhe pa mëdyshje. Prandaj edhe bëjnë çdo mundim, aq sa herë-herë edhe çmimin e rrumbullakosin nga poshtë sikur duan të japin bakshish për begenisjen.

Në qytetin këtej kufirit është mbajtur një kongres i rëndësishëm në maj të vitit 1944 që “sipas vullnetit të popullit” ka mundur dhe justifikuar marrjen e pushtetit nga komunistat pa mbaruar lufta e dytë botërore. Salla ku u mbajt ky kongres nuk është veçse një hangar, por ruhet e mbrohet si një nga monumentet historike të klasës së parë, që ka mbetur monumenti më i rëndësishëm edhe sot pas 35 vite përpjekjesh të vullnetit të popullit këtej kufirit për t’u shkëputur nga e kaluara komuniste. Në qytetin andej kufirit ndodhet saraji i nënës së Ali Pashë Tepelenës, kësaj gruaje të jashtëzakonshme që poezia gojore e ka pavdekësuar si “Hanko mos shko nëpër varre, se të vdekurit i ngjalle, të gjallët i vdiqe fare”! Në këto saraje Ali Pasha ka kaluar fëmiminë dhe rininë e vet të hershme pas vrasjes së të atit, nën kujdesin dhe me vullnetin e hekurt të kësaj gruaje, para se të bëhej sundimtari zulmëmadh këtej dhe andej kufirit të sotëm. Sarajet mbresëlënëse që sundojnë mbarë luginën e Vjosës thellë në horizont janë shprehja më e mirë e lavdisë së dikurshme të aristokracisë vendase përgjatë shekujve, por janë lënë në harresë të rrënohen pa kujdesje, me sa duket ngaqë kjo nuk është më lavdia e banorëve të sotëm andej kufirit. “Harro mushkë Vallarenë se Ali Pashën e prenë”! Apo ngaqë banorët e sotëm këtej kufirit nuk kanë nge të merren me gërmadha pa ndonjë përfitim të menjëhershëm.

Shumë njerëz këtej kufirit janë pushtuar nga ankthi për të kaluar andej kufirit. Me shpresën e një jetese më të mirë, këta harrojnë dhe nënvlerësojnë mirëqënien dhe mundësitë që ofron vendi i tyre këtej kufirit. Pranojnë të ndërrojnë emër, të ndërrojnë gjuhë e të ndërrojnë fë, thjesht për të mirëmbajtur dhe pastruar shtëpitë e rrënuara apo për t’u shërbyer dhe mbajtur oturakun pleqve të varfëruar. Shumë njerëz andej kufirit i presin me përcëim, me diskriminim dhe me shfrytëzim, pavarësisht aftësive, cilësive dhe energjive të tyre rinore.

Mendjet e ndritura këtej kufirit përgjigjen me pohime ballsamike të veçantisë antikuarizuese dhe të përparësisë autoktonike, qofshin pohime albanologjike të ashtuquajtura shkencore apo akrobaci turbo-pellazgologjike pseudo-shkencore. Mendjet këtej kufirit habiten pse andej kufirit nuk kuptohen ngjashmëritë dhe pse nuk i trajtojnë e nuk i nderojnë ashtu si duhet. Me sa duket andej kufirit, mendjet besojnë se ndryshimet janë rrënjësore dhe të papajtueshme, pavarësisht se ngjashmëritë janë më të thella dhe më të qenësishme nga sa duken. Prandaj me këmbëngulje ata ruajnë gjendjen e luftës dhe kundërpërgjigjen me pretendime territoriale shoviniste sikur duan të mos përzejehen kurrë.

Tek e fundit, ashtu si veçoritë e sjelljes shoqërore, këto lloj mendjesh provojnë edhe një herë se modelet kulturore të përfutuara nga abstraktimi i realiteteve konkrete që përjetojnë si këtej edhe andej kufirit janë transformime të njëri-tjetrit. Antropologu mund të vazhdojë të nxjerrë në pah pa mbarim manifestime të shumta veçorish analogjike që shfaqen në raport të drejtpërdrejtë ose të përmbytur ndaj njëra-tjetrës, ndërsa i njëjti modelim kontrastiv mund të përsëritet pa mbarim për aq kohë sa nuk ndryshon perceptimi i realitetit që përjetojnë njerëzit këtej dhe andej kufirit. Mënyra e perceptimit të realitetit shpreh pikërisht atë ngjashmëri thelbësore që i bën njerëzit këtej dhe andej kufirit të zgjedhin sjelljen e tyre të përditshme shoqërore në përputhje të domosdoshme me modelimet kulturore që ata përftojnë nga përjetimet reale të botës ku jetojnë.

Qershor 2025,

Këtej dhe andej kufirit greko-shqiptar

Konferencë shkencore

POETIKA LETRARE E  
RIDVAN DIBRËS



UNIVERSITETI I SHKODRËS  
“LUIGJ GURAKUQI”

Fakulteti i Shkencave Shoqërore  
Departamenti i Letërsisë

KONFERENCA SHKENCORE

POETIKA E VEPRËS  
LETRARE TË

RIDVAN  
DIBRËS

E hënë, më 30 qershor  
2025, ora 11:00

Biblioteka Universitare  
Shkodër

Kleo është një piktoreshë njëzetekatër vjeçare me një vizë studentore që po i skadon; Franku është njëzet vjet më i madh dhe me gjendje të mirë ekonomike (plus ca të tjera). “Martesa e tyre e rrufeshme” ndez një sërë reagimesh në rrethin e tyre të miqve dhe familjarëve, pa përmendur reagimet e tyre individuale tek mësohen si bashkëshortë.”

—Libri më i shumëpritur nga “LitHub” për vitin 2022

Një roman i parezistueshëm, që nuk e heq dot nga dora. Një letër dashurie për Nju Jorkun, një letër dashurie për dashurinë. “Kleopatra dhe Frankenshtajni” është një debutim i ndërlikuar, me humor, i ndjerë, dhe i shkruar bukur.

—Nathan Englander, autor i “What We Talk About When We Talk About Anne Frank” and “Kaddish.com”



Botim i ri nga “Trishtil”

COCO MELLORS

“Kleopatra dhe  
Frankenshtajni”

Piktorja njëzetekatërvjeçarja britanike Kleo, është arratisur nga Anglia për në Nju Jork dhe është ende duke kërkuar vendin e saj në qytetin që nuk fle, kur, pak muaj para se t'i mbarojë viza studentore, njihet me Frankun. Njëzet vjet më i madh dhe i suksesshëm me forcat e tij, jeta e Frankut është plot me lukset që të Kleos i mungojnë. Ai i ofron shansin për të qenë e lumtur, lirinë për të pikturuar, dhe mundësinë për të marrë një Green Card. Por martesja e tyre e ngutur ndryshon në mënyrë të pakthyeshme jetën e tyre, dhe jetën e njerëzve pranë tyre, asisoj që askush nuk mund ta kishte parashikuar.

Çdo kapitull, i lexueshëm me një frymë, eksploron jetët e Kleos, Frankut, dhe secilit prej miqve dhe familjarëve të tyre të paharrueshëm ndërkohë që rriten dhe plaken. Qoftë miku i ngushtë i Kleos që po përpaket të përqafojë identitetin e tij gjinor pas martesës së saj, apo motra e vogël e Frankut që, e lënë pa ndihmë financiare, planifikon takime me ‘sugar daddy’ për të mbijetuar, apo vetë çifti Kleo dhe Frank që përballen me sprovat e martesës dhe të shëndetit mendor, secili personazh është po aq përthithës dhe i prekshëm sa tjetri.

Njëherazi komik dhe zemërthyes, zbavitës dhe thellësisht prekës, “Kleopatra dhe Frankenshtajni” shënjon hyrjen e një talenti brilant e të guximshëm.

“Kleopatra dhe Frankenshtajni”, romani debutues i shkëlqyeshëm nga Coco Mellors, është një libër për shumë gjëra: Është një histori dashurie madhështore e dalldisë; një përshkrim shkatërrues i mënyrës si varësia dhe sëmundja mendore na shtrembërojnë jetët; dhe një portret i mprehtë dhe i zgjuar i Nju Jorkut të globalizuar. Por mbi të gjitha, Mellor ka shkruar një libër njerëzor rrënues, herë i mprehtë e herë i butë, që e shënjon atë si një shkrimtare e rrallë, fjalitë e së cilës janë aq të bukura sa janë të mençura. Një lexim i paharrueshëm.

—Sam Lansky

COCO MELLORS

Kleopatra dhe  
Frankenshtajni



Roman

Trishtil

Sandër Prosi

Dua të kujtoj disa copëza jete nga artisti më i njohur i ekranit shqiptar, në këtë përvjetor të ikjes së tij! Rolet ia njohim kaq mirë dhe janë njëri më i arrirë se tjetri. Mjafton Dhaskal Todri, Xha Jaho apo Ismail Qemali e shumë e shumë të tjera, duke u kthyer deri tek Otelloja. Këtu po kujtoj vetëm copëza jete me këtë artist të madh.

Burrin e pashëm, fisnik, të shtruar si në jetë, ashtu edhe në art, e kam parë për herë të parë në Teatrin Popullor, në rolin e shkëlqyer të Horatit. Ajo përshtypje e mikut të besës sipas atij roli të Shekspirin të “Hamleti”, më ka mbetur edhe sot për njeriun Sandër Prosi. Horati sikur ishte shkruar shumë shekuj më parë enkas për Prosin tonë.

Në verën e vitit 1965 e pata fare pranë në oborrin e Teatrit Popullor. Një burrë sugestionues me cigare në buzë rrinte krah meje. E përshëndeta. Ma ktheu përshëndetjen duke përkulur kokën dhe duke buzëqeshur. E kujtoj si tani! Mendoni që ishte 45 vjeç në atë kohë dhe ndjesia ime qe sikur ishte goxha burrë në moshë! Në ato vite posterat me portretin e tij nga filmat “Detyrë e posaçme” dhe “Vitet e para” të regjisorit Kristaq Dhamo, na ishin ngulitur në mendje. Ishte bërë ylli i kinematografisë që në hapat e parë të karrierës së tij artistike. Kujtoj ecjen e tij gati unike, si në një meditim gati të pandërprerë. Vitet ikin vrullshëm në moshën studentore që isha unë. Pas katër vitesh ishim së bashku te filmi “I teti në bronz” të Viktor Gjikkës. Po xhironim në atelie. Sandri ishte shumë i përqendruar gjatë provave. Unë isha në krevat, kur futet dr. Borova dhe fillonte teksti. Paralelisht punonte edhe grupi i xhirimit, si vendosja e kamerës, ndriçimi, zëri etj. Ndriçuesit të hipur në skelat e dekorit mbi

tavanin e dhomës komunikonin me njëri-tjetrin. Kjo e pengonte Sandrin dhe për të shmangur zhurmat, vuri ca pambuk në vesh. Unë i shtrirë në krevat, si i ri 25 vjeç, duke e parë që vuri pambuk, hapja gojën dhe nuk nxirrja zë. I bëra shenjë. Nuk po më dëgjonte, provoi të lëvizte pambukun dhe përsëri nuk po dëgjonte. E kuptoi humorin tim dhe më erdhi pranë e më drejtoi gishtin, duke më thënë: “Ah, qerrata!”. Qeshëm të dy dhe ky gjest më pas u bë çelësi i një miqësie të bukur në vitet që pasuan.

Gjatë xhirimeve të filmit “Guximtarët” të Gëzim Erebarës flinim së bashku në barakat e sharrave. Një pasdite, mes atij peizazhi malor, po bisedonim për tema të ndryshme, ndërsa ai nuk dinte ta hiqte cigaren nga buza. I mjaftonte ndezja e parë, se më pas cigarja ndizte cigaren... Aty më thotë: “E ke vënë re që këtej nuk e përdor këmishën e bardhë dhe rri vetëm me bluzën e tutave?”. “Jo! – i them dhe e pyes për kureshtje: – Po pse?”. “E ruaj për në Tiranë, pasi nuk kam tjetër. Edhe pushime verore kam shumë vite që nuk kam bërë, pasi në kohën e pushimeve të teatrit vij në filma, për të marrë një rrogë plus!”

Një ditë i ndodhi një tronditje. Ishte koha e luftës së tmerrshme kundër liberalizimit. Ishte rregull, që në orën 9:00 të bëhej apeli në teatër. Sandri nuk e dëgjoi emrin. Iku me trazimin se “më paskan hequr nga teatri!”. Ishte i lodhur me idenë e frikës së asaj kohe. Shkoi në shtëpi dhe tentoi të vriste veten. Kur vajta në spital, më tha: “Për dy gisht, kisha shpëtuar!”

Vite më vonë ishim duke pirë kafe te “Drini”. Ishte një e diel me diell e fillimshkurtit. Në atë kohë përgatiteshim për filmin “Plumba perandorit”. Sandri ishte duke folur me fytyrë nga dera dhe ne të tjerët po ndiqnim bisedën. Papritur Sandri ndaloi dhe nuk po fliste. Kthejmë kokën dhe shikojmë dy vajza me nga një tufë mimozash në duar. Njëra qe e gjatë dhe e bukur, sa ia ngriu shikimin dhe fjalën në buzë. Vajza sikur ndjeu çdo gjë dhe erdhi me tërë atë çudi-pamje që na dhuroi, u afrua dhe i zgjati Sandrit dy degëza mimoze. Mendoni buzëqeshjen fisnike të Sandër Prosit për gjestin e vajzës!

Atë vajzë më vonë e mora në film, për një paraqitje në një episod. Gjatë filmit

## SANDËR PROSI, ARTISTI QË KISHTE LINDUR PËR EKRANIN

Nga Mevlan Shanaj

Sandri erdhi tek unë për hatër të miqësisë, për një rol karakteri, por bashkëpunimi dhe ndihmesa e tij ishin të pashlyeshme.

Një ditë futem në kafe te pesëmbëdhjetëkatëshi. Dukej fisnikërisht i ëmbël në komunikim me njeriun që kishte në tavolinë. Ma bëri me dorë. Vajta dhe teksa po ulesha, personi tjetër u ngrit. Më zgjati cigaret “Partizani”, kurse unë nxora “DS”. Qeshi dhe më tha: “Pse nuk ma respektove paqetën?”. Qeshëm. I them: “Po kënaqeshe me atë personin!”. Vuri buzën në gaz dhe ma ktheu: “Ishte një simpatizant, që ti e di, vijnë dhe shprehin fjalë të mira! Unë nuk i kundërshtoj dot! Por sot, në fakt, kam harruar pa ndërruar baterinë e aparatit të dëgjimit dhe nuk dëgjoja asgjë! Doja të dëgjoja vetëm veten time!”.


Pas kaq vitesh kujtoj nga Sandër Prosi njeriun, i cili në çdo takim diskutonte për punën e radhës, më jepte këshilla për dramaturgjinë e filmit që do të bëja. Në një dokumentar timin, “Berati”, erdhi si narrator. I pëlqeu teksti i shkruar nga Shpëtim Gina dhe kur e lexonte, donte të ribënte dubla, që ta bënte sa më mirë! Nga violina që kishte studiuar, Sandrit i kishte mbetur shpirti delikat. Të dëgjonte me vëmendje dhe më pas me qetësi të pyeste... Nuk kam rastisur njeri të dytë në jetë, që ta respektojë bashkëbiseduesin si ai! Legjendë e gjallë, që edhe pas kaq vitesh, është këtu mes nesh!

Në atë ditë marsi erdhi lajmi për ikjen tragjike të burrit më fisnik e më të famshëm të ekranit shqiptar. Askush nuk di të thotë si ndodhi aksidenti i ikjes së tij. Pas ka mbetur vetëm imazhi i burrit të bukur, të mençur dhe të urtë, që kishte lindur për ekranin, pa

menduar se si do të ishte çasti fatal! Sandri iku në mënyrën më të dhimbshme, veç 65 vjeç. Sa i ri! Humbje kombëtare!

Aktori shqiptar në ekran

Mjeshtëria e interpretimit në ekranin shqiptar erdhi në mënyrë të natyrshme. U shquan dhe u preferuan ata aktorë, që me aftësitë e tyre sollën vërtetësi, duke iu larguar teatrit. Rritja e mjeshtresë së interpretimit në përgjithësi erdhi gradualisht. Aktorët me përvojë skenike procesin e kalimit në ekran në fillimet e tyre e patën më të ngadaltë. Kurse gjenerata e re e përthithi më shpejt. Shëmbull kemi Rikard Ljarjen, që erdhi i pari në ekranin shqiptar, me një interpretim filmik dhe më pak skenik. Kujtojmë Dritan Shkabën, ku shkëlqeu me Roza Anagnostin. Më pas ishte një grup aktorësh, që krahas rritjes së prodhimit të industrisë së filmit, rritën dhe mjeshturinë e aktrimit në ekran. Bujar Lako, Timo Flloko, Robert Ndrenika, etj. Aktori i filmit te ne ka ardhur në saje të teknikës së tij individuale, pa asnjë leksion mbi transformimin apo krijimin e karakterit në ekran. Karakteret krijoheshin gjatë shesheve të xhirimit, me punë të përbashkët regjisor-aktor! Në skenë mjeshtria e aktrimit është kushti themelor dhe nuk kemi përse të mos themi, se edhe ekрани është më pak i kapërcyeshëm për sa i përket mjeshtresë së aktrimit. Kamera është sa tolerante, po aq edhe mizore me portretin. Për kamerën është thënë se “nuk gënjen”. Kamera thekson duke zmadhuar apo treguar emocionin përmes syrit. Përmes pasqyrës së qëndrimeve emocionale, zbërthehet mjeshtria e interpretimit, krijimi i karakterit! Syri në




kinema është aktrimi. Jo pak raste në ndonjë rol kemi krijuar edhe nga amatorët. Por aq shkon “loja” e amatorit, nuk reziston dot në krijimin profesional në vazhdimësi të karaktereve.

Në ekranin tonë aktorët vinin nga fusha të ndryshme. Nuk kishte aktorë profesionistë vetëm për film. Aktorët i zgjidhte regjisorin dhe pothuajse të gjithë u nënshtroheshin provave për rolin e ri, duke filluar që nga krijimi i figurës nga ana e jashtme në çdo detaj, deri te kërkesa kryesore e krijimit të karakterit të ri, si dhe marrëdhënia me partnerët. Në përgjithësi teatri ishte laborator i përgatitjes së aktorit apo Instituti i Arteve! Një ndër “liritë” që kishte aktori në film, ishte e drejta e tij për të zgjedhur, jo rolin se ajo ishte e drejta e regjisorit, , por aktori zgjidhte në se e pranonte apo jo rolin e ofruad! Asnjë rast nuk mund të ketë ndodhur, që aktori të ketë qenë i detyruar të pranonte për një interpretim në ekran në se ai nuk bindej artistikisht! Në skenë aktorët ishin të punësuar dhe do të merrnin rolin që u jepte regjisorin. Puna në tavolinë në teatër ishte një ushtrim i përditshëm, deri në daljen para publikut. Në ekran përgjegjësia ishte shumë e madhe pas fiksimit, pasi nuk kishte mundësi korrigjimi. Përqëndrimi në çastin pas fjalës “çak” ishte emocion i veçantë, sepse aktori e dinte se po jepej dënimi i tij.

Aktori i filmit ishte bashkëpunëtori në dënimin apo lavdinë e tij. Kishte lirinë e zgjedhjes për ta

zmadhuar emrin e tij ose për ta dënuar. Raste shumë të rralla rezultojnë me mosarritje, pasi puna në film nuk është si në skenë, që fillon dhe mbaron për aq kohë sa zgjat drama. Në film kohëzgjatja është shumë më e madhe dhe kjo është një ndër gjërat teknike, që i jep mundësi aktrimit të korrigjohet gjatë realizimit të filmit. Regjisorin përzgjedh skenarin dhe më pas aktorët, të cilët kalojnë një seleksionim të parapërgatitjes. Ka shëmbuj që gjatë kimoptobave, regjisorë të veçantë kalonin episode te ndryshme të filmit të ardhshëm me aktorin që do ta merrte për të parë se deri ku mund të arrinin limitet e interpretimit! Regjisorja Xhanfize Keko tregonte se për rolin e Benit në filmin “Beni ecën vetë” kishte provuar 500 fëmijë. Nuk di që në kinostudio të jetë dhënë ndonjë rol pa kinoproven ose audicionin siç thuhet sot. Ishte ajo punë krijuese këmbëngulëse që kemi sot karaktere kombëtare të arritura mjeshtrosh nga gjigandët : Sandër Prosi, Kadri Roshi, Tinka Kurti, Margarita Xhepa, Yllka Mujo, Vangjush Furxhiu, Luiza Xhuvani, Ndriçim Xhepa, Kastriot Çausi , Gulielm Radoja, Agim Qirjaqi, Reshat Arbana, Xhevdet Ferri etj! Unë në filmat e mi e kam shkelur këtë “ligj” si regjisor, merrja aktorët që më kishin bindur me arritjet e tyre! Krahas dramaturgjisë, imazhit, mjeshtresë së krijimit padyshim në suksesin e një filmi rol të madh ka edhe kolona zanore!

Nga libri” Të fshehta jashtë ekranit”



Në ditët tona nuk ekziston ndonjë dallim tepër i rëndësishëm midis vargut dhe prozës ose poemës dhe prozës : *poiësis* (gr.), *poesis* (lat.) do të thotë krijim, ndërsa *poïema* (gr.) dhe *poema* (lat.), vepër në vargje. Aristoteli në librin “*Poetika*”, shkruan se me *poiësis* mund të jepen të gjitha bukuritë e gjithësisë. Poezia ndonjëherë arrin të dhurojë emocione të fuqishme. Pra, ndarja klasike *varg, prozë* shfaqet qysh në Antikitet. Megjithëkëtë për modernistët ekziston një tjetër ndarje që është : *ligjërim i zakonshëm* dhe *poezi*. Në poezi përfshihen edhe vargu edhe proza. Çelësi ironik i Roland Barthes-it është : Poezi=prozë+a+b+c+...

Moderniteti poetik nisi në vitet e simbolizmit, në Francë. Simbolizmi është një lëvizje letrare dhe artistike e gjysmës së dytë të shekullit XIX. Në pikëpamje letrare ai qe në mospajtim kryesisht me natyralizmin dhe poezinë parnasiane.<sup>1</sup> *Manifesti i simbolizmit* që botoi më 1886 në gazetën *Figaro* Jean Moreas-i<sup>2</sup>, kërkonte që poeti të mos pasqyronte dukjen, por brendësinë, ndjesinë shpirtërore, realitetin transcendental. “Poema duhet të rivalizojë me muzikën », shkruan ai. Simbolistë ishin edhe Kahn, Henri de Régnier, Emile Verhaeren, Gauthier, Banville, Meterlinck..., por protagonistë kryesorë të tij mbetën : Baudelaire, Rimbaud, Verlaine, Lautréamont, Mallarmé si dhe disa personazhe me rëndësi të veçantë në këtë lëvizje letrare si Tristan Corbière, Jules Laforgue dhe Gérard de Nerval. Simbolizmi ndikoi thellë edhe në disa vepra të shkrimtarëve Oscar Wilde, Paul Claudel dhe Paul Valéry.

#### Një histori e shkurtër e vargut të lirë.

Në shkrimet teorike të poetit Stefan Mallarme flitet për një krizë të vargut. Ai nuk krijohet më si një e tërë me dy heksametra, por pritet atje ku dëshiron autori. Artur Rembo thotë se aleksandrini nuk është më forma e vargut që vlen për të shkruar poema. Vargu duhet të jetë “me një liri të lirë” (*d’une liberté libre*), shprehet ai. Në këto vite vargu poetik kalon nëpër disa faza, deri në zhdukjen e numrit “të zyrtarizuar” të rrokjeve. Fillimisht përpjekja për mos ta pasur më si model aleksandrinin, u përkufizua negativisht si lojë fjalësh. Krahas vargut të lirë u eksperimentua edhe poezia në prozë apo proza poetike. Poema në prozë dhe proza poetike shpesh herë tregojnë se “kulla e filldishtë” ka mbetur vetëm si relike, e braktisur së bashku me teorinë e saj “të artit për art”. Në të vërtetë braktisja e kullës së fildishtë ishte një mospërfillje për poeticitetin e jashtëm, përkundër një poeticiteti të brendshëm të një realiteti që karakterizohej nga një prozaizëm i pashërueshëm. Në fakt ky është objekti më i rëndësishëm i poezisë moderne.

Vite më vonë, Apollinaire-i<sup>3</sup> i çliruar nga të gjitha kufizimet metrike dhe tematike do të shkruante: *Falmëni mosdijen / Falmëni që s’e njoh më zjarrin e moçëm të vargut / Nuk di asgjë, vetëm dashuroj / Lulet në sytë e mi shndërrohen në flakë* (Fejesa).

Vargu i lirë dhe poema në prozë pranojnë një varg të zhveshur nga stilitë tradicionale. Ai do të shndërrohet në një ligjërim prej poetëve të mëdhenj të fundshekullit XIX, të shekullit XX e të fillimshekullit XXI: Whitman. Mickiewicz, Cavafis, Frost, Neruda, Ricos, Montale, Alixandre, Elytis, Eluard, Ahmatova, Borges, Paz, Brodsky, Szymborska; Glück...<sup>4</sup>

#### Modernistët e parë :

**Stéphane Mallarmé (1842-1898)**, teoricien i shquar i vargut të lirë që nuk e përdori kurrë atë. Edhe kur e përdor fjalën *prozë* si titull të parë të poemës “*Për Eseitët*”, ai shkruan me varg të matur : *Oh ! Ta dish o shpirt i trazuar / Në çastet që heshitja na mbulon / Degë e zambakut është shumëfshuar / Dhe prej arsyes sonë lulëzon*<sup>5</sup>. Për sonetet që shkroi, ai u quajt “muziktar i heshtjes”. Claude Debussy i bëri një ilustrim të mahnitshëm me nota poemës së tij “*Pasditja e një fauni*”, në të cilën fauni në eglogë pyet : “*A mos kam dashuruar një ëndërr ?*” Pyetja është dyshimi për kohën e re që ka hyrë në poezi, dyshim ekzistencial i njeriut modern.

Në librin “*Një hedhje zari*”, ai shpiku poemën tipografike ose ligjërimin e hapësirës. “Fjala e fundit e letërsisë është të krijojë një ligjërim brenda një tjetër ligjërimi”, thotë. Në fakt, në veprimtarinë e tij zyrtare e disi monotone si kuadër i arsimit e më pas si mësues anglishteje në provincë, gjersa erdhi përfundimisht në Paris, Mallarme ia kushtoi jetën, siç thotë “të vetmes detyrë shpirtërore”, të përpunonte “Librin” që i jepte shpjegim orfik “Tokës”. Duke u marrë që herët me leximin e parnasianëve e pastaj të Bodlerit e të Edgar Poe-s (për Edgar Poe-n, ai shkroi vargun e famshëm : *I tillë që vetë përjetësia e ndryshon*, në sonetin “*Varri i Edgar Poes*”), qysh më 1862 ai shpallte mbëhinë e një vepre me kërkesa tepër të larta artistike.

Pavarësisht se në poemat e para “*poeti i brengosur nga jeta që vyshket*” endet nëpër temat bodleriane, ai përshkruan në mënyrë filozofike : universin që plagos dhe që njëherësh josh, fëmijërinë, kohën e hershme që shtrihet përtej fëmijërisë, gjer te *Dikuri* i mbështjellë me terr absolut, zbrazëtinë e botës që

<sup>1</sup> Nga Parnas, në Antikitetin e vonë ai zëvendësoi Helikonin si vendqëndrim i Muzave dhe i frymëzimit të poetëve; Masiv shkëmbor në Greqi.

<sup>2</sup> Jean Moreas (1856-1910) - Poet simbolist, me origjinë të dyfishtë greke e shqiptare, i ardhur në Paris nga Moreja. Luan Rama ka shkruar librin Jean Moréas, poeti i Moresë, botuar nga Globus R, Tiranë, 2009 dhe nga Les Livres Rama, Paris, 2012.

<sup>3</sup> Guillaume Apollinaire, Shekulli i reve, poema, përktheu Anton Pappleka, Alef, Tiranë, 2016

<sup>4</sup> Cikle të këtyre poetëve ka perkthyer herë pas here Anton Pappleka në gazetata Nacional dhe ExLibris.

<sup>5</sup> Vargjet e poemave në shembujt e përdorur janë përkthyer nga Anton Pappleka.

# Rivështim SIMBOLIZMI OSE PRELUDI I MODERNITETIT NË LETËRSI Nga Feride Pappleka

ka ngrirë në *Idenë e Kulluar : Jam i trishtuar, medet ! dhe tërë librat i kam lexuar / Të arratisem larg ? E shoh se edhe zogjtë janë dehur* (Fllad deti).

Pas një periudhe dyshimi që më 1868 e nxitì të shkruante : *Unë kam vdekur dhe jam ringjallur*, Mallarme tani e tutje do ta krijojë veprën e vet si një përvojë metafizike : *Dashurohemi po të duash / Me buzët e tua pa folur / Trëndafilisht të ma thuash / Heshtjen e zezë të lodhur* (pa titull). Duke përdorur sonetin në një sintaksë eliptike për të mbërthyer “fjalë totale” të reja, fjalë burimore, që për nga tingëllimi mëtojnë të hahen me muzikën, ai e kthen gjuhën në instrument të betejës së tij me fjalën : *Vdes dhe dashuroj : vështroj një engjëll kur shihem !/- Sikur qelqi të jetë art dhe mistikë- / Duke mbajtur ëndrrën si diademë rilindem, / Në një qiell të moçëm ku lulojnë Bukuritë !* (Dritaret).

Ndërsa shpjegon krizën e vargëzimit, ai rrëfen historinë e përjetimit të parë metrik që e shndërruan në një arkitekt virtual të vargut të lirë dhe argumenton thelbin e asaj poetike që ia nënshtron vargun formës së ligjërimit. Problemin e frymëzimit e trajton edhe Nietzsche. Në krijim, thotë ai, *Maska* bëhet *Dukje* dhe në një përmbysje të plotë, *Dukja* kthehet në *Realitet*. Poeti gjeni, sipas tij, mishëron këtë lloj krijimi. Vjen një çast, kur poema është gati të dalë në dritë dhe kjo ndodh kur *Maska* dioniziake përputhet me *Dukjen* apoliniane për të sjellë *Realitetin poetik*. Kësaj teme do t’i kthehen më vonë Luis Borges, derisa Roland Bart (Barthes) do të flasë për vdekjen e autorit.

I përfshirë papritmas në librin “*Poetë të mallkuar*” (1884) të Verlenit dhe fill më pas në librin “*Së prapthi*” të Huysmans-it, Mallarme u bë udhëheqës i gjeneratës simboliste që mblidhej tek ai në rrugën e Romës 18, në Paris.

**Charles Baudelaire (1821-1867)**, ripagëzoi skenën natore të realitetit duke projektuar vetveten me një *anti*. Gjesti *kundër* është vendimtar në poezinë e tij. Ai pyet vazhdimisht për arsyen e të ekzistuarit në këtë botë të rrënuar, ku rënia e njeriut është edhe më e rëndë se te mëkati zanafillor. Poeti i sheh njerëzit të dërrmuar nga kimera e vet, në një proces shfityrimi fatal e të pashmangshëm.

Që fëmijë, i mbyllur në një kolegji, Bodleri pati ndjesinë e një fati përjetësisht vetmitar. Pasi mbaroi liceun, udhëtoi për dhjetë muaj rresht dhe u kthye prej andej me nostalgjinë ekzotike. Ai revoltohet me familjen e vet borgjeze që filloi të skandalizohej ndaj jetës së tij prej bohemi. Poemat e para që botoi më 1847, Bodleri i kishte shkruar më herët, por jetën si krijues ai e nisi me



kritika artistike. I kësaj kohe është përkthimi i poezisë “*Korbi*” të E.A. Poe-s që e entuziazmoi shumë, sepse ndjeu një afërsi të çuditshme krijuese me të. Sipas Bodlerit *shpirtat e shenjtë janë të dënuar të ecin drejt vdekjes dhe lavdisë duke lënë pas rrënojat e tyre*.

Viti 1848 e gjen Bodlerin në barrikadat e revolucionit, por pas grushtit të shtetit më 1851, ai i braktis ato i zhgënjyer. Tani në poemat e tij konceptet *hapësirë* dhe *kohë* lidhen drejtpërdrejt me ekzistencën, ndërsa fjala angleze *spleen* që përkthen përafërsisht fjalën frënge *brenjë*, do të shfaqet shpesh e më shpesh edhe si term i parapëlqyer i gjithë simbolistëve. Ajo do të shprehë hapur dëshpërimin e thellë si pasqyrë e modernitetit.

Megjithëse i lajmëruar më parë te një botues gazete, libri me poema “*Lulet e së keqes*” (1857)<sup>6</sup>, shkaktoi befasim poetik dhe tronditje të moralit borgjez parizian. Ai u shoqërua edhe me një proces të famshëm gjyqësor. Arkitektura e fshehtë me gjashtë pjesë që ndjekin në libër njëra-tjetrën, është një përjetim simbolik i orvatjeve të njeriut për t’i shpëtuar mjerimit dhe për t’u rilindur edhe një herë. Shpirti i poetit luhatet midis ligështimit e lartësimit dhe në këtë luhatje ai e ndjen veten të huaj midis njerëzve (*Albatrosi*). Sipas Bodlerit, te njeriu ende mbijeton vetëdija e një parajse të humbur, që shpjegon etjen e dhimbshme për dëlirësi dhe për të Bukurën, sidomos për artin (*Himn Bukurisë*). Ligjin e analogjive *shpirt-natyrë* që bën t’i konsiderojmë *Tokën* dhe pamjet e saj si shëmbëllim, si korrespondencë qiellore të përjetësisë, e ilustronjë më së miri poemat *Tablo pariziane*. Bodleri thotë se në disa gjendje shpirtërore, pothuaj mbinatyrore, thellësia e jetës zbulohet e tëra në spektaklin që e kemi para syve, sado i zakonshëm qoftë ai. Por pas endjes gjithherë vjen keqardhja, çmagjepsja dhe dëshira e asgjësimit me vdekje. Tek dashuria Bolderi sheh edhe një formë të arratisjes, të shpëtimit nga bota.

Përmbledhja “*Lulet e së keqes*” e ka simbolikën që në titull. Bodleri thotë se « *kishte vënë aty gjithë mendimin, gjithë zemrën, gjithë besimin dhe gjithë urrejtjen* ». Poeti përpiqet që në jetën e përditshme të gjejë shenjat e dukshme të një bote sa më të hershme aq edhe ideale, të panjolllosur me fatalitetin e mëkatit dhe vuajtjes : *Ti je një qiell i bukur vjeshte, i kthjellët dhe i trëndafilte / E megjithatë trishtimi te unë ngjitet si batika* (Bisedë); *E dua në sytë e tu dritën e blertë / por sot në mua gjithçka është helm* (Këngë vjeshte), “*Dua të të rrëfej o magjistarja ime e ëmbël*” (Brenjë).<sup>2</sup>

Vepra e tij ashtu si dashuria i bindet një postulatit engjëllor dhe satanik, ku imazhet dhe simbolet përtërihen nga një rrjetë e hollë shoqërizimesh mistike. “*Zemra ime është lakuriq*”, thotë ai, dhe shtron problemin e lidhjes së autorit me tjetrin, me bashkautorin e padukshëm : *Ç’do të thuash sonte, o shpirt i gjorë, vetmitar / ç’do të thuash ti zemra ime që herët e venitur*. (Semper eadem). Lirizmi i tij është një lloj imazhërie. Tagora thoshte se çdo poemë lirike është një dhuratë. Në poemën “*Moesta dhe errabunda*”, lexojmë : *Sa larg që je parajsë e erëtisur / Nën qiejt e kaltër gjithçka është dashuri e shend*. Por vargje të tilla janë të rralla te Bodleri, sepse ai e sheh botën të çpoetizuar dhe thërret qetësisht : “*O vdekje, kapiten i moçëm / është koha ankorën ta ngremë* (Udhëtim) ; *Parisi i lashtë s’është më, / forma e një qyteti ndryshon më shpejt / se zemra e një të vdekuri* (Mjellma) ; *Një vetëtimë, pastaj terri / U arratisë bukuri / Më nuk do të shoh, mbase në përjetësi* (Për një kalimtare).

Bodleri mendon se është vetëdije politike të mos ushqehesh me iluzione. Ai flet për shtriga, për daj, për luçiferr, për kufoma. Madje një poeme ai i ve titullin “*Kërma*” e që ngjalli në atë kohë mjaft diskutime.

Poetika e Bodlerit është poetikë e dhimbjes. Ai krijon i pari figurën e poetit tokësor, që përjeton vuajtjen e qenieve fatkeqe të kësaj bote : *Dy luftëtarët vrapuan drejt njëri-tjetrit / E spërkatën ajrin armët e tyre me dritë dhe gjak*. (Duellum) dhe shprehu konfliktin e njeriut modern të shqyer nga antagonizmi i trupit dhe shpirtit. Një nga të dashurat e tij ai e quan “*Venus i zi*” me “*bukuri të kobshme*”. Në traditën lirike, poeti këndon dhe vendoset në qendër të botës, pa rënë në sy. Sepse poezia moderne është “*sans papiers*”, (pa dokumente). *Albatrosi* i tij është poeti i zhveshur nga poeticiteti. Kurse V. Hugo-i e quan atë « *princ ëndërrues, të shenjtë, profet* ».

Pas procesit të famshëm gjyqësor, që dënoi disa poema dhe e ndaloi librin “*Lulet e së keqes*”, Bodleri nuk di të shkruajë më. Ai përfundon afazik.<sup>3</sup> Duke përmbledhur disa artikuj që kishte shkruar që më 1845, 46 dhe 49 për revistën “*Salon*”, ai boton më 1859 librin “*Kuriozitete estetike*” dhe më 1860 shkruan librin me elemente biografikë “*Parajsat artificiale*”. Ndërkohë vazhdon të përkthejë Poe-n.

Brenga e thellë e shtyn poetin të kërkojë arratisje duke iu dhënë drogës dhe dashurive mistike. I dërrmuar nga pikëllimi dhe nga mendimi i ngulët për pleqërinë (në një kohë që është relativisht i ri) dhe vdekjen, që ia shton sëmundja, në pranverë 1867 ai shkon në Belgjikë. Atje goditet nga një paralizë e rëndë. Pas disa muajsh, Bodleri vdes në Paris, në moshën 46 vjeçare.

Në atë kohë “*Lulet e së keqes*” kishte njohur edhe dy botime të tjera dhe do të njohë edhe një botim të tretë e të plotë më 1869, *postume*. Libri do të mbetet një tekst shumë i kërkuar nga lexuesi dhe do të ribotohet vazhdimisht.

Mes dorëshkrimeve që iu gjetën poetit pas vdekjes, ishte edhe “*Poema të vogla në prozë*, apo “*Spleen de Paris*” (*Brenga e Parisit*) 1869<sup>7</sup>. Libri është një nga përpjekjet më origjinale

<sup>6</sup> Përkthyer në shqip nga Anton Pappleka, Charles Baudelaire Lulet e së keqes, Redona, Tiranë, 2016.

<sup>7</sup> Përkthyer në shqip nga Besiana Kadare, Charles Baudelaire, Brenga e Parisit, Onufri, Tiranë, 2005.

për të shkruar një prozë poetike muzikore, pa ritme dhe rimë, sipas lëvizjeve lirike të shpirtit. Ky ishte veprimi më i çuditshëm alegorik i Bodleri.

Proza e tij poetike vë në veprim ligjërimin e përditshëm. Në të shquhen temat : qyteti, vetmia, turma, të marrët, të pambrojturit dhe Bodleri na jep kështu mundësinë për të hyrë më natyrshëm në jetën moderne. Poemat e tij në prozë parashtrojnë idenë universale se jeta jonë kalon nga mosqenia në mosqenie.

Bodleri është personazh emblematik i modernitetit. I vetmuar, por solidar me njerëzit që i fton nëpërmjet asaj që shkruan, të ndiejnë trishtimet, por edhe të shohin bukuritë, ai mbetet një nga poetët e mëdhenj simbolistë dhe ndër themeluesit kryesorë të modernitetit : *Rinia ime qe një stuh**i e errët / E përshkuar aty-këtu nga diej të ndritshëm*. (Armiku).

**Arthur Rimbaud (1854-1891)**. Malarmeja e ka quajtur një aventurë lirike. Vepra e tij poetike i ka të gjitha. E vërteta e kohës tek ai bëhet e vërteta e krijuesit. Rembo shkruan për t’u çliruar nga frymëzimi. Vepra e tij është një nisje me shumë stacione, që përmbledh në vetvete tërë zhvillimin poetik të viteve simboliste¹. Më 1869 ai i pati shkruar Th. Banville-it shprehjen e çuditshme : *“Do të jem parnasian”*. Dhe vërtet poezitë e tij të para janë me varg të matur : *Në muzgjet verore, shtegut do të arratisem / i caksur nga gruri, do të shkel mbi barin e njomë / Ëndërrues do të flladitem e erëtisem / Mbi fytyrë do ta lë erën të vallëzojë* (Ndjesi) ; *Mbi valën e kaltër e të zezë yjet flenë / E zbehta Ofeli pluskon, zambak i bardhë* (Ofelia). Simbolistët do t’u qortojnë parnasianëve karakterin sipërfaqësor të kumtit. Shkolla parnasiane në përgjithësi mbahet si teori e “artit për art”, po Artur Rembo shumë shpejt i braktis parnasianët dhe e nis *“anijen e dehur”* që të zbulojë shtigje të reja pastruara. E botuar më 1871 *“Anija e dehur”* është prelud i modernitetit dhe paraqitet si një alegori e shkëlqyer e aspiratave të poetit të ri në udhëtim drejt agimeve të pikëlluara : *Që nga ai çast jam zhytur te Poema / E detit, i larë me yj qumështorë / Duke lundruar gëlltis qiej të blertë / Si një i mbytur që ende mediton* (Anija e dehur). *“Unë jam në anije e dehur”*, thotë ai dhe lëshohet në ndjekje të metrave të panjohur, të vargjeve popullore, ngjall forma të harruara. Më 1872 ai shpik me Verlenin një varg të ri, shkruan sonete të përmbysura, romanca dhe arrin te proza poetike. Duke folur me nostalgji për një gojëtari poetike të vdekur, poeti kalon nga poezia objektive në atë subjektive : *A e zezë, E e bardhë, I e kuqe, U e verdhë, O blu : zanore / Një ditë do të rrëfej lindjen tuaj të fshehtë* (Zanore).

Megjithëse doli para lexuesit në moshën 15 vjeçare (më 1870 ai pati botuar librin e parë *“Për muzikën”*), Artur Rembo nuk është pararendës. Poemat e tij dëshmojnë se ai i ka njohur format e mëparshme poetike dhe pohon se do ta jetojë më mirë se Bodleri përvojën “prometeiane” si “rrëmbyes zjarri”. Kur shkruan, ai thotë se “nuk është më vetvetja” dhe ka si përgjigje “çrregullimin e të gjitha kuptimeve”. Edhe Fernando Pessoa do të thoshte se kur shkruan një poemë, çdo herë e ndjen se është ndryshe.

I tronditur nga shpallja e luftës me Prusinë dhe nga dështimi i Komunës, Rembo provon disa herë të arratiset nga Parisi. Por arratisja e tij e vërtetë është arratisja brenda krijimit. Sidoqë në fillimet e tij poetike ndjehet ndonjë ndikim i jashtëm nga poezia e Verlenit apo edhe admirim për Hugo-in, retorika e tij shenjohet hapur në një revolucion metrik. Brenda vargut të matur ai shprehet kundër vargut të matur. Poema e tij *“Kujtesë”* është një “katastrofë” e vërtetë metrike. Rregullat aty s’vlejnë më. Moderniteti poetik me forcën e tij s’ka të bëjë me poetikën si muzikë dhome të parnasianëve.

Në të vërtetë Rembo është pasqyra më e kthjellët e viteve simboliste. Krijimtaria e tij përmbldhet në tri faza : 1. Kriza e vargut ; 2. Stili barok dhe 3. Revolucioni i brendshëm. Në tekstet palimpsest lëvizja e përgjithshme ndihet si një lloj shkrimi, ku poezia i kalon kufijtë poetikë dhe bëhet kaos, ndërsa proza bëhet urtësi. Në këtë krizë poema bëhet prozaike dhe proza bëhet poetike si tek Bodleri. *“E dua shkretëtirën, blerimin e djegur”*, do të shkruajë ai.

Vjen një moment kur ai e braktis formalisht vargun në librin *“Ndriçime” (Illuminations)*, 1874. Megjithëse titulli dëshmon dritë, prozat poetike të këtij libri janë të errëta, plot mistere. Ndryshe nga *“Një stinë në ferr”* që u krijua thuajse me një frymë, gjatë një krize shpirtërore (pas prishjes dramatike me Verlenin më 1873, dhe që shërben si autobiografi poetike), *“Ndriçime”* u formësua në disa vite.

Poemat e tij në prozë që janë si vegime të skicuara, shprehin aspekte të poetikës si: largpamësia, sensualiteti, besimi, politika, fëmijëria, të endurit, spektaklet e natyrës, mitologjia, dehja... Që më 1870 tek *“Alkimia e fjalës”* ai dëshmon për një hershmëri poetike, e cila do të shpërfaqë ligjërimin universal poetik “nga shpirti për shpirtin” (*de l’âme pour l’âme*). Lidhja midis poemave të tij e sidomos mes *“Një stinë në ferr”* dhe *“Ndriçime”* është e madhe. Te *“Një stinë në ferr”* ai shkruan: *Po, i kisha sytë të verbuar nga* drita jote. Poemat në prozë nëpërmjet një mistike të njohur tashmë në krijimet poetike të mëparshme, bartin fragmente të jetës si copëra të mëdha pasqyrash të thyera. Çdo poemë, qoftë ajo e shkruar me varg, qoftë e shkruar në rreshta “si shpërthim i çmendur”, përkthen vizionin për botën dhe forcën e tij të thellë krijuese.

Poetika e Rembosë është vendi i një larmie formale, i një lufte të pafund me fjalët. Ajo është poetikë e modernitetit. Kaos i perceptimit por edhe kaos i formës (ndonjëra mund të lexohet si sonet në prozë). Poema në prozë *“Mistikë”* që në titull lajmëron

hapjen drejt një bote tjetër: *Butësia e çelur yjore dhe e çdo gjëje tjetër mbi lirishtë që zbret mbi fytyrat tona si një shportë, e bën greminën të lulëzuar dhe krejt të kaltër dheun*. Optika poetike në këtë poemë në prozë është e përmbysur. Madje edhe engjëlli bie, në një kohë që ai duhet të ngjitet. Zbritja e shportës të kujton zbritjen e Jeruzalemit Qiellor te *“Apokalipsi”* i Shën Gjonit. Rimat e brendshme janë zanore, me muzikalitet: *E putha agun e verës. Asgjë nuk pipëtinte. Uji ishte i vdekur. Unë ecja, ecja dhe zgjoja frymët e gjalla, dhe gurët e çmuar vështronin dhe flatrat u ngritën pa zhurmë* (Agim). Kritika ka theksuar se ndër poemat më të bukura të Rembosë janë ato të shkruara sipas vegimeve. Poeticiteti tek ai e shmang narrativitetin.

Te krijimtaria e Rembosë shfaqet thelbi i mosqenies si element transfiguracioni. Jean-Pierre Richard, vë në dukje se ëndrra tek Rembo, ashtu siç ndodhte edhe me Nervalin, vjen nga jashtë, në gjendje zgjuar. Poemat e tij përshkruajnë lëvizjen e tmerrshme të kohës në kohësi duke ndriçuar një të vërtetë që shkon përtej së vërtetës: *Ç’të kuptosh nga fjala ime / Që arratiset, fluturon* (O stinë, o kështjella). Retorika e tij është një gjuhë e zgjedhur për t’i bërë ballë errësirës. Zanoret e tij të ngjyrshme janë fantazma e atij ligjërimi të ri, me të cilin Rembo shpreson se ka gjetur të vërtetën poetike. Ai i përdori të gjitha llojet e vargut, deri sa shfaqet tek ai “katastrofa metrike” që e përmendëm, siç e emërtun Jean-Nicolas Illouz² momentin kur ai e zhduk vargun e matur. Te një poemë e tij që pati ruajtur Verleni, në pak vargje evokohet dielli eskatologjik, domethënë frymëzimi si dehje poetike.

Kur e quan aventurë lirike, Malarme shton se Rembo u shfaq në poezi si meteor. Për një kohë të shkurtër ai i kapërcen kufijtë e realitetit krijues. Uni është një tjetër *« Je est un autre »*, i tij e kapërcen vetëdijen individuale dhe bashkon unin e thellë me unitetin kozmik. Nëpërmjet alkimisë së vargut, siç shprehet vetë, ai synon të mbërrijë në një pushtet të mbinatyrshëm.

Ai që pati deklaruar më 1874 : *Unë tani di si ta përshëndes të bukurën* dhe *Kam ndërur telat nga kambanarja në kambanare ; vargje girlandash nga dritarja në dritare ; zinxhirë të florinjtë nga ylli në yll dhe vallëzoj*, shpall hapur paafësinë e poezisë për të ndryshuar botën. Kur i thotë lamtumirë poezisë, Rembo i thotë njëkohësisht lamtumirë edhe jetës. Ai hesht për tetëmbëdhjetë vjet rresht dhe përfundon trafikant armësh në Abisini. Më 1891, Rembo vdes në një spital të Marsejës, pasi i presin njërën këmbë me kancer në gju. Ishte vetëm 37 vjeç.

E përmbyllur me një heshtje të gjatë e që ngjalli shumë interpretime : si një përvojë meteorike për të shpikur dashurinë (*Delir I*) dhe si një luftë e fuqishme shpirtërore për një vetëdije “absolutisht moderne” (*Delir II*), vepra e shkurtër e Rembosë e mbolli simbolizmin para se ai të përshëndetej nga syrealistët si rrymë letrare, si pararendëse e revolucionit të tyre të brendshëm. Rembo quhet i paklasifikueshëm, një rast i veçantë që përbën një identitet të fortë letrar, me një historicitet poetik të patjetërsueshëm. Megjithëse e mitizuar (*Le mythe Rimbaud*, R. Etiemble, 1957), vepra e tij mbetet një nga burimet kryesore të lëvizjes poetike moderne.

**Paul Verlaine (1844-1896)**, mbetet gjer në vdekje besnik i vargut. Në tematikën poetike ai sjell me guximin e talentit poetik një fushë gjërash të vagullta, të panjohura gjer atëherë. Gjeni tepër individual, mendohet se vepra e tij nuk ka ndikime. Vargjet e tij formojnë një këngë intime: *Dritë e qetë hënë, e trishtë dhe e bukur / Që i bën ëndërrues zogjtë nëpër pemë* (Dritë hënë). Zogu në traditën popullore është një qenie e nginjur me poezi dhe futja e tij në poemë është “simbolike“. Keats madje ka

2 Jean-Nicolas Illouz, profesor universiteti në Paris, specialist i letërsisë simboliste dhe kryedaktor i revistës Nerval.



shkruar një ode të gjatë dramatike me titull *“Ode për një bilbil”*, ku bilbili është simbol i artit, fitimtar mbi vdekjen.

I lidhur që herët me poezinë, Verleni mori pjesë në lëvizjen letrare të kohës dhe bashkëpunoi me revistën *“Parnasi bashkëkohor”*. Libri i parë *„Poema saturniane”* më 1866, kur ishte 22 vjeç, sidoqë e tregon të ndjeshëm ndaj parnasianëve, e karakterizon atë si poet me frymë të re që i përshkruan në mënyrë origjinale pështjellimet nga dashuritë fatkeqe. Elita intelektuale pariziane u entuziazmua, ndërsa Malarmeja i shkruan: “Tashmë do të kisha kurajo t’ju recitoja të gjitha vargjet që kam mësuar përmendësh nga *“Poema saturniane”*.”

Verleni thoshte: “Arti kërkon të jesh absolutisht vetvetja”. Ai shkruan me një lirizëm që nuk kërkon ngjyrën, por nuancën: *O zhurmë e ëmbël shiu, / Që rigon mbi çati e mbi dhe, /Për zembrën e trishtuar, /Muzikë e gëzuar ti je* (pa titull). Fjalët në poemat e tij kanë një tingëllimë të mbytur, si sonatat, të mezikapshme, me sintaksë të lirë, me ritmikë të lehtë. Jo rrallë ai krijon një varg tek që shërben si refren ideor: *Hënëza e bardhë / shkëlqen në pyje/ Nga degët përhapet / Një zëth plot diell / Nën degë përse rri menduar? / O e dashuruar* (pa titull).

Më 1869 Verleni boton librin e dytë *“Festa galante”*. Disa bashkëkohës të tij e çmuan si një vlerë të re të poezisë verleniane. Në këto poezi Verleni duket sikur të merr përdore e të përkund me fjalën e shenjtë të shpirtit që niset për të rizgjuar botën. *“Këngë e bukur”* më 1870 manifeston një lloj frymëzimi të lumtur që shuhet shpejt.

I ndarë nga gruaja, për shkak të lidhjeve intime me Rembonë, ai iu dha pijes dhe njohu një ekzistencë të paqëndrueshme, sidomos pas rënies të Komunës; ai kishte pasur një punë në Bashkinë e Parisit: *Një tempull i moçëm duke u vithisur / Nga maja e frikshme e një mali të verdhë / Si një mbret që vajton fronin e përmbysur / Llahtarisht e zbeh pasqyra e ujit që rrjedh*. (Alegori). Në një letër që i shkruan ato kohë një miku, lexojmë: “Filli i zi që qarkon këtë letër do t’ju mësojë mjaft se udhëtimi dhe qëndrimi im në Belgjikë kanë qenë të trishtuar”. Kuptohet që poeti kërkon pakëz lumturi, por nuk e gjen.

*“Romanca pa fjalë”* botuar më 1879, është shkruar në burg, pasi qëllloi me revolver mbi Rembonë: *Në parkun vetmitar e të akulluar, / Dy hije njerëzore sapo kypa e kaluar, / Sytë i kanë të vdekur dhe buzët të thata, / U ngatërrohen ndër dhëmbë fjalët e ngrata* (Bisedë sentimentale).

Verleni kultivoi një poezi duke u mbështetur në zhvendosjen nga fusha e ndjenjave në atë të përshlypjeve poetike: *Dënesjet e pafunda / të violinave / vjeshtore / Ma copëtojnë zembrën / Me dhimbje monotone* (Këngë vjeshte).

Më 1880 ai boton *“Urti”*, një tekst plot mistere, me poema heteroklite, ku shtrohet poetikisht pyetja tragjike: Çfarë bën njeriu mbi tokë? Dhe poeti përgjigjet: „Veçse çon një jetë të ndërmjetme midis jetës së brendshme dhe asaj të jashtme: *Diç qan në zembrën time? / Siç ndodh kur në qytet rigon, / Nuk e di çfarë më sjell pikëllime, / Që shpirtin kështu ma plagon* (pa titull).

Libri tjetër *“Liturgji”* më 1892 e paraqet në zemër të rrymës simboliste, të cilës i printe pa dashur: *O Perëndi, jeta është aty / E thyeshhtë dhe e qetë / Një e lehtë zhurmërimë / Prej qytetit vjen* (pa titull).

Megjithë jetën e tij të turbullt e tepër kontradiktore, duke e krahasuar me harmoninë e poemave të tij, megjithë mjerimin dhe sëmundjen e viteve të fundit, ai nuk harronte të çonte një jetë të dyfishtë: të njeriut dhe të artistit të zgjedhur nga fati që të jetë i ndritshëm. Jeta e tij është si oksimori që përdor vetë kur shkruan: *këndoj vuajtjen*.

Vargu i Verlenit dallohet për një muzikalitet që brof nga një gjendje shpirtërore eterike, e përshkuar nga mrekullia dhe e bukura. Në një libër kushtuar Verlenit, Stephane Huyman shpreh keqardhjen kur thotë: “Të kesh aq muzikë në kokë dhe aq pak auditor për ta shpërndarë atë thesar!”. Poemat e tij, në tërësi ndërtojnë një këngë intime, që frymëzoi kompozitorët e kohës si G. Fauré e ndonjë tjetër. Është e njohur e famshmja *“Këngë gri”* në vitet ’60 të shekullit të kaluar sipas një teksti të Verlenit.

Më 1894 Paul Verlaine u zgjodh princ i poetëve. Ajo zgjedhje ishte kurorëzimi i veprës poetike të një gjeniu të simbolizmit, megjithë përgjigjen e tij emblematike dhënë një gazetari: “Simbolizëm? Nuk e kuptoj. Është fjalë gjermane”. Ai pohon: “Unë jam një Perandori në prag të rënies”. Dhe e mbyll krijimtarinë poetike me poemën *“Vdekja”*. Këtë titull mban edhe poema e tij e parë.

\*

Elemente të simbolizmit në poezinë shqipe shfaqen në disa poezi të De Radës, Naim Frashërit Asdrenit, Poradecit, të cilët e shmangin retorikën dhe i falen emocionit. « *Që nga fund’ i vetëvetes do këndoj një mall të ri* »³, shkruan Poradeci. Këtë mënyrë tepër vetjake të shprehjes emocionale me elemente të simbolizmit e gjejmë më vonë edhe te N. Mjeda, F. Noli, Migjeni, V. Stafa, M. Kuteli, M. Camaj, F. Gunga, A. Shkreli, D. Mehmeti e ndonjë tjetër, si rezultat i takimeve dhe ndikimit nga kulturat e ndryshme ballkanike dhe europiane, por edhe më gjerë.

\*

Fjala poetike është transhendencë, është kërkim i identitetit. Kjo u kuptua më tepër se kurrë në vitet simboliste, kur poema u bë ikonoklaste dhe nuk i përgjigjejë më rregullit të ligjërimit në vargje. Poeti parnasian kishte pushuar së ekzistuari. Kodi lirik ishte bërë stereotip. Kështu, lindi kriza e vargëzimit si krizë moderniteti që solli shkrimin vertikal, madhështor, jehonë tematike e kuptimësisë me vargun e lirë, poemën në prozë dhe prozën poetike.

<sup>[1]</sup> Arthur Rimbaud, Poema të zgjedhura, përktheu Anton Papeleka, Redona, Tiranë, 2011.

<sup>[3]</sup> Lasgush Poradeci, Rilindja, Prishtinë, 1988, f.50.

Kur Dona Tarti po shkruante romanin *“Historia sekrete”*, një përpjekje që i mori tetë vjet, nuk ishte e bindur se do të ftonte një gamë të gjerë lexuesish. Ishte një vepër e frymëzuar nga dhe njëkohësisht për dashurinë ndaj mitologjisë greke; një rrëfim melankolik për një grup studentësh të letërsisë klasike në një universitet elitare të Anglisë, të cilët ndajnë një sekret të tmerrshëm, i rrëfyer me detaje dikensiane. “Mendoja se po shkruaja një libër të vjetër, shumë të çuditshëm, që nuk do t’i pëlqente askujt. Po e shkruaja për veten dhe miqtë e mi”, - u shpreh Tart në një intervistë në vitin 2018.

Po ajo nuk kishte pse të merakosej, sepse që në botimin e parë, shtatorin e vitit 1992, *“Historia sekrete”* u bë menjëherë një sukses kritik dhe komercial; një nga ato vepra të rralla që bën bujë si në qarqet letrare, ashtu edhe në listat e librave më të shitur. Po suksesi nuk ishte i përkohshëm, sepse shumë shpejt u kthye në një nga librat që njerëzit i lexojnë disa herë dhe ia kalojnë me entuziazëm shoshëqit. Libri është shitur në më shumë se 2.3 milionë kopje vetëm në anglisht dhe është përkthyer në mbi dyzet gjuhë. Tridhjetë vjet më vonë, ai ende bën pjesë në diskutimet kulturore, duke tërhequr një brez të ri lexuesish përmes platformës “TikTok”. Dona Tart ka botuar edhe dy libra të tjerë, përfshirë “Gardalina”, fitues i Çmimit Pulitzer në vitin 2014, por është pikërisht debutimi ai që ka lënë mbresën më të thellë.

Pjesërisht triller, pjesërisht roman rritjeje në ambientet universitare dhe pjesërisht tragjedi greke, *“Historia sekrete”* nis me një nga fjalitë më të paharrueshme në letërsi: “Dëbora po shkrihej maleve dhe Bani kishte disa javë që kishte vdekur, kur e kuptuam se sa e rëndë qe situata.” Që në prologun e ftohtë të librit, kuptojmë menjëherë se rrëfimtari, Riçard Papani, dhe miqtë e tij kanë kryer një krim të tmerrshëm. Lexuesi është në dijeni të një sekreti të kobshëm, që e bën romanin të shtrihet në dy linja: çfarë i çoi ata drejt vrasjes së shokut të klasës dhe ç’ndodhi më vonë. Kur libri doli në treg, *The New York Times* shkroi: “Imagjinoni një histori që kombinon komplotin e ‘Krim dhe Ndëshkim’ të Dostojevskit, me ‘The Bacchae’ të Euripidit, të vendosur në sfondin e ‘Rules of Attraction’ të Bret Istën Elisit, dhe të rrëfyer me zërin elegant dhe meditues të ‘Brideshead Revisited’ nga Evelyn Uo.”

Shkrimtarja Lori Petru e ka lexuar këtë libër me dhjetëra herë. “Kam pasur aq shumë kopje, sa disa i kam lagur në vaskë, disa i kam dhuruar dhe të tjerat janë dëmtuar nga përdorimi”, - tregon ajo për *BBC Culture*. Për herë të parë e lexoi në shkollë, kur ia huazoi një shoqeje. “U lidha me të në një mënyrë që nuk e kisha bërë me asnjë nga librat që na kërkohej të lexonim në shkollë. Kur Riçardi tregon për monotoninë e adoleshencës, më kujtohet se sa fort më goditi ajo copëz, por në fakt, ishte mënyra e të shkruarit. Ishte përcjellë aq e bukur dhe aq prekëse, gërshetuar me ndjesinë e parehatisë dhe ftohtësisë që përshkon librin. Ishte libri që më bëri lexuese dhe më pas shkrimtare.”

#### Jeta në kampus

“Historia sekrete” bën pjesë në një traditë të gjatë romanesh të vendosura në ambiente universitare, përfshirë edhe romanin më të fundit të Petrusë, “Stargazer”, që tregon historinë e dy mikeshave në një universitet të largët kanadez në vitet ‘90, që është frymëzuar nga dashuria për “Historia sekrete”. “Ka një paralelizëm të qartë, është i vendosur në një kampus të vogël, tregon për një miqësi të ngushtë, por përcillet edhe ajo ndjesia e përgjithshme e ftohtësisë, një lloj mizorie që nuk e përkufizon dot, por që të vë në siklet.”

Bota e mbyllur e kampusit, me rregullat dhe hierarkitë e veta, e ndërthurur me personazhe që vijnë nga vende të ndryshme dhe kërkojnë të ndërtojnë një version të ri të

Tridhjetë vjet pas botimit të parë, romani debutues i Dona Tartit, “Historia sekrete”, vazhdon të magjepsë breza të rinj lexuesish.

## “Historia sekrete”, misteri që vazhdon të magjepsë lexuesit edhe pas tri dekadash

Nga Clare Thorp

Përktheu: Xhoina Salaj

vetes, krijon një terren të përshtatshëm për tregime të fuqishme. “Janë të rinj, që për herë të parë jetojnë të pavarur në botën e të rriturve. Janë njerëz të lirë, por që sillen keq. Ka inteligjencë, snobizëm, privilegj, pra, elemente që janë tokë pjellore për letërsi të jashtëzakonshme.”

*Parë nga një perspektivë klasike, është e qartë se ajo nuk e ka lexuar “The Bacchae” të Euripidit, por i ka bërë autopsinë. - Owen Hodkinsën.*

Në librin “Historia sekrete”, Riçard Papani përfundon në Hampden pothuajse rastësisht: gjen një broshurë të kolegjit në xhepin e palltos dhe aplikon në mënyrë impulsive pas një zënke me prindërit. Arratisja nga Kalifornia drejt Anglisë është një mënyrë për të shpëtuar nga familja dhe monotonia e ambientit të saj, por kur mbërrin në Hampden, përpara tij shtrihet një botë krejtësisht e re. Në fillim, i mohohet klasa e greqishtes së lashtë, ku studentët përzgjidhen me pikatore nga profesori karizmatik, Xhuliani, por më pas ai lejohet t’i bashkohet klubit ekskluziv, ku bëjnë pjesë binjakët Çarls dhe Kamila, Frensis,

Henri dhe Edmund Korkorani, ose Bani. Prejardhja e Riçardit nga klasa e mesme e bën një të huaj në atë grup pasanikësh, por në letërsi, të gjithë duan të lexojnë për të huajin.

Ashtu si personazhet e saj, Dona ka qenë studente e letërsisë klasike, dhe referencat e tilla i shtojnë një shtresë të tërë romanit. “Njohuritë dhe dashuria për klasikët nga autorja ndihen qartë gjatë gjithë leximit”, - thotë Owen Hodkinsën, profesor i asociuar i Kulturave Greke dhe Romake në universitetin “Leeds”. “Dikush tjetër mund të kishte shkruar një histori të ngjashme nga ana e komplotit, me personazhe të frymëzuara nga antikiteti dhe do të ishte në rregull. Por nga një perspektivë klasike, është e qartë se ajo nuk e ka lexuar ‘The Bacchae’ të Euripidit, por i ka bërë autopsinë dhe e ka vlerësuar përmes punimeve akademike.”

Dhuna dhe egërsia e veprës “The Bacchae” nga Euripidi përmendet herët në libër, kur Xhuliani diskuton me klasën për ritualet dionisiane, duke theksuar se “bukuria është terror”. Studentët më pas

rikrijojnë versionin e tyre të një *bakaniale* në pyll: një natë e mbushur me ekstazë, dehje dhe në fund, vrasje.

“Edhe pse vepra e Euripidit është referenca më e qartë që përdor Tart, ka edhe të tjera shumë më komplekse, - thotë Hodkinsën, - shumica e të cilave kalojnë pa u vënë re nga ata që nuk janë të njohur mirë me klasikët. Si për dreg, krijohet një rreth i brendshëm dhe një i jashtëm edhe me vetë lexuesit, njësoj si në roman, ku ka studentë të greqishtes së lashtë dhe të tjerët. Disa lexues do të jenë në gjendje të kuptojnë shumë më tepër nga aludimet dhe shtresëzimet e romanit, do të jenë të vetëdijshëm se janë në pozitë të privilegjuar, por kjo gjithashtu është një ndjesi e parehatshme, sepse i bën ata më të ngjashëm me Henrin dhe pjesën tjetër të grupit të klasicistëve.”

#### Rrethi i zgjedhur


Të bëje pjesë në një klikë të talentuarish, ishte diçka me të cilën Dona Tart ishte më se e njohur. Ajo filloi ta shkruante “Historia sekrete” gjatë studimeve në “Bennington”, një universitet elitare të arteve në Vermont. Klasa e vitit ‘86 përfshinte gjithashtu Xhonatan Lithëm dhe Bret Istën Elisin, të cilëve u ka kushtuar librin në fjalë. Elis botoi romanin e tij të parë, “Less Than Zero”, ndërsa ishte ende student dhe u frymëzua shumë nga përvojat atje për romanin e dytë, “The Rules of Attraction” (ku përmendet ai grup i çuditshëm i klasikëve... se ndoshta po enden nëpër fshat duke bërë fli fermerë dhe duke kryer rituale pagane). Ashtu si protagonistin, lindur në Misisipi, edhe autorja ishte disi e jashtme mes studentëve të kamur, por njëjtë si Riçardi, edhe ajo u përshtat shpejt.

Në vitin 2019, gazetarja Lili Anëlik shkroi për revistën “Esquire” një histori të trilluar, kushtuar kohës që kaluan së bashku tri vjet e letërsisë në “Bennington” gjatë viteve ‘80, dhe më pas e përfshiu në një podcast të gjatë me 14 copëza dhe plot thashetheme, të titulluar “Once Upon A Time... At Bennington College”. Ajo e lexoi librin “Historia sekrete” dhe u dashurua me të qysh në adoleshencë. “Ishte libri i parë që më mbajti zgjuar gjithë natën. Shumë vendime i mora falë tij. Vuajta katër vjet mësim latinishteje duke imituar Riçardin. Më kujtohet që doja me çdo kusht të përjetoja ato çka përjetonte ai. Nuk dua të them se doja të vrisja në grup njërin nga miqtë e mi, por doja të shkoja në një koleg të vjetër, me ndërtesa të mbuluara me dredhka, me shumë gjelbërim dhe tradita të lavdishme”, - shprehet ajo për *BBC Culture*.

Anëlik beson fort se libri nuk do të kishte ekzistuar pa kolegjin në fjalë; aq i madh ishte ndikimi i atij institucioni tek autorja, e cila është shprehur se ka qenë oaza e saj e paqetë. Në libër, Riçardi thotë: “Besoj se ekziston një interval i caktuar dhe vendimtar në jetën e gjithkujt, ku formohet përgjithmonë karakteri; për mua, ishte ai semestri i parë i vjeshtës që kalova në Hampden”; një fjali e marrë pothuajse fjalë për fjalë nga fjalimi i diplomimit që Dona Tarti mbajti në “Bennington” në vitin 1986.

Në zhytjen e saj të thellë në kolegjin e viteve ‘80, gazetarja zbulon detaje pikante: si kohërat e festave të martinit që Dona mbante në dhomën e konviktit dhe mbërritjen e Bretit në kampus, me një valixhe plot me drogëra të klasit A. Ajo eksploron gjithashtu origjinën e romanit të Tartit, duke identifikuar njerëz që mund të kenë frymëzuar krijimin e personazheve. Midis tyre është Mat Xhakobson, ish-shok klase i autores, i cili nuk kishte ndonjë simpati për të (e ka përshkruar Donën si Joko Ono të klasës së greqishtes) dhe që beson se ka shërbyer si frymëzim për personazhin e Banit, i cili vritet nga shokët e vet. Këto zbulime e çuan *LA Review of Books* të ngrejë pyetjen, nëse “Historia Sekrete” është një version i sofistikuar dhe i hollësishëm i një libri hakmarrjeje.

*Librat janë jetë të tjera, që na mundësojnë të ndryshojmë lëkurë. - Dona Tart*





Dona Tart e ka mohuar vazhdimisht që libri të jetë bazuar në jetën e saj, përveçse në një formë të butë dhe të vogël. Në thelb, mbetet fantazi për jetën universitare. Ajo ka pranuar se është frymëzuar nga zhdukja misterioze dhe çështja e pazgjidhur e një studenteje të kolegjit në vitet '40.

Vitin e kaluar, kur *The New Yorker* publikoi një përshkrim të Klod Frederik, profesorit të letërsisë klasike në kolegjin "Bennington", dhe e cilësoi atë si muzën për personazhin e Xhulianit. Autorja iu përgjigj me një deklaratë mbrojtjeje për "mësuesin e dashur dhe bujar", duke shprehur zhgënjimin ndaj gazetarëve që bëjnë krahasime të atilla. "Për mua, kjo ngatërresë është tragjike, ashtu edhe e padrejtë ndaj kujtimit të tij."

S'do mend që Dona është një person privat, që ka rezerva serioze ndaj famës. Megjithatë, është jashtëzakonisht e zonja në të qenit e famshme. – Lili Anëlik

Kur u transmetua podkasti i Lilit, avokatët e Tartit iu dërguan një letër producentëve, duke i paralajmëruar të mos përdornin deklaratatë të pavërteta, mashtruese apo të pasakta për autoren. Ndryshe nga Bret Istën Elis dhe Xhonatan Lithëm, Dona Tart refuzoi të merrte pjesë në historinë e trilluar, ashtu edhe në podkast.

"Romani 'Historia sekrete' nuk ishte krijimi i vetëm letrar i autores gjatë viteve të saj në kolegji, - thotë Anëlik. - Ajo krijoi edhe një version letrar të vetes, një personazh, një figurë publike po aq teatrale, të qëllimshme dhe mjeshtërore sa vetë proza e saj." Një copëz e këtij krijimi qe edhe pamja e saj, flokët në stil *bob*, kostumet e qepura me kujdes, kravatat dhe shallet, pamje që u bë tipari i dallueshëm dhe që gazetarja dyshon se është frymëzuar nga libri "Brideshead Revisited". "Duket se është e vetëdijshme që është projektuar për të ngjarë me një personazh të Evelin Uosë. Është Sebastian Flait në versionin grua."

Në një intervistë të vitit 2013, Tart citoi Emersonin: "Liria e madhe e jetës amerikane është liria... për të mbyllur derën dhe për të tërhequr perdet."

Bret Istën Elis, një nga lexuesit e parë të dorëshkrimit të librit "Historia sekrete", e prezantoi autoren me agjentin e tij letrar, i cili siguroi një parapagim prej 450,000 dollarësh. Kur u botua në vitin 1992, kritikati ishin kryesisht pozitive. *Time* e quajti "tronditës dhe tërheqës deri në palcë", *Newsday* e përshkroi si "trilleri i mendimtarëve", ndërsa *The Independent* shkroi se "stili ngatërrohet vazhdimisht me përmbajtjen". Megjithatë, makineria e publicitetit e kishte nisur punën e vet dhe kështu Dona Tart përfundoi në një reportazh tetëfaqësh të *Vanity Fair*, bashkë me një set fotografik ku pozonte me qenushin e saj, Pongon. Atëbotë, botuesi i saj u shpreh për *New York Times* me deklaratën: "Kur e blemë librin, nuk dinim se si dukej ajo, por kjo gjë nuk na dëmtoi."

Në reportazhin e *Vanity Fair* ajo prezantoi me rreshtin: "Dona Tart, e cila shumë shpejt do të bëhet e famshme...", por që në fillim, autorja preferoi të ruante një

aurë misteri, duke u bërë bisht pyetjeve për jetën personale. Detajet e pakta që u zbuluan, u kthyen shpejt në legjenda urbane: zëri në sekretarinë e saj telefonike ishte vetë T.S. Eliot duke lexuar "Toka e shkretë"; vishej me rroba për fëmijë nga "Gap Kids"; dhe mund të pinte më shumë se Bret Istën Elisi pa iu dridhur qerpiku.

Gjatë karrierës së saj, intervistat kanë qenë të rralla, zakonisht vetëm kur ka nxjerrë një libër të ri (gjatë tridhjetë vjetëve ka botuar vetëm dy të tjerë: "The Little Friend" në vitin 2002 dhe "Gardalina" në vitin 2014). Misticizmi vetëm sa ia ka shtuar famën. Anëlik thotë: "Libri 'Historia sekrete' vazhdon të jetojë, sepse është një roman i shkëlqyer, dhe nuk e dëmton aspak fakti që Dona ka një instinkt brilant për maninë kult, sepse di ta menaxhojë mirë famën enigmatike."

Gjithsesi, imazhi i saj si një vetmitare e skajshme është disi i ekzagjeruar. Vitin e kaluar, në një intervistë për botimin italian, ajo foli hapur për pasionin për modën, muzikën e preferuar (Lana Del Rei) dhe rutinën e të shkruarit (tri orë në mëngjes), ku la të nënkuptohej se një libër i ri mund të jetë në horizont. Ajo gjithashtu deklaroi se nuk i ka përdorur kurrë rrjetet sociale.

#### Proza që magjepsi internetin

Është disi ironike që pikërisht rrjetet sociale janë arsyeja pse "Historia sekrete" po përjeton një valë të re popullariteti, falë *Dark Academia*, një nënkulturë në platformat sociale, që romantizon dijen dhe përqafon një estetikë "tradicionale akademike me prirje gotike". Libri konsiderohet si Bibla e kësaj akademie dhe videot me hashtagun #thesecrethistory kanë kaluar 150 milionë shikime, duke përfshirë gjithçka tjetër që ka të bëjë me frymën e librit, që nga të rinjtë që vishen si personazhet, tek ata që lexojnë pasazhet e preferuara apo tregojnë copëzat e nënvizuara. "Ka qenë një kënaqësi e madhe të shoh një brez të ri që zbulon kryeveprën e Dona Tartit", - thotë Izabel Uoll, drejtoreshë editoriale e *Viking*, botuesi i saj në Mbretërinë e Bashkuar.

Për Lori Petrunë, është më se e kuptueshme që libri vazhdon të lidhet me lexuesit e rinj, edhe nëse bota që përshkruhet duket gjithnjë e më e largët nga epoka dixhitale. "Mbeten të rinj, apo jo? Ndjesitë që më preknin mua dikur, sëmbojnë të njëjtat ndjesi tek të rinjtë e sotëm."

Lili Anëlik bie dakord se libri është i përjetshëm. "Mendoj se të rinjtë janë snobë natyralë dhe libri 'Historia sekrete' është romani më i mirë amerikan për snobët e rinj, ashtu siç është 'Brideshead Revisited' për snobët e rinj anglezë."

Tridhjetë vjet dhe miliona lexues më vonë, zbulimi i librit "Historia sekrete" vazhdon të përcjellë ndjesinë e përfshirjes në një klub ekskluziv.

*Të lexosh "Historia sekrete", është si të shohësh dikë në kulmin e artit të vet. I kam zili ata që ende nuk e kanë lexuar. - Lori Petru*

(Instalacion nga Bib Frrokaj /50x6x350cm/)

## Një përshtypje nga takimi me veprën “Flamuri i Dritës”

Nga Stefan Çapaliku

Me instalacionin “Flamuri i Dritës” të Bib Frrokajt u “ndesha” në mbasditet e mmrekullueshme të asaj çfarë ndodhi këtë fundjavë në katundin e vogël “Kukël”, aty ku gjendet kompleksi muzeal “Ndre Mjeda”, me kishën, qelën, muzeun, monumentin figurativo-konceptual të Sadik Spahisë, dhe gjithë hapësirën e gjelbër të manipuluar dhe mbështjellë me kujdes prej famullitarit historian Dom Nikë Ukgjini, i cili ia kishte ofruar bujarisht kuratorit Andi Tepelena, me rastin e organizimit nga ana e këtij të Festivalit të Artit Bashkëkohor “Arti mes ëndërrës dhe realitetit”. Instalacione, video, filma, piktura, danc, ligjërata dhe plot ide, fjalë dhe prapë ide dhe ëndërrime që ajo hapësirë i mbartte si fllad...

“Flamuri i Dritës”, është një instalacion që i bën homazh trashëgimisë poetike të Ndre Mjedës, duke i transformuar disa nga fjalët e tij në një simbol të ndritshëm të rezistencës kulturore. Një shirit vertikal çeliku inox, i prerë me rreze lazër, që mbart nje tekst të shkurtër, (epitaf), varet si një flamur i heshtur pranë qelës se tij në Kukël, ku për më shumë se një çerek shekulli jetoi dhe punoi poeti. Ndërsa drita kalon nëpër tekst, hijet e hedhura në tokë bëhen të lexueshme, duke e shndërruar vetë tokën në një fletore poetike, bartëse e përjetshme e kujtesës.

Ndryshe nga një flamur tradicional që valëvitet në erë, ky flamur transformohet nëpërmjet dritës natyrale, duke zbuluar e duke na mahnitur me faktin sesi gjuha bëhet fener dhe fanar. Zgjedhja e materialit inox dhe rezistent ndaj agjentëve natyror i bën jehonë qëndrueshmërisë dhe vitalitetit të vetë zërit të Mjedës, i cili vazhdon të na mahnisë me luciditetin dhe surprizat kuptimore. Kur gjendesh përballë këtij instalacionit që nuk thërret, nuk bërtet, nuk vetëdëshmohet, nuk thotë se është atje, nuk të fton me zë të lartë, kupton se fjalët e Mjedës, të gdhendura në metal dhe të projektuara përmes dritës, vazhdojnë të flasin, të shkëlqejnë, të kujtojnë.

“Flamuri i Dritës” ky titull që i bën jehonë të drejtpërdrejtë strukturës gjuhësore “Hyllit të Dritës”, nuk është dhe nuk pretendon të jetë një monument. Ai është thjesht një gjest, “hand made”, një jehonë e ndritshme e besimit të autorit, Bib Frrokaj se te Mjeda gjithçka nis dhe mbaron me fjalën, madje edhe Liria vetë.





*Karikatura nga Arben Mexsi*